



Konrad  
Adenauer  
Stiftung



seit 1558

# PASOJAT E DIKTATURËS - QËNDRIMI NDAJ SHYPTJES DHE MËSIMET

**Botues:**

**Konrad-Adenauer-Stiftung e.V.**

**Zyra e Tiranës**

**Dr. Willibold Frehner**

---

**Dr. Pandeli Pani**



## PERMBAJTJA

### Hyrje

<b>Rreth domosdoshmërisë së studimit të historisë së periudhës komuniste</b> – Dr. Willibold Frehner .....	<b>3</b>
---	----------

### Jeta në diktaturë dhe kultura e revolucionit

<b>“Çdo komunist çekist – Sigurimi i Shtetit, populli “punonjës” dhe armiqtë e tij në RDGJ dhe në Shqipëri</b> - Dr. Pandeli Pani .....	<b>5</b>
---	----------

<b>“Një herë në ferr dhe kthim” – Përpunimi shpirtëror dhe harresa e viteve në internim</b> – Dr. Vera Bekteshi .....	<b>12</b>
---	-----------

<b>Proceset politike dhe përndjekja penale për motive politike në Shqipërinë komuniste 1945-1990</b> – Ina Rama .....	<b>20</b>
---	-----------

<b>Sundimi i tejskajshëm i shoqërisë, “patologjia” e akulturacionit, si paradigmë zotëruese dhe format e refuzimit të saj në Shqipërinë totalitare</b> – As. Prof. Dr. Adem Jakllari .....	<b>27</b>
---	-----------

### Opozita politike, subkultura dhe letërsia e sirtarëve

<b>“The second society” – Qëllimet dhe aktivitetet e aktorëve të shoqërisë civile në RDGJ në vitin e kthesës 1989</b> – Dr. Christoph Giesel .....	<b>33</b>
--	-----------

<b>“Shkruar” në kokë – Letërsia e indoktrinuar e realizimit socialist dhe letërsia e pabotuar nën diktatin e saj</b> – Dr. Eldon Gjika .....	<b>59</b>
--	-----------

<b>Lecka legjendash të grisura e të copëtuara nga era e revolucionit – Poema shqiptare mes viteve ’60 – ’70, një aventurë mes realizmit dhe irealizmit</b> – Arjan Leka .....	<b>65</b>
---	-----------

### Aspekte të përballjes me historinë në Shqipëri dhe Gjermani

<b>Fate të ngjashme, përpunim i ndryshëm – Përballja me të kaluarën komuniste të Republikës Demokratike Gjermane dhe të Shqipërisë komuniste</b> – Aida Cama .....	<b>72</b>
---	-----------

## RRETH DOMOSDOSHMERISË SË STUDIMIT TË HISTORISË SË PERIUdhËS KOMUNISTE

Dr. Willibold Frehner

Shqyrtimi dhe analiza kritike e diktaturës komuniste në Shqipëri ka filluar me hapa të ndrojtur. Hulumtimi objektiv i krimeve dhe trajtimi i historisë së periudhës komuniste kanë rëndësi të jashtëzakonshme për forcimin demokratik të vendit dhe të shtetit të së drejtës.

Përmes studimit shkencor të shkaqeve, të rrjedhave dhe të pasojave të diktaturës komuniste, mund të përgatitet edhe analiza kritike e së kaluarës komuniste dhe diktatoriale dhe të nxitet zgjerimi i strukturave të shtetit të së drejtës.

Edhe 20 vjet pas kthesës politike përballja me të kaluarën komuniste vazhdon të mbetet një thjeshtëri i shkencave shoqërore shqiptare. Megjithatë vlerësimet historiko-politike për diktaturën komuniste nuk mungojnë. Por këto ndryshojnë shumë prej njëra-tjetrës në varësi se kush i ndërmerr: ish i përndjekuri politik, ish-komunisti, dikush që ka hyrë rishtazi në politikë, historiani apo politologu.

Pasojat e diktaturës vazhdojnë të ushtrojnë ende deri sot ndikimin e tyre në thuajse çdo familje shqiptare. Për këtë arsye shqyrtimi i historisë së kësaj kohe është një domosdoshmëri absolute, e cila kontribuon për konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe një shoqëri të drejtë.

Analiza e kësaj periudhe do të thotë të zhvillosh një koncept më kritik dhe autokritik të historisë. Do të thotë të konstatosh, se cilat përfytyrime për të kaluarën vazhdojnë të ndikojnë ndaj së tashmes sonë, se për cilat gjëra duhet të bëjmë kujdes, kur bëhet fjalë për kujtimin publik të asaj kohe. Kultura e përkujtimit nuk është pra vetëm çështje e historianëve apo e artistëve, por edhe një detyrë shtetërore.

Seminari i organizuar nga Fondacioni Konrad Adenauer, Universiteti i Jenës dhe Universiteti i Tiranës, në të cilin patën mundësi të mblidheshin dhe të bisedonin bashkarisht viktimat e diktaturës komuniste, historianë, juristë, politikanë dhe aktivistë për të drejtat e njeriut, bazuar në shembujt nga RDGJ-ja dhe Shqipëria, nxori një bilanc të punës së kryer apo deri tani të lënë pas dore, në lidhje me analizën e së kaluarës dhe evidentoi e skicoi disa perspektiva për punën studimore dhe përkujtimore në të ardhmen.



Si në Universitetin e Jenës dhe në atë të Tiranës ka studiues që merren me çështjen e përballjes me të kaluarën komuniste. Në këtë seminar ata patën mundësi të këmbenin përfundimet e nxjerra nga studimet shkencore dhe t'ua paraqisnin ato një publiku të gjërë. Seminari shërbeu si nxitje për aktorët e shoqërisë civile dhe për gazetarët në Shqipëri që të merren në mënyrë më intensive me këtë temë.

*Fondacioni Konrad Adenauer*

## “ÇDO KOMUNIST - NJË ÇEKIST I MIRË“ SIGURIMI I SHTETIT, POPULLI “PUNONJËS“ DHE ARMIQTË E TIJ NË RDGJ DHE NË SHQIPËRINË KOMUNISTE

Dr. Pandeli Pani

“Armiku është nënshtruar por nuk është shfarosur krejtësisht. Ende vazhdon të ketë armiq jashtë dhe brenda zonës sonë të pushtetit – theksonte Lenini gjatë luftës civile ruse duke shtuar “Terrorin detyrohemi ta përdorim për shkak të terrorit të Antantës (*Entente*) [...]. Ne nuk do t’ia dilnim mbanë të rezistonim as edhe dy ditë, në rast se nuk do t’u ishim kundërvënë pa mëshirë përpjekjeve për sabotim., që për ne do të thotë terror“<sup>1</sup>.

Lenini përdor këtu argumentin klasik të despotëve modernë, sipas të cilëve ata genkëshin të detyruar prej të tjerëve që të përdorin dhunën dhe terrorin. Këtë argument të Leninit e bënë të vetin më vonë, duke e ashpërsuar madje edhe më tej, Stalini dhe më pas edhe Republika Demokratike Gjermane (RDGJ) apo Shqipëria komuniste.

*“Partia mendon se lufta e klasave, edhe pas likuidimit të klasave shfrytëzuese, mbetet një nga forcat kryesore lëvizëse të shoqërisë.[...] Kjo luftë në socializëm, siç tregon edhe eksperiencia e vendit tonë, është një fenomen objektiv dhe i pashmangshëm. Lufta e klasave brenda vendit jo vetëm nuk ndërpritet e nuk shuhet, por edhe zhvillohet ashpër, valë-valë e gërshetohet me luftën e klasave në frontin e jashtëm. Ajo përfshin të gjitha fushat e jetës. Lufta e klasave zhvillohet kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm.”* (Historia 1981: 398)

Vende të tilla si Bashkimi Sovjetik, RDGJ-ja apo Shqipëria propagandonin vazhdimisht se ishin të rrethuara nga armiq dhe se për të mbijetuar u duhej t’u përgjigjeshin atyre duke vepruar me ashpërsi brenda vendit<sup>2</sup>. Për të përligjur terrorin pretendohet se ai ishte legjitim për të garantuar arritjet e socializmit. Pushtetmbajtësit theksonin se mbrojtja e socializmit është qëllimi më i lartë, i cili justifikonte dhe u jepte bekimin të gjitha mjeteve. Por qëllimi më i lartë i regjimeve të Republikës Demokratike Gjermane

<sup>1</sup> Lenin 1974: 318

<sup>2</sup> Parrulla të tilla si “Të punojmë, të mendojmë dhe të veprojmë kurdoherë si revolucionarë në rrethim”, “Në njërën dorë kazmën, në tjetrën pushkën” nga Shqipëria, apo “Vendi i punës – vend lufte për paqen”, “Lufta e klasave, pushteti i klasave” nga Republika Demokratike Gjermane i bëjnë të qarta qëndrime të tilla. Shih edhe këtë citat nga hyrja e Kushtetutës së RPSSH-së (1976): “Në përleshje me armiqtë e jashtëm e të brendshëm ai [populli shqiptar] mbrojt qënien si popull e si komb, luftoi për lirinë e pavarsinë kombëtare, për tokën dhe gjuhën amtare, për bukën dhe drejtësinë shoqërore.”

apo i Shqipërisë komuniste ishte në vërtetë sigurimi me çdo kusht dhe mjet i pushtetit dhe sundimit tyre, pra edhe përmes dhunës. Këtij qëllimi i shërbente edhe ngritja dhe forcimi i aparateve të sigurimit të shtetit, të cilat praktikonin edhe terrorin.

## Modeli dhe përvoja sovjetike

Si në shumë sektorë të tjerë të organizimit të shtetit edhe për krijimin e aparateve të sigurimit të shtetit, si model dhe shembull shërbente Bashkimi Sovjetik, konkretisht Komisioni i Jashtëzakonshëm Mbarërus për Luftimin e Kundërrevolucionit, të Spekulumëve dhe të Sabotazhit – ВЧК – ВеЧеКа<sup>3</sup>, sikurse quhej sigurimi sovjetik i shtetit, apo policia politike e BRSS-së, që u themelua më 20 dhjetor 1917.

Krijimi i ВЧК-së u shoqërua edhe me nxjerrjen e një ligji të posaçëm, i cili e konsideronte praktikisht si veprim kriminal çdo formë opozite qoftë individuale, qoftë kolektive, një ligj me anë të së cilit legalizohej çdo kufizim i lirive dhe i të drejtave individuale: "Nisur nga interesi i përgjithshëm i klasës punëtore, Republika Sovjetike ua heq personave apo grupeve të caktuara të drejtat e tyre, që ata mund t'i përdorin kundër interesave të revolucionit socialist."<sup>4</sup> Përcaktimin e veprimeve që mund të ishin kundër interesave të revolucionit e ndërmerre ВЧК-ja, që quhej arma e revolucionit, pra e partisë.

## Parimi i revolucionit të vazhdueshëm dhe organet e sigurimit të shtetit

E gjithë dhuna dhe arbitrariteti shtetëror, i përpunuar dhe sanksionuar në paragrafët e Kodit Penal të Republikës Demokratike Gjermane apo të Shqipërisë komuniste, e ka zanafillën tek idetë e Leninit.

Gjithsesi në një pikë Shqipëria komuniste dallon prej Republikës Demokratike Gjermane dhe vendeve të tjera të ish-bllokut lindor. Enver Hoxha dhe PPSH-ja vazhduan ta ndiqnin me fanatizëm stalinizimin dhe terrorin edhe pas vdekjes së Stalinit. "Stalini vriste, edhe ne gjithashtu" – shkruan Hoxha plot krenari në librin e tij Hrushshovianët<sup>5</sup>.

I përbashkët për të dyja vendet është koncepti, i shndërruar në parim, i revolucionit të vazhdueshëm, i cili nuk i merr parasysh parimet e shtetit të së drejtës dhe shërben edhe si bazë për institucionin e "sigurimit të shtetit".

<sup>3</sup> Prej këtij shkurtime rrjedh edhe termi propagandistik çekist, që përdorej për emërtimin e bashkëpunëtorëve të shërbimeve sekrete në shtetet anëtare të Traktatit të Varshavës.

<sup>4</sup> Krahaso edhe "Figura morale e njeriut punonjës, ndërgjegjia dhe botëkuptimi i tij formohen në bazë të ideologjisë proletare, e cila është ideologjia sunduese." Kushtetuta e RPSSH-së, 1976, Hyrja

<sup>5</sup> Hoxha 1984: 418

Më 08 shkurt 1950 Kuvendi Popullor (Volkskammer) i Republikës Demokratike Gjermane miratoi ligjin për krijimin e Ministrisë së Sigurimit të Shtetit, e cila njihet me shkurtimin Shtazi (gjerm. Stasi). Për t'u përmendur është se ky ligj nuk përmban asnjë lloj përcaktimi në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj ministrie. Veprimtaria e Ministrisë së Sigurimit të Shtetit rregullohej më tepër me anë të direktivave, të rregulloreve, të urdhëresave dhe të urdhërave të brendshëm, të cilët i nixirte apo i shfuqizonte vetë ministri për Sigurimin e Shtetit. Në bazë të parimit të revolucionit të vazhdueshëm përgjegjësitë dhe procedurat e punës së Ministrisë të Sigurimit të Shtetit nuk rregulloheshin me ligj.

Parimi i revolucionit të vazhdueshëm, që në Shqipëri vlente për të gjithë sektorët e jetës<sup>6</sup>, u sanksionua edhe në kushtetutën e vitit 1976: "Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë zhvillon pa ndërprerë revolucionin duke iu përmbajtur luftës së klasave dhe ka për qëllim të sigurojë fitoren përfundimtare të rrugës socialiste mbi rrugën kapitaliste, të arrijë ndërtimin e plotë të socializmit e të komunizimit."<sup>7</sup>

Një ndër instrumentet e rëndësishme të sistemit njëpartiak dhe të luftës së klasave në Shqipëri ishte, sikurse edhe në RDGJ, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, apo Sigurimi, sikurse emërtohet në thjeshtligjërim. Në dallim nga RDGJ-ja ky institucion në Shqipëri nuk ishte ministri më vete, por pjesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke qenë formalisht nën urdhërin e ministrit të Punëve të Brendshme. Përgjegjës i drejtpërdrejtë për veprimtarinë e Sigurimit të Shtetit ishte një nga zëvendësministrat.

Në mënyrë të ngjashme me RDGJ-në edhe Sigurimi i Shtetit nuk e ushtronte veprimtarinë e tij në bazë të një ligji në të cilin përcaktoheshin direktivat, përgjegjësitë dhe detyrat përgjegjëse, por mbi një platformë të Komitetit Qëndror të PPSH-së.<sup>8</sup>

Formalisht si Ministria për Sigurimin e Shtetit e Republikës Demokratike Gjermane ashtu edhe Drejtoria e Sigurimit të Shtetit në Shqipëri ishin institucione shtetërore, ndërsa në të vërtetë ato ishin instrumente të sundimit të udhëheqjes së partisë dhe, në rastin e Shqipërisë, edhe të sundimit personal të Enver Hoxhës. Jo më kot në RDGJ sigurimi i shtetit quhej "mburoja dhe shpata e partisë", ndërkohë që në vazhdim të traditës çekiste dhe staliniste, Hoxha i konsideronte organet dhe punonjësit e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Sigurimit pararojë të shoqërisë komuniste.

Në asnjë ministri tjetër të Republikës Demokratike Gjermane nuk ishte aq i fortë ndikimi absolut i partisë sa në Ministrinë e Sigurimit të Shtetit. Kjo bëhet e

<sup>6</sup> "Çdo komunist e çdo punonjës të punojë e të mendojë si revolucionar çdo ditë e çdo orë, në çdo punë që kryen apo në çdo funksion që zë." Dokumente 1966: 24.

<sup>7</sup> Neni 4 i Kushtetutës së RPSH-së, 1976.

<sup>8</sup> Drejtoria e Sigurimit të Shtetit ishte aq sekrete sa ekzistenca e saj nuk përmendet me asnjë fjalë as në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar të vitit 1985, ku trajtohen gjërësisht drejtori të tilla si Drejtoria e Kontrollit për Shfrytëzimin e Mjeteve të Transportit apo Drejtoria e Kontrollit të Mjeteve Matëse, apo Sigurimet Shoqërore Shtetërore apo Sigurimet Shtetërore të Pronës.



qartë si në aspektin e parimeve që përbënin bazën e punës dhe të veprimtarisë së Ministrisë së Sigurimit të Shtetit edhe në aspektin organizativ të kësaj ministrie. Sa u përket parimeve të punës së Shtazit ministri Erich Mielke theksonte se "vendimet e partisë janë masa për matjen e punës sonë çekiste". Nga pikëpamja organizative ndikimi absolut i partisë vihej re jo vetëm në faktin se të gjithë punonjësit e Ministrisë së Sigurimit të Shtetit, pavarësisht nga grada dhe posti, ishin pa përjashtim anëtarë të Partisë së Bashkuar Socialiste Gjermane (SED), por edhe se kuadrot drejtuese të kësaj ministrie si edhe ata të Ministrisë së Punëve të Brendshme ishin edhe pjesë e nomenklaturës së Komitetit Qendror. Po ashtu punonjësit e Sigurimit të Shtetit gëzonin privilegje në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë.

Për Shqipërinë mungojnë të dhënat nëse të gjithë punonjësit e Sigurimit të Shtetit ishin edhe anëtarë partie. Gjithsesi anasjellas çdo anëtar partie ishte i detyruar të ishte edhe çekist, pra t'i raportonte partisë gjithçka, sikurse përcaktonte në fjalën e tij për cilësitë e komunistit edhe Enver Hoxha: "çdo komunist duhet të pajiset me vigjilencë për mbrojtjen e vijës së partisë dhe të pastërtisë së idealeve të saj, [...] të godasë pa mëshirë dhe me urrejtjen më të madhe ata që janë të pandreqshëm e shoqërisht të rrezikshëm, armiqtë e popullit dhe të partisë".

Ndryshe nga ajo që propagandohej dhe pasqyrohej në letërsi apo filma<sup>9</sup> organet e sigurimit të shtetit si në RDGJ edhe në Shqipëri shërbenin kryesisht për të mbajtur nën kontroll popullsinë përmes mjeteve të mbikëqyrjes, të përgjimit, të represionit dhe të terrorit. Shtazi në RDGJ apo Sigurimi shqiptar mbikëqyrnin pra në radhë të parë se sa besnikë ishin qytetarët e secilit vend ndaj ideologjisë sunduese, ndërkohë që mbrojtja e vendit prej agjentëve apo spiunazheve të huaja luante në veprimtarinë e tyre vetëm një rol të vogël. Kjo bëhet edhe më qartë në rast se mbahet parasysh numri i lartë i punonjësve dhe i informatorëve të Sigurimit të Shtetit në të dy vendet në raport me numrin e popullsisë.

## Masat punonjëse dhe shteti i tyre

Edhe një krahasim i shkurtër i neneve të para të Kushtetutës së Republikës Demokratike Gjermane (të 6 prillit 1968, në versionin e 7 tetorit 1974) dhe asaj të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të vitit 1976, mjafton për të vënë re të përbashkëtat, por edhe një ndryshim të rëndësishëm mes tyre. Kushtetuta e RPSSH-së, sikurse edhe sistemi ligjor i saj, jo vetëm krakterizohen prej një *radikalizimi revolucionar* të dukshëm, por nuk bëhet asnjë përpjekje për ta maskuar atë të paktën në formulim. Po ashtu në kushtetutën e Shqipërisë sanksionohet edhe PPSH-ja si e vetmja forcë sunduese e shtetit dhe e shoqërisë.

---

<sup>9</sup>Krahaso p.sh. "Fijet që priten", "Gëzhoja e Vjetër", "Dora e Ngrohtë", "Mërgata e Qyqeve" apo "Das Ministerium für Staatssicherheit - Alltag einer Behörde" të Christian Klemke dhe Jan N. Lorenzen.

<p>► Republika Demokratike Gjermane është një <i>shtet socialist i punëtorëve dhe i fshatarëve</i>.</p> <p>Ajo është organizata politike e punonjësve dhe e fshatarëve në qytet dhe në fshat nën drejtimin e klasës punëtore dhe të partisë së saj marksiste-leniniste. [...] (Neni 1)</p> <p>► I gjithë pushteti politik në Republikën Demokratike Gjermane ushtrohet prej punonjësve në qytet dhe në fshat. [...]</p> <p>Lidhja e fortë e klasës punëtore me klasën e fshatarëve kooperativiste, <i>pjesëtarët e inteligjencës dhe të shtresave të tjera të popullit</i> [...] drejtimi dhe planifikimi i zhvillimit shoqëror sipas njohurive më të përparuara të shkencës përbëjnë bazat e paprekshme të rendit shoqëror socialist. (Neni 2)</p> <p>► Bashkimi i të gjitha forcave të popullit gjen shprehjen e vet të organizuar në Frontin Kombëtar të Republikës Demokratike Gjermane.</p> <p>Fronti Kombëtar i Republikës Demokratike Gjermane bashkon partitë dhe organizatat e masave dhe të gjitha forcat e popullit për të vepruar bashkarisht për zhvillimin e shoqërisë socialiste. (Neni 3)</p>	<p>► Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë është <i>shtet i diktaturës së proletariatit</i>, që shpreh e mbron interesat e të gjithë punonjësve.</p> <p>Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë mbështetet në unitetin e popullit rreth Partisë së Punës të Shqipërisë dhe ka në themel aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë kooperativiste nën udhëheqjen e klasës punëtore. (Neni 2)</p> <p>► Partia e Punës e Shqipërisë, pararoja e klasës punëtore, është forca e vetme politike udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë.</p> <p>Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë <i>ideologjia sunduese është marksizëm-leninizmi</i>. Në bazë të parimeve të tij zhvillohet gjithë rendi shoqëror socialist. (Neni 3)</p> <p>► I gjithë pushteti shtetëror në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë buron nga populli punonjës dhe i përket atij.</p> <p><i>Klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste dhe punonjësit e tjerë</i> e ushtrojnë pushtetin nëpërmjet organeve përfaqësuese si edhe drejtpërdrejt. (Neni 5)</p>
---	---

Të dyja shtetet e konsiderojnë veten si rezultat zhvillimesh historike të caktuara.

Republika Demokratike Gjermane e sheh veten si vazhduese e traditës revolucionare të klasës punëtore gjermane. Mbështetur në çlirimin prej fashizmit, thuhet në preambulën e kushtetutës, populli i Republikës Demokratike Gjermane realizon dhe i jep formë shoqërisë së zhvilluar socialiste në përputhje me proceset e zhvillimit historik të epokës sonë dhe me të drejtën e tij për vetëvendosje social-ekonomike, shtetërore dhe kombëtare. Kjo bëhet natyrisht "mbushur plot me vullnetin dhe dëshirën për t'i përcaktuar vetë dhe në liri fatet e vendit dhe për

të vazhduar më tej pa gabuar rrugën e socializimit, të komunizmit, të paqes, të demokracisë dhe të miqësisë mes popujve.”

Regjimi komunist në Shqipëri shkon në këtë drejtim një hap më tej, duke e konsideruar Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë si kurorëzimin e historisë së popullit shqiptar, i cili “e ka çarë rrugën e historisë me shpatë në dorë, dhe në përlëshje me armiqtë e jashtëm e të brendshëm mbrojt qënien si popull e si komb, luftoi për lirinë e pavarësinë kombëtare, për tokën dhe gjuhën amtare, për bukën dhe drejtësinë shoqërore. Pas shekujsh robërie ai arriti një fitore të madhe me krijimin e shtetit të pavarur kombëtar shqiptar më 28 Nëntor 1912.”<sup>10</sup>

“Instrumenti kryesor për krijimin e bazave të socializimit është pushteti shtetëror” – thuhej në RDGJ. “Ç’thotë partia bën populli, ç’do populli bën partia.” – thuhej në Shqipëri. Por në të dyja vendet shteti apo partia shtet ishte instrument sundimi, që nuk nguronte të përdorte ndaj shtetasve të vet as terrorin. Dhe megjithëse në formën e tij brutale dhe të dukshme, terrori kryhej në radhë të parë pas mureve të burgjeve, në dhomat e izolimit apo në kampet e internimit, ai ishte kudo gjithmonë i pranishëm në formë të padukshme: në jetën e përditshme kur njerëzit kishin frikë t’i besonin njeri-tjetrit, të shprehen lirshëm atë që mendonin, kur ata përgjoheshin, damkosesin si armiq dhe pengoheshin në jetën e tyre private apo profesionale. Po ashtu edhe masat despotike që përdoreshin për të shtypur mendimin e lirë, për të censuruar shtypin apo për të mos lejuar organizimin e zgjedhjeve të lira, maskoheshin duke krijuar përshtypjen e rreme të lirisë.

## Inskeniimi i armiqve të socializimit

Pjesë thelbësore e propagandës së Republikës Demokratike Gjermane dhe të RPSSH-së ishte pretendimi për ekzistencën e përhershme të armiqve të brendshëm dhe të jashtëm. Prania e këtyre armiqve shërbente si justifikim për të përligjur masat represive në vend.

Në këtë mes vihen re shumë pika të përbashkëta mes të dy regjimeve. Ndër armiqtë e brendshëm nuk bënin pjesë vetëm ata që mendonin politikisht ndryshe, por edhe artistët dhe shkrimtarët. Në RDGJ ata kërkonin “një *socializëm demokratik*”, në Shqipëri mjaftonin edhe disa këngë, si ato të Festivalit të 11-të të Këngës në dhjetor të vitit 1972 për t’i damkosur njerëzit e artit si “armiq” që, duke nxitur frymën e liberalizimit, donin të minonin nga brenda dhe të shkatërronin shoqërinë socialiste.

Në ndryshim nga RDGJ-ja në Shqipëri vazhdoi deri në fund të sundimit të diktaturës modeli i përndjekjes familjare dhe fushatat e spastrimeve politike, që kishin formë ciklike. Shfarosja prej komunistëve e shumë intelektualëve që

<sup>10</sup> Kushtetuta e RPSSH 1976: 1

kishin studiuar jashtë vendit përpara marrjes së pushtetit nga ana e tyre si dhe e përfaqësuesve të fesë, sidomos e priftërinjve katolikë<sup>11</sup>, u pasua nga shtypja që në embrion dhe zhdukja edhe e çdo lloj gjurme opozitare. Prej terrorit nuk të mbronte as anëtarësia në parti dhe as kariera në hierarkinë e sistemit, sikurse e tregojnë shembujt e shumë prej ish-bashkëpunëtorëve dhe bashkëlufëtëtarëve të Enver Hoxhës, të shpallur në vite si "armiq të pushtetit dhe të popullit".

Edukimi me urrejtjen për armikun e brendshëm dhe të jashtëm ishte pjesë e rëndësishme e sistemit shkollor dhe nuk ishte vetëm pjesë e përgatitjes së punonjësve të organeve të rendit. Fëmijët si në RDGJ edhe në Shqipërinë komuniste mësonin që në kopsht, se cilët ishin të mirët dhe cilët të këqinjët. Në procesin e edukimit të përfytyrimeve për figurën e armikut vihet re edhe një paralele mes diktaturave të ndryshme, pavarësisht prej llojit të tyre. Kështu p.sh. ideologjia naziste në Gjermani përdorte figurën e *njeriut të ulët*, ideologjia komuniste atë të *armikut të klasës*. Edhe emërtimet që përdoren për karakterizimin e "armikut" janë të ngjashme: *parazitët, krimbat, gjarpërinjtë, akrepat, ushunjëzat* (që i thithin gjakun popullit) e kështu me radhë.

Pushtetmbajtësit e të dy vendeve ishin të bindur se historia dhe progresi ishin në anën e tyre dhe se ajo që bënin ishte legjitime. Kjo bindje ishte aq e madhe, sa ata harruan se përmes përdorimit të dhunës i ranë vetë ndesh legjitimitimit të diktaturës së proletariatit.

## Literaturë:

Dokumente (1966) *Letër e hapur e KQ të PPSH, 4 mars 1966*; në Dokumente kryesore të PPSH, vëll. V, 8 Nëntori, Tiranë

Historia (1981) *Historia e Partisë së Punës së Shqipërisë*, Botimi II, 8 Nëntori, Tiranë

Lenin (1974) *Bericht über die Arbeit des Gesamtrussischen Zentralexekutivkomitees*, në Lenin, Vepra, vëll. 30, Dietz Verlag, Berlin

Simoni, Zef (et al.) (1993) *Martirizimi i Kishës Katolike Shqiptare 1944-1990*, Shkodër

<sup>11</sup> Shih për këtë Simoni et. al. 1993.

## “NJË HERË NË FERR DHE KTHIM” – PËRPUNIMI SHPIRTËROR DHE HARRESA E VITEVE NË INTERNIM”

Dr. Vera Bekteshi

Një të diel, duke rrëmuar nëpër fotot e vjetra bardhezi, ndava një të njërit prej tyre. Ishte një fotografi e kohës së shkollës shtatëvjeçare: Katër vajza të ulura në bar, Natasha, Nadja, Mira dhe unë, Vera, me flokë të shpupuritur nga era e dimrit, të mbërthyer në pallot e leshta, me këmbë të mbështjella e të mbuluara.

Përveç këtij pozicioni, ne kishim të përbashkët edhe vitin e lindjes, vitin e shkollës, pra në klasën e 7, që jetonim në të njëjtën rrugë të **Tiranës së Re** dhe...që ishim të gëzuara.

Ne ishim shoqe të pandara. Por hollë-hollë kishim një nëndarje: Unë dhe Natasha, Nadja dhe Mira.

Shtëpitë ku banonim, renditeshin në rrugën “Pjetër Bogdani” sipas rangut familjar. Shtëpia e Nadjës ishte një vilë e bukur me kopsht të lulëzuar dhe me shkallët e brendshme të shtruara me tapet vishnje. I ati ishte njeriu i tretë në Shqipëri për nga pushteti dhe dobësia e tij më e madhe ishte e bija.

Shtëpia ime vinte e dyta, ishte pjesë e një vile, por pa kopsht të lulëzuar. Im atë kishte pushtet të “rangut të dytë”, meqë ishte anëtar i Komitetit Qëndror. Të dy prindërit e mi u shkolluan pas martesë, babai në Moskë dhe mamaja studjoi drejtësi në USHT.

Natasha banonte në të njëjtën anë të rrugës me mua dhe hyrja e saj ishte pjesë e një pallati të madh të ndërtuar në kohën e Italisë. I ati ishte anëtar i Gjykatës së Lartë dhe kishte studiuar në Paris. E ëma nga ortodoksët e Kalasë së Elbasanit; dhe ajo e arsimuar diku jashtë. Me sa kisha kuptuar unë, i ati i saj ende ëndërronte jetën mondane të Parisit.

Mira banonte në një apartament në fund të rrugës, nga ato me tulla të kuqe, që ndërtoheshin në kohën e socializmit. Nuk e di pse ai apartament mbante gjithnjë erë fshati (këtë erë do ta ndeshja përsëri pas shumë vitesh, kur do të banoja vetë atje). Prindërit e saj ishin pa universitet, sikurse dhe ata të Nadjës, por në ndryshim me ta, nuk kishin pozitë të lartë. I ati, i vëllai i tij dhe të bijtë e tyre më pas, ishin ose u bënë fuksa. Prej miqësisë së ngushtë me Nadjën, në pozitë u ngrit e ëma. Ajo që e vetmja në familje që kishte sy të shuar. Gjithë të tjerët, duke përfshirë edhe Mirën, kishin ca sy që dukeshin sikur digjeshin përbrënda.

Vendi ynë i parapëlqyer për të mësuar dhe dëfryer ishte shtëpia e Natashës. Aty gatuhej më së miri, me bollëk dhe në fund të çdo ngrënjeje servirej djathë gjirokastre. Xhaxhai i saj banonte në Amerikë dhe ata s’vuajtën kurrë për para.

Shtatë vitet e shkollës mund t'i quash më të mirët e jetës sonë të përbashkët.

Natasha u nda nga grupi e para, fill pas fiksimit të asaj fotos në piknik, foto që mbeti i vetmi kujtim i përbashkët, iku pa dëshirën e saj. Iku sepse familja u shpërngul në Berat, ngaqë i ati pësoi një ulje në detyrë dhe në parti. Më saktë i ati i Natashës u përjashtua prej saj, u quajt element antiparti.

Me gjithë se Partia qe e para, e para në listë, madje para atdheut, para popullit, para vetë familjes, të quheshe **element antiparti** ishe më pak i dënuar se sa të quheshe **armik i popullit**. Sepse nuk qe tamam ashtu siç pretendohej, se në sistemin socialist rëndësi kishte përmbajtja dhe jo forma. Kishte rëndësi forma që ç'ke me të. Ishe me fat po të të vihej nofka e parë, si në rastin e prindërve të Natashës.

Ne të trija që mbetëm vazhduam gjimnazin "Petro Nini" në Tiranë, Natasha një gjimnaz në Berat.

Vajtja ne Universitet më ndau edhe mua, sepse unë fillova te studioja për fizikë, kurse Nadja me Miren per arkitekture.

Në Berat Natasha bënte një jetë më modeste se e mëparshmja, por një lloj jete të stabilizuar dhe me mirëqënie, jo si të gjithë të tjerët. I ati punonte si jurist në një ndërmarrje, e ëma mësuese, ajo vetë si gjithnjë e dalluar, kështu që edhe mund t'i dilte e drejta e studimit të lartë, por dënimi i të atit u rrinte si çomange mbi kokë dhe kjo punë ishte përsëri çështje fati.

Në ditët e para të shtatorit, vitin që filluam studimet e larta, e takova Natashën në shkallët e godinës qendrore të Universitetit Shtetëror të Tiranës. Kishte filluar studimet në arkitekturë, në të njëjtin grup me shoqet e vjetra të fëmijërisë.

Në fillim të vitit të dytë universitar, e takova përsëri Natashën, këtë herë në shkallët e fakultetit tim. Ajo kishte ndërruar degë, sepse nuk ia kish dalë dot as me arkitekturën, as me shoqet e vjetra që jo vetëm s'e shoqëronin më, por s'i jepnin as të njohur. Gojë e liga thoshin se Nadja qe kujdesur që Natasha të mos studionte as në të njëjtin grup me të.

Matematika, si degë e vështirë, konsiderohej më e përshtatshme për të deklasuarit e moderuar, sepse për të tjerët – për të ashtuquajturit armiq të popullit – studimi ishte absolutisht i ndaluar.

Në degën e matematikës, ku studioi për katër vjet, ajo jo vetëm nuk u dallua në mësimet si më parë, por edhe s'kishte ndonjë shoqëri të qëndrueshme. Nuk besoj, se ishte shkak dënimi i të atit, shokët i ruheshin diçkaje tjetër, diçkaje që u endej si tis dhe që unë e kuptova nga takimet e rastësishme që pata me të gjatë viteve të studimeve.

Fillova edhe unë ta shmang, sepse tek ne askush s'ishte imun në lidhje me statusin e vet politik. Të nesërmen mund të gdiheshe si pjesë e palës armiqësore me pushtetin, madje edhe për shkak të disa fjalëve të pamatura mirë.

Pas studimeve secila shkoi në punë të vet, pra u ndamë përfundimisht nga njëra-tjetra. Së paku kështu u duk fillimisht.

Mira u martua pa dashuri me një diplomat, shkoi me të jashtë shtetit dhe prej asaj kohe nuk u kthye më në Shqipëri, veçse për pushime.

Unë fillova punën shkencore, fillimisht në një institut studimesh, e më pas në Fakultetin ku kisha studiuar në Tiranë.

Nadja punoi si arkitekte e më pas edhe ajo në fakultetin respektiv në Tiranë.

Natasha u emërua në Berat mësuese matematike, deri në momentin që i vëllai u arrestua dhe dënua për “sabotazh”. Unë s’e pashë më për vite, por e dija se të paktën familja e saj nuk u zhvendos nga Berati në ndonjë fshat të largët, mbeti brenda në qytet, që mund ta konsiderojë përsëri fat pas gjyqit special që iu bë të vëllait. Të kishin pasur vallë mëshirë për t’ëmën e paralizuar? Nuk ishte zakon të mëshirohej e ëma e një “sabotatori”!

Takoheshim nganjëherë kur ajo vinte tek kushërinjtë në Tiranë, ishte plakur para kohe dhe ishte transformuar. Sa herë takohesha, bëhesha keq, jo vetëm se ajo tashmë ishte nga pala kundërshtare me pushtetin, por më linte një shije të hidhur, asaj nuk i besohej më për asgjë, gënjeshtra ishte bërë tipari i saj kryesor, përkundër gëzimit dhe humorit të rinisë së hershme.

Në vitin 1974 “u zbulua” grupi armiqësor në ushtri. Në atë kohë, im atë ishte gjeneral leitnant dhe drejtor i Institutit të Studimeve Ushtarake. Ishte ndër të parët në listë edhe për arsye të funksioneve në parti si anëtar i Komitetit Qëndror të saj.

Në librin tim, “*Vila me dy porta*”, përmes historisë së familjes sime përshkruhen shkurtimisht dënimet politike të grupeve të ndryshme të djathta e të majta që nga vendosja e pushtetit të komunistëve në Shqipëri, por kryesisht jam ndalur në atë që u quajt “fshesa e hekur”. Me anë të asaj fshese ushtrisë shqiptare iu bë një spastrim rrënjësor, duke dënua me pushkatim, dhe burgime të gjata oficerët nga grada major e lart. Ishte koha e lidhjes me Kinën dhe e ndikimit të revolucionit kulturor dhe në këtë kuadër u hoqën edhe gradat në ushtri. Ky qe një dënim i pashembullt si për nga përmasat njerëzore edhe ato familjare. Familja ime, si shumë të tjera, u fshinë prej kësaj fshese.

Çrrënjësja e njerëzve që dënoheshin nga vendbanimi i mëparshëm dhe vendosja në “mjedisin e ri” ishte organizuar me së miri. Dihej përshkallëzimi që pushteti kryente në raste të tilla. Kishte një skemë që funksiononte si sahat Omega dhe çdo hap i skemës matej me njësinë e këtij sahati, pra me orë.

Skema fillonte me mbledhje të thjeshta kolektivi dhe përfundonte me burgje apo internime. Dhe të gjitha këto ndodhnin në disa dhjetëra orë.

Në dhjetor të vitit 1974 familja ime u dëbua nga Tirana për në Berat. Në atë kohë unë vetë isha pedagoge në fakultetin e Shkencave të Natyrës, nënë e re me djalin një vjeç dhe me një burrë diplomat.

Brenda disa orësh u gjenda pa punë dhe pa shtëpi në Tiranë, por me një divorc politik dhe një fëmijë që qante pa pushim, plus urdhërit të prerë për t'u larguar brenda 24 orësh. Prej këtij momenti deri në kthimin tonë në Tiranë në vitin 1991, nuk do të kishte më urdhra për t'u larguar, por zhvendosje të organizuara me ushtarë të armatosur me automatikë.

Skenat e njerëzve që dëbohen nga kjo lloj ushtrie e vogël, do të më mbeten përherë nën lëkurë si diçka tronditëse, që i rijetoj pothuaj me të njëjtin intensitet sa herë më dilnin para sysh skena të ngjashme nga librat apo filmat.

Destinacioni im, si dhe i gjithë familjes sime, qe Berati.

E dinim se atje na priste Natasha, por në fakt ajo u bë e gjallë më përpara mbërritjes sonë atje. Kishte ardhur në Tiranë pak kohë pas dënimit të tim eti.

Do të isha përsëri me të atë vit që qëndruam në Berat dhe ato vitet e tjera të internimit në fshatin Kutalli. Vinte shpesh dhe sillej me shumë "dashuri", ndërsa ime më tmerrohej në këto raste duke ruajtur çdo tingull që nxirrim nga goja. Por nuk ia mbyllëm derën asnjëherë.

Në Kutalli qëndruam afro 5 vjet.

Nuk është ndonjë tmerr i madh të mësohesh pa jetën e kryeqytetit, të privohesh nga puna jote e dashur, nga miqtë, apo partneri, të mos kesh as një pikë rehatie dhe të jetosh në kushtet e mungesës së ujit, të ushqimeve primare, të jetosh në një hapësirë të ngushtë të kontrolluar pa ndalim nga mikrofonë të instaluar s'dihet se ku. Nuk është ndonjë tmerr të punosh 18-20 orë në fushatat e verës dhe disi më pak gjatë dimrin, të mos kesh asnjë ditë pushim dhe të paguhesh sa për të mbajtur frymën gjallë, të mos kesh mundësi të pish një kafe vetëm a me të tjerë, të harrosh ç'është shëtitja, ç'është deti, ç'janë gjithë ato çikërrima që përbëjnë shijen e jetës.

Vështirë ishte tjetër gjë. Vështirë ishte të mos dije t'u jepje përgjigje pyetjeve të fëmijës tënd të admirueshëm që rritej pa fëmijëri, vështirë ishte të shihje sytë e prindërve të tu që ndiheshin në faj për këtë situatë, vështirë ishte të mësoheshe me faktin se rinia jote po grisej copë-copë në ato vende të humbura, vështirë ishte të shihje vëllezërit dhe sidomos motrën, të voglën e fëmijëve, që nuk do të kishte asnjë mundësi të provonte dashurinë, e vështirë ishte mungesa totale e lirisë, por më e vështirë ende ishte pasiguria që pushteti të impononte në çdo rast dhe çast, se asgjë nuk është e jotja, as familja, as puna as banesa, as miqtë, as zakonet e vogla të përditshme, as ai status mjeran që të kanë dhënë, dëbimi, internimi, sepse ka edhe më keq, burgu, torturat, vdekja.

Vërtet, pas 5 vjetësh pati edhe më keq. Brenda një intervali të shkurtër kohe, pas një dite të lodhshme 20 orëshe në përpunimin e duhanit, plaçkat tona të përgjysmuara u vërvitën majë ca kamionëve *Skoda* dhe familja ime mori rrugën për në një destinacion të panjohur, por qartësisht të kuptueshëm, për në një vend më të largët dhe më të varfër. Ishim të rrethuar nga një ushtri e vogël ushtarësh të rinj, që mundoheshin më kot të egërsonin fytyrat e tyre.



Ishte një situatë groteske, sepse më besoni, me gjithë dëshpërimin e madh që na jepte kjo shpërngulje për më keq, me gjithë se lodhja dhe tensioni ishin në ekstrem, ne s'na mbetej tjetër gjë veçse të qeshnim.

Në fshatin ku u shpërngulëm, në kooperativën e Sheqezës, ku kishte gra që punonin zbathur edhe në dimër, qëndruam 11 vjet.

Këto vite Natasha nuk u pa asnjëherë. Por sapo mbëritëm në vendbanimin e ri s'e patëm aspak të vështirë për ta kuptuar se ajo ishte zëvendësuar me të tjera bashkëpunëtore të rekrutuara të Sigurimit të Shtetit nga komuniteti i të dënuarve tiranas, që kishin përfunduar atje para nesh.

Këto 11 vite, nga shoqet e mia të fëmijërisë dhe rinisë, pashë vetëm Nadjën, përmes televizorit në emisione apo rubrika, pasi ajo po ecte e sigurt në karrierën e nisur. Qe e vetmja që dukej e qetë në gjithë botën që na rrethonte. Mendoj se këtë status të paarrtshëm në socializëm, ia kishin siguruar prindërit me përpjekjet e tyre të pakufishme si puthadorës të diktatorit, cilësi që edhe ajo e kishte të mishëruar me kohë.

Mira ishte larg botës sonë, por e lidhur me fije të padukshme, që ia siguronte shoqja e saj e fuqishme.

Në librin tim "*Vila me dy porta*" ato nuk figurojnë askund, megjithëse në kujtimet e mia kishin mjaft vend. Ai pushtet ndërhyri deri tek memorja jonë duke ia zënë asaj hapësirën me të përditshmen imponuese. Figuron vetëm Tasha pa mbiemër dhe pikërisht me këtë emër të shkurtuar, figuron ajo nga që pushteti na armiqësoi duke na vënë përballë.

Megjithatë dhe megjithëse jam munduar të fal sa më shumë, në këtë rast do arsyetoj në mënyrë krejtësisht ekzistenciale:

*Gjithkush është i lirë të zgjedhë. Të zgjedhë të jetojë i poshtëruar edhe nga punonjësi më i parëndësishëm i sigurimit, veçse për të siguruar një komoditet minimal, apo të jetojë në mizerabilitet, ndoshta edhe në burg, por pa e ndier këtë poshtërim. Pati që zgjodhën të dytën dhe unë jam plotësisht me ta*

Në vitin 1991 pas rënies së Murit të Berlinit dhe gjithë ndryshimeve që pasuan në botë, unë u ktheva në Tiranë së bashku me familjen time dhe pata fatin të rifilloj punën në atë institut studimesh, ku kisha filluar punën për herë të parë.

Filloi për mua dhe të tjerët si unë një kohë e trazuar, me vështirësi të panumërta si ekonomike apo të strehimit, ashtu edhe të tjera po aq të rëndësishme si të ndodheshe pa asnjë pikë orientimi për të tashmen dhe të ardhmen. Ishim të gjithë si ca të shpëtuar nga anija e mbytur në një breg të panjohur. Por jo vetëm ne, ishim kështu pak a shumë të gjithë ne shqiptarët, veçse ne të porsakthyerit, sapo kishim dalë nga një sëmundje pa shpresë shërimi.

Në një nga intermexot e librit tim e kam shprehur kështu këtë gjëndje:

*Mbaj mënd një natë, fund dimri, fillim pranvere te vitit 1991. Isha në këmbë tek Zogu i Zi, në rrugë, e shkujdesur, kur po e shihja qartë se një qime më ndante nga një makinë që vinte drejt meje me shpejtësi. Në çast po mendohesha ta shmangia apo të futesha në rrotat e saj, nga që para syve të mëndjes më doli e qartë pamja e një lufte të re po aq të gjatë, që më duhej të përballoja në vitet që do të vinin, për t'u përfshirë në vorbullën e jetës që sapo kishim filluar përsëri në Tiranë. Isha përballë kësaj dileme nga që ndihesha shumë e lodhur nga beteja që sapo kishte përfunduar dhe aspak e sigurt se do t'ia dilja mbanë një beteje tjetër që një Zot e dinte sa e vështirë dhe sa të papritura do të kishte. Atë natë kuptova se nuk do t'u dorëzohesha kurrë joshjeve të vdekjes që janë shumë më të fuqishme se ato të dashurisë, nga që janë edhe më të rralla dhe të godasin, kur ti je e çmobilizuar.*

Këtu del sërish në skenë Natasha. Nga xhaxhai i saj amerikan kishte trashëguar një vilë njëkatëshe me kopsht, një oaz të vërtetë qetësie dhe mirëqenije. Por ajo s'ë pasqyronte aspak këtë gjëndje. Ishte mbledhur një grusht, qeshte po jo si në rininë e hershme, më mirë të them ngërdheshej, por jo nga gëzimi i jetës, tani gëzohej nga disa barcaleta banale dhe kishte filluar të pinte pa masë.

Vendosa të mos e takoj më. Sepse pikërisht kësaj radhe u binda përfundimisht për dyshimet e vjetra, por e lashë me kaq, s'kërkova të rrëmoja në arkiva. Tek ne nuk u hapën kurrë ato arkiva, megjithëse prej tyre kanë rrjedhur shumë të dhëna që qarkullojnë dhe përdoren rast pas rasti.

Unë pata fatin e mirë apo të keq, nuk di ta përcaktoj, që të më bjerë në dorë dosja ime jo e plotë, por e lidhur vetëm me deponimet e Natashës gjatë viteve. E njoha menjëherë shkrimin dhe firmën e saj. Më besoni m'u desh një javë e mirë të merrja veten. Nuk qe problemi i tekstit të gjatë, por i fundit të tij ku shkruhej qartas një konkluzion për të tre ne "miqtë e saj": mua dhe vëllezërit e mi. Ajo shkruante:

Konkluzioni im është se: "*Pranvera Bekteshi, Guxim Bekteshi dhe Skënder Bekteshi janë, armiq të betuar të Partisë dhe të Pushtetit Popullor.*" Kishte kursyer vetëm të voglën, Zanën.

Këtë fakt e kam paraqitur edhe në librin tim që shkrova pas 19 vitesh kthimi, atëherë kur ujërat u "qetësuan" dhe gurët zunë vend, nëse gurët mund të zenë vend ndonjëherë.

Të tria shoqet e mia e lexuan atë.

Nadja më takoi në rrugë dhe me atë ëmbëlsinë që s'ë humbi asnjëherë, më bëri shumë lëvdata. Mira, sipas saj, kishte të njëjtin mendim për librin.

Tashës ia dërguan kushërinjtë në SHBA, ku ajo jeton. Ajo nuk tregoi asnjë shenjë pakënaqësie, veçse tha se kishte qenë e detyruar të jepte atë konkluzion në fund të deponimeve të veta. Dhe se ajo kishte për të rrëfyer shumë më tepër se unë. E besoj, por ç'pret, do ishte mirë t'i shkruante ato për veten dhe ne të gjithë.

Romanin tim autobiografik fare mirë mund ta kisha paraqitur si fikshën duke e ndryshuar pakëz, duke mos dhënë emrat realë si dhe vendet dhe ngjarjet, por t'i lija të njëjtën strukturë. Parapëlqeva ta paraqes ashtu për të shërbyer si një dëshmi, edhe duke e ditur mirë se do të kishte reaksion, siç edhe pati. Por nuk erdhi nga e prisja, erdhi prej atyre që mendoja se në heshtje do të më falënderonin.

Në kapitullin më të gjatë të librit, unë përshkruaj fqinjët që ishin kryesisht familje tiranase të internuara si ne. Kam bindjen se libri do të kishte më tepër vlerë nëse do të kisha dhënë me vërtetësi të plotë marrëdhëniet tona komplekse në ato vite në fshat. Nuk e bëra, duke menduar t'i ruaj, që ata njerëz të mos vuanin përsëri. I preka gjatë përshkrimit paksa “me pupël”, siç thuhet.

Pikërisht ato u treguan më të egrat. U organizuan grusht, pas shumë vitesh mërie me njëra-tjetrën veçse për një “qëllim të lartë”, për të më dënuar – mundësisht me burg – ngaqë kisha nxjerrë intimitetet e tyre. Ato intimitete që nuk u zbuluan kurrë në libër, por që i dinte e gjithë kooperativa e më pas e gjithë bota që i njihte.

Ky është një shembull, edhe për mua vetë, se nëse do të denoncosh të keqen, duhet ta bësh atë deri në fund, sepse përndryshe kjo e keqe ngrihet për të të dhunuar sërisht.

Po me dy shoqet e tjera, ç'ndodhi pas vitit 1991?

Mira qëndroi në Kinë, ku i shoqi dhe ajo nga diplomatë u konvertuan në tregtarë të zotë dhe tani jeton me fëmijët, diku në Australi. Natasha iku ne Amerikë tek xhaxhai i pasur dhe jeton atje. Nadja, u largua nga Shqipëria nga frika se mund të ndiqej penalisht, dhe pasi u fsheh disa kohë jashtë vendit – ca thonë në Brazil, ca në një nga vendet arabe – ku me ndihmën e Mirës u mor ca kohë me tregëti, u kthye sërish në Shqipëri, ku vazhdon karrierën si dekanë në një prej universiteteve private.

Unë punoj si eksperte mjedisi në Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe po shkruaj historinë tonë e të tjera histori.

Më vjen në mend shpesh herë pyetja:

A jemi ne të kthyerit nga burgjet dhe internimet si plaku në brigjet e Karaibeve në Kubë, që kthehet me skeletin e peshkut të madh, pasi ka mundur tërbimin e detit dhe të gjallesave të saj? A ndihemi ne si ai?

Do të ishte mirë të ndiheshe si ai dhe ta kaloje pleqërinë me kujtimin se të paktën kemi arritur një fitore morale mbi të keqen.

Për vete e lakmoj atë gjendje, e kam fjalën për statusin e pensionistit, që po mundohem ta shtyj sa më shumë, madje kam frikë se nuk do ta arrij kurrë. Sepse pleqëria është mirë të gëzohet, është një moshë e pëlqyeshme nga që s'ke nevojë të shtiresh. Kam frikë se nuk do ta arrij kurrë atë, sepse më duhet të zëvendësoj vitet e humbura.

Djali im i brishtë, tashmë i mbyllur me librat dhe muzikën e tij, përjeton ende pasojën e atij makthi që zgjati 17 vjet. Ai kërkon ndihmë për të dalë, por deri

tani kam qënë e pafuqishme t'ia jap. Por një gjë e di fort mirë, se nuk do të rresht së përpjekuri, se do të mundohem ta gjej forcën për të mos u dorëzuar, duke shpresuar se do të vijë dita, kur edhe ai ta gëzojë jetën me të mirat dhe vështirësitë e saj.



## SISTEMI I DREJTËSISË PENALE NË SHQIPËRINË KOMUNISTE 1945 – 1990

Ina Rama

Gjatë periudhës 1945 – 1990 nën regjimin totalitar, në Shqipëri e drejta penale pozitive (legjislacioni), doktrina e së drejtës penale, kriminologjia si dhe i tërë sistemi i drejtësisë penale ishin në shërbim të politikës së partisë –shtet.

Gjithsesi fillesat e sistemit të mëvonshëm të drejtësisë së diktaturës të proletariatit u dukën që në kohën e luftës partizane. Gjatë kësaj kohe edhe pse strukturat gjyqësore shtetërore të krijuara që nga viti 1921 pas Kongresit të Lushnjës, megjithë pushtimin, vazhdonin të ekzitonin, partizanët kishin krijuar të ashtuquajturat gjyqe partizane, që merreshin me gjykimin e rasteve të tradhëtisë, të dezertimeve, të imoralitetit, të plaçkitjes, të vjedhjeve, të vrasjeve si dhe krimet e drejtuara kundër Luftës Nacionalçlirimtare. Me pak modifikime këto vepra penale, vazhduan të ishin edhe pjesë e së drejtës penale në Shqipërinë diktatoriale edhe pas çlirimit të vendit.

### Fillimet e arbitraritetit në sistemin e drejtësisë

Pak para çlirimit të Shqipërisë Komanda e Përgjithshme e Ushtrisë Nacionalçlirimtare miratoi më 16 nëntor 1944 “Rregulloren mbi funksionimin e gjykatave ushtarake dhe kompetencat e tyre”. Sipas kësaj rregulloreje gjyqtari nuk ishte i lidhur detyrimisht me provat, por e jepte vendimin sipas mendimit të tij të lirë, ose thënë më qartë, në mënyrë arbitrare.

Po ashtu vendimet, me përjashtim të atyre me vdekje, ishin të paankimueshme. Në rastet e vendimeve me vdekje çështja i dërgohej Gjyqit të Lartë Ushtarak.

Kjo procedurë u ruajt edhe pas ardhjes në pushtet të komunistëve, të cilët, përcaktuan shumë shpejt edhe se cilët ishin të ashtuquajturit armiq të popullit: Anëtarët e Ballit Kombëtar, apo të Legalitetit, ish-pronarët e mëdhenj dhe të mesëm, shumë prej intelektualëve, që kishin studiuar jashtë shtetit dhe persona të tjerë, të cilët mendohej se mund t’i kundërviheshin regjimit.

Vetëm në maj të vitit 1945 u miratua Ligji për Organizimin e Përkohshëm Gjyqësor dhe u krijuan të ashtuquajturat gjykata popullore, të cilat gjykonin si çështjet penale edhe ato civile dhe ushtarake. Bashkë me to u krijuan edhe

gjykatat e prefekturave, të cilat gjykonin apelet ndaj vendimeve të gjykatave të nënprefekturave si dhe Gjykata e Lartë.

## Riorganizimi i sistemit gjyqësor

Në vazhden e përpjekjeve për krijimin e një sistemi drejtësie krejtësisht në shërbim të partisë në pushtet dhe të diktaturës së saj, në vitin 1951 fillon riorganizimi i sistemit gjyqësor. Në këtë kohë bëhet ndarja e gjykatave ushtarake nga ato civile dhe fillon zgjedhja e gjyqtarëve dhe e ndihmësgjyqtarëve nga populli.

Më pas, në vitin 1953, miratohet edhe Kodi i Procedures Penale. Po ashtu gjatë kësaj periudhe miratohet edhe një ligj i ri për avokatinë, i cili zëvendëson ata të mëparshmit.

Sipas rregullave të vendosura nga ky kod ndjekja penale ushtrohej nga prokurori, i cili bën vetë hetime dhe ndihmohet nga organet e gjurmimit për kryerjen e veprimeve të ngutshme. Në zbatim të normave të këtij kodi, krimet kundër shtetit hetoheshin në këtë periudhë nga hetuesia e Sigurimit të Shtetit, e cila “kontrollohej” nga prokurori, dhe gjykoheshin nga gjykatat ushtarake.

## Masa tejet represive ndaj krimeve kundër shtetit

Në vitin 1952 u miratua edhe Kodi Penal, i cili parashikonte në pjesën e tij të përgjithshme institutet e së drejtës penale materiale dhe në pjesën e posaçme veprat penale konkrete të dënueshme sipas këtij legjislacioni.

Që në pjesën e përgjithshme të këtij kodi, në të cilën parashikohen llojet e dënimit të njohura nga ky legjislacion, shpalolet qëndrimi ekstremisht represiv i pushtetit ndaj krimeve kundër shtetit.

Në nenin 18 të Kodit Penal parashikohet që dënimi me vdekje jepet vetëm për krimet kundër shtetit dhe për krimet e tjera veçanërisht të rrezikshme. Ndëshkimi kapital i legjislacionit shpallet në këto parime se është vendosur aty pikërisht për të ndëshkuar këtë kategori veprash penale. Po në këtë pjesë parashikohet gjithashtu rregulli përjashtues se qoftë ndjekja penale, qoftë ekzekutimi i një vendimi për një krim kundër shtetit, nuk ishin të parashkrueshme.

Këto parime gjejnë më pas pasqyrim në pjesën e posaçme të kodit në të cilën parashikohen krimet kundër shtetit. Në këtë kapitull parashikohen si vepra penale të kryera kundër shtetit: tradhëtia ndaj atdheut (neni 64), spiunazhi (neni 65), provokimi i luftës ose prerjes së marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Shqipërisë (neni 66), veprat terroriste (neni 67), veprat terroriste kundër përfaqësuesve të shteteve të huaja (neni 68), organizimi dhe pjesëmarrja në banda të armatosura (neni 69), diversioni (neni 70), gjenocidi (neni 71), sabotimi (neni 72), agjitacioni dhe propaganda (neni 73), nxitja e urrejtjes ose e grindjeve mes

kombësive (neni 74), propaganda e luftës (neni 75) pjesëmarrja në një organizatë kundër pushtetit popullor (neni 76), veprimtaria armiqësore para çlirimit (neni 77). Po ashtu ishin të dënueshme edhe çdo lloj veprimtarish armiqësore kundër Bashkimit Sovjetik apo çdo shteti demokratik popullor.

Të gjitha këto vepra penale konsideroheshin njësoj të dënueshme për sa u përket marzheve të parashikuara të dënimit. Masa e dënimit për këto vepra parashikohej të ishte jo më pak se dhjetë vjet heqje lirie, apo dënim me vdekje, dhe kurdoherë shoqëruar edhe me konfiskim të pasurisë.

Një trajtim me të njëjtën frymë të ashpër vihet re edhe në veprat penale të parashikuara në kapitullin e krimeve kundër pasurisë shtetërore ose shoqërore, duke qenë se edhe ky lloj aktiviteti konsiderohej jo thjesht si një aktivitet kriminal ordiner i drejtuar drejt pasurisë, por i drejtuar gjithashtu drejt dëmtimit dhe goditjes së vetë shtetit demokratik popullor.

## Shndërrimi i drejtësisë në vegël të mirëfilltë në duart e regjimit

Vitet në vazhdim janë vitet e “revolucionarizimit” të sistemit të drejtësisë, po të flasim me gjuhën e asaj kohe, apo më saktë të largimit të saj edhe më shumë nga ajo që mund të quhet drejtësi. Në këtë periudhë kemi pra shndërrimin e këtij sistemi në një vegël të mirëfilltë në duart e partisë – shtet.

Me ligjin nr. 4406 dt. 24.06.1968 “Për Organizimin Gjqësor të RPSH-së” përveç ristrukturimit të sistemit të gjykatave, përmes masave të tilla si krijimit të gjykatave të lagjeve dhe të qyteteve, që gjykonin vepra me rëndësi të vogël dhe të thjeshta, suprimohet gjykimi në shkallë të dytë, i cili i kalohet Gjykatës së Lartë.

Në vitin 1966 suprimohet Ministria e Drejtësisë dhe funksionet e saj i kalojnë po ashtu Gjykatës së Lartë. Në vazhdim të uzurpimit të sistemit të drejtësisë prej diktaturës, në vitin 1967 me dekretin nr. 4277, suprimohet institucioni i avokatisë me arsyetimin se ai qe një institucion i panevojshëm, i cili nuk ndihmonte por pengonte zgjidhjen e çështjeve.

Filozofia e kohës që shoqëroi suprimimin e avokatisë ishte që “drejtësia popullore” garantonte një paanshmëri të tillë që prokurori edhe akuzonte edhe e mbronte njëkohësisht të akuzuarin dhe se gjykatësi ishte gjithashtu në mbrojtje të tij.

## Ashpërsimi i mëtejshëm i sanksioneve penale në vitet 1970-1980

Nëse dikush mendon se me këto hapa sistemi i drejtësisë penale i ishte nënshtuar tashmë krejtësisht diktaturës së proletariatit, gabohet, sepse ky nënshtim nuk mbaron me kaq. Të gjithë hapat dhe vendimet e mësipërme ishin hapa në shërbim

të hapjes rrugës për miratimin e Kodit të Procedurës Penale dhe të Kodit të ri Penal që hynë në fuqi respektivisht në vitet 1980 dhe 1981. Këto sigurisht u miratuan nën frymën e re revolucionare të sanksionuar nga Kushtetuta e vitit 1976.

Pas daljes së Kushtetutës së vitit 1976, drejtësia penale në Shqipërinë komuniste mori një drejtim të ashpër. U thellua karakteri klasor i shtetit të diktaturës së proletariatit dhe në bazë të kësaj politike u ndërtuan kodet e lartpërmendura, në plan të parë të cilave ishin krimet politike dhe ashpërsimi i sanksioneve penale.

Kodi i Procedurës Penale i vitit 1980 sanksionoi parimet revolucionare të legjislacionit procedural penal, të udhëheqjes nga politika e partisë, e luftës së klasave dhe nga vija e masave, parime këto të shprehura në nenet 2 dhe 4 të kodit. Ndryshe nga të gjitha kodet e procedurës penale të çdo sistemi dhe modeli, ky kod shpalli varësinë e gjykatës nga politika, i hoqi prokurorit të drejtën e ushtrimit të ndjekjes penale, mohoi mbrojtjen me avokat dhe rikonfirmoi të drejtën e prokurorit për vendosjen e masave të sigurimit, pa u kontrolluar nga gjykata.

Në këtë kod nuk u njohën as formalisht parimet demokratike të prezumimit të pafajësisë, të barazisë së palëve, të oralitetit të procesit e të tjera si këto. Në zbatim të Kodit të Procedurës Penale (1980), ndjekja penale ushtrohej nga organet e hetuesisë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që përbëheshin nga sektorët e hetuesisë në rrethe dhe nga drejtoria në ministri. Kjo strukturë kishte hierarki të brendshme dhe ishte e pavarur nga prokurori.

Paralelisht me kufizimet që solli Kodi i Procedurës Penale me normat e procedurës dhe deformimin në ekstrem të rregullave të një procesi demokratik, ashpërsimi i politikës penale u ndie gjithashtu edhe në dispozitat e Kodit Penal, të miratuara nën këtë frymë.

## Kod Penal me efekte terrorizuese

Në mënyrë të veçantë zgjerohet së tepërmi koncepti i krimit të tradhëtisë ndaj atdheut, duke e shpallur atë si krimin më të rëndë që mund të kryejë shtetasi i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Elementet e anës objektive të këtij krimi zgjerohen së tepërmi duke e bërë lehtësisht të konsiderueshme kryerjen e kësaj vepre, çdo herë që një aktivitet do të konsiderohej si i papëlqyer nga shteti. Kjo normë lexohet si represive dhe përfaqësuese e mirëfilltë e ashpërsimit të luftës së klasave në këtë periudhë.

Me nota ekstremisht represive dhe kundër çdo sistemi rehabilitues të dënimeve penale dallohet në këtë kod futja e një dispozite të re që ndëshkon jo vetëm armikun e klasës, por edhe atë që e përkrah atë. Neni 59 i Kodit parashikon si vepër penale përkrahjen pas kryerjes së krimit kundër shtetit që i bëhet autorit



të këtij krimi. Sigurisht që veshja me formatin e një vepre penale të një aktiviteti të tillë, është konsideruar dhe konsiderohet krim përgjithësisht nga të gjitha sistemet e së drejtës, ajo që është veçanërisht represive në këtë rast, është pikërisht sanksioni penal i parashikuar, i cili luhatet mes marzheve nga jo më pak se pesë vjet heqje lirie deri edhe me vdekje. Lexohet krejtësisht si një normë me efekte terrorizuese, që shtrihet mbi të gjithë popullsinë, shprehje e plotë e një sistemi totalitar ku të drejtat dhe liritë e individit janë krejtësisht të papërfillshme, krahasuar me qëllimin e mbajtjes së pushtetit me çdo kusht e me çdo mënyrë.

Të njëjtën frymë gjejmë edhe tek nenet 111 e 112 të Kodit Penal të cilat parashikojnë veprat penale të përkrahjes pas kryerjes së krimit dhe të moskallëzimit të krimit, të shoqëruara me sanksione të ashpra penale të pajustificuara për natyrën e kriminalitetit që këto vepra penale përfaqësojnë dhe aq më tepër për rrezikshmërinë shoqërore të vetë autorëve të tyre.

I njëjti nivel ndëshkueshmërie vazhdon të ruhet përgjithësisht edhe për krimet ndaj pasurisë socialiste, në lidhje me të cilat për raste të caktuara – që konsideroheshin si me pasoja të rënda – parashikoheshin edhe dënime me vdekje.

## Vendime gjyqësore si fjalime politike

Përveç parashikimeve ligjore e normave penale në fuqi që demonstrojnë të gjithë politikën e partisë – shtet si dhe ideologjinë marksiste-leniniste të mbështetur plotësisht në teorinë sovjetike të së drejtës penale, natyra politike e vendimmarrjes, ishte gjithashtu lehtësisht e lexueshme edhe në aktet procedurale të prodhuara në këtë kohë.

Subjektet e procedimit penal gjatë regjimit totalitar ndesheshin me sfida të mëdha, pengesa e kufizime të shumta politike, ideologjike e dogmatike. E gjithë kjo filozofi pasqyrohej qartazi në aktet e prodhuara në këtë kohë nga hetues, prokurorë apo gjyqtarë. Vendimet gjyqësore dukeshin më shumë si fjalimet politike të kohës që ndëshkonin politikisht aktivitetin armiqësor, sesa si akte të mirëfillta juridike me elementet e tyre të nevojshme të së drejtës procedurale e asaj materiale.

## Ndryshimet kozmetike pas viteve 80-të

Deri në vitin 1990, kur pësoi kthesën thelbësore në drejtim të parimeve mbi të cilat ishte ndërtuar, i gjithë sistemi i drejtësisë në Shqipëri iu nënshtrua gjatë viteve '80 disa ndryshimeve graduale.

Në vitin 1983 me ligjin 6801 iu njoh e drejta prokurorit për të kontrolluar

hetimet. Duhet thënë se deri në këtë kohë roli i prokurorit në procesin gjyqësor ishte kryesisht demaskues, pasi roli vendimtar i zhvillimit të hetimeve dhe i ngritjes së akuzave u përkiste organeve të hetuesisë. Në vitin 1987 nëpërmjet dekretit 7177, u përmirësua pozita e prokurorit përmes njohjes së disa të drejtave të tjera procedurale, si fillimi i çështjes penale, ndalimi i saj, miratimi i vendimit të mosfillimit të çështjes penale, të pushimit dhe të pezullimit të çështjes, ndalimi i veprimeve të paligjshme të hetuesit dhe marrja e masave për të ndrequr padrejtësi të shkaktuara për shkak të shkeljes së ligjit.

Këto ndryshime u shoqëruan edhe me ndryshime në organizimin e sistemit gjyqësor si zëvendësimin e këshillave gjyqësore me gjykata të shkallëve të dyta, njohjen e kompetencave Gjykatës së Lartë që të shqyrtojë ankimet ndaj vendimeve për krimet kundër shtetit apo të dënimeve me vdekje.

Gjithsesi ky proces reformimi i sistemit të drejtësisë penale që konstatohet, nuk ka të bëjë me ndryshime reale në drejtim të demokratizimit të sistemit të drejtësisë në përgjithësi e të së drejtës penale në mënyrë të veçantë, por ka të bëjë vetëm me aspektin formal, pasi në të vërtetën e së përditshmes nuk mund të thuhet se kjo frymë më moderatore u reflektua ekzakhtësisht.

## Dënimet dhe dëmshpërbimet

Pas viteve 1990-të janë bërë publike shifra të ndryshme në lidhje me dënimet gjatë periudhës komuniste. Sipas të dhënave të nxjerra nga Arkivi Qendror i Shtetit rezultojnë këto shifra:

- U ekzekutuan për motive politike 5.037 meshkuj dhe 450 femra,
- U dënuan me heqje lirie 16.788 meshkuj dhe 7.367 femra,
- U internuan 48.217 meshkuj dhe 10.792 femra,
- U dëbuan nga qytetet kryesore dhe nga zonat kufitare 11.536 familje,
- U pushkatuan apo vdiqën në burgjet shqiptare 64 shtetas të huaj dhe u burgosën 1.223 syresh, 1.215 meshkuj dhe 38 femra,
- U pushkatuan 95 kosovarë, që gjendeshin në Shqipëri.

Në zbatim të Ligjit 9831/2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë nga regjimi komunist” janë regjistruar rreth 20.264 kërkesa për përfitimin e këtij dëmshpërblimi nga ish të dënuarit politikë apo familjarët e viktimave të ekzekutuar apo të pushkatuar padrejtësisht për motive politike, me dhe pa gjyq.

Nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9831/2007 deri aktualisht janë miratuar nëntë lista me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) që përmbajnë rreth 6.541 emra të ish të dënuarve politikë.

VKM-të e mësipërme kanë miratuar dëmshpërblimin financiar për ish të dënuarit politikë, të cilët kanë vuajtur dënim me burg dhe dënim kapital. Nuk janë

përfshirë në këto lista ish të dënuarit politikë të cilët kanë vuajtur internim, dhe të cilët përfitojnë një skemë pensioni në pritje të VKM-së e cila duhet të hartohet nga Ministria e Financave, si dhe familjarët e viktimave të pushkatuar për motive politike pa gjyq, për të cilët pritet një VKM, që do të përcaktojë mënyrën e shqyrtimit administrativ dhe masën e dëmshpërblimit për këtë kategori.

Mbyllja me drejtësi e këtij procesi mendoj se është një detyrim bazë i shtetit demokratik të së drejtës, karshi shtetasve të tyre të ndëshkuar padrejtësisht për shkak të qënies në fuqi të një regjimi totalitar.

## SUNDIMI I TEJSKAJSHËM I SHOQËRISË, “PATOLOGJIA” E AKULTURACIONIT SI PARADIGMË ZOTËRUESE DHE FORMAT E REFUZIMIT TË SAJ NË SHQIPËRINË TOTALITARE

As. Prof. Dr. Adem Jakllari

Në fushën e antropologjisë kulturore janë të njohura konceptet e dijetarëve gjermanë, por edhe atyre anglezë për rolin e reduktuar që luan distanca gjeografike për përhapjen e modeleve dhe të sjelljeve kulturore nga një etni në një tjetër; dhe kjo falë aftësisë tepër elokvente që ka njeriu, nëpërmjet së cilës realitetet kulturore dhe modelet strukturore – simbolike të tyre, përhapen më shpejt sesa përsëriten.

Edhe kultura shqiptare ka dëshmuar në prerjen e saj diakronike dhe sinkronike se ka qenë e përfshirë në lëvizjen globale të qarkullimit të modeleve gjeneruese dhe të simbolikave themelore. Ajo ka ekzistuar dhe funksionuar si një kulturë që gjenetikisht dhe strukturalisht nuk ka vuajtur nga dukuria e akulturacionit. Teza të tilla që e kanë klasifikuar kulturën shqiptare si të prekur nga sindroma e akulturacionit, nuk mund t’i qëndrojnë së vërtetës, sepse në rrafsh tipologjik dhe stilistik kjo kulturë dëshmon për aftësitë e saj komunikuese dhe absorbuese të modeleve që kanë ardhur dhe vijnë qoftë nga qendra e sistemit universal, qoftë nga nivelet e tjera. Shenjat dhe kumtet e asaj të cilat Umberto Eco (1997: 47) e quan “biblioteka universale” ne i gjejmë jo vetëm në veprat përfaqësuese të kulturës materiale dhe shpirtërore, por edhe në sjelljet dhe konceptet bazë të njerëzve të thjeshtë.

E vetmja periudhë e historisë shqiptare në të cilën u shfaqën dukshëm shenjat e “patologjisë” së akulturacionit, është ajo e diktaturës komuniste. Këto shenja nuk erdhën nga brenda sistemit kulturor shqiptar, që ndërkaq historikisht kishte provuar të kundërtën, por u bënë detyruese nëpërmjet dogmës dhe kanoneve teorike dhe institucioneve ideologjike. Edward Said shkruan:

*“Mendoj se shumica e studiuesve të fushave humanistike janë plotësisht të kënaqur me nocionin se tekstet ekzistojnë në kontekste, se ka diçka që quhet ndërtekstorësi, se trysnitë e konvencioneve, paraardhësve dhe të stileve retorike e kufizojnë atë çka Walter Benjamini dikur e ka quajtur “mbitaksimin e personit prodhues në emër të parimit të krijimtarisë”, në të cilin poeti beson se e ka sjellë në dritë veprën e tij nga vetja dhe e nxjerr prej mendjes së vet të pastër”. (Said 2009: 36)*



## Dikotomia antagoniste: Ne dhe armiku

Në Shqipërinë totalitare trysnia e konvencioneve ideologjike dhe stili retorik e zotërojnë në nivel institucional, tërësisht, jetën shpirtërore shqiptare, duke ndërtuar dikotominë ne dhe “armiku ideologjik borgjezo-revizionist”. Konvencioni zotërues i tjetrit si armik e ndërpret komunikimin kulturor dhe simbolik, veçanërisht me kulturën dhe ligjërimin filozofik-artistik.

Klima despotike e totalitarizmit komunist i shtypi subjektit krijues shqiptar disa prej hipostazave shpirtërore më të forta dhe më me fuqi krijuese. Despotizmi komunist, duke zbatuar në fushën e kulturës parimin e partishmërisë proletare, përjashtoi nga sistemi i komunikimit pjesën kryesore të kulturës dhe të letërsisë botërore të shekullit XX. Institucionet ideologjike, që sunduan për gati një gjysmë shekulli jetën e shqiptarëve, e vunë universin tonë kulturor në kushtet më të pavaforshme të zhvillimit të tij. Proceset natyrore të akulturimit dhe të transkulturimit, nëpër të cilat kanë kaluar historikisht kulturat rajonale, pushteti totalitar me institucionet e veta ideologjike i zëvendësoi, gjatë kohës së sundimit të tij, me trysnitë e forta për ta detyruar shoqërinë shqiptare në nivel kapilaresk të pranonte mungesën e dialogut me kulturën dhe sistemet e komunikimit modern evropian, dhe më gjerë.

## Izolimi dhe pasojat e tij

Nën diktaturën komuniste kultura shpirtërore shqiptare iu nënshtrua një izolimi të egër. Për pasojë, ajo humbi shumë nga vetitë e komunikimit me kulturat e vendeve të tjera. Mungesa e kontakteve dhe e ballafaqimeve kulturore me vendet e tjera të kontinentit tonë dhe më gjerë, i solli kulturës shpirtërore shqiptare bjerrjen dhe tkurrjen e shumë vetive dhe aftësive krijuese.

Pasojat e kësaj dukurie qenë të rënda aq më tepër, sepse ky izolim ndodhi në shekullin XX, në kohën kur kultura perëndimore përjetoi zhvillime të fuqishme shndërruese drejt modernitetit. Institucionet ideologjike dhe dogma komuniste ngritën kultin e primatit të letërsisë dhe të artit të faktit, tezë të cilën Majakovski e kishte parashtruar që në vitin 1928.<sup>1</sup> Primati i letërsisë së faktit e izoloj letërsinë tonë nga zhvillimet inovuese; nga karakteri i theksuar abstragues dhe zhvillimet e vrullshme në poetikë dhe strukturë që përjetoi letërsia, muzika, piktura dhe format e tjera të komunikimit estetik në gjysmën e dytë të shekullit XX.

---

<sup>1</sup> Shih Zalambani 2003: 49-53

Perëndimi, me të gjithë sistemin e tij të vlerave, u vlerësua dhe u interpretua nga ideologjia dhe estetika zyrtare e kohës së totalitarizmit komunist si tërësisht armiqësore dhe që sundohej nga antivlerat. Dikotomia me artin dhe kulturën perëndimore; madje lufta kundër tyre u shndërrua në paradigme zotëruese.

Në rrafsh sinkronik, kultura jonë u ballafaqua me rrezikun real të përveçimit nga zhvillimet kulturore të botës: paradigma që u bë sunduese, një paradigmë mirëfilli e “patologjisë” së akulturacionit, që nuk kishte asgjë të përbashkët me qytetërimin modern të shekullit XX, e la në harresë individin, ndjenjat dhe shpirtin e tij, duke u kushtuar më shumë vëmendje zhvillimeve të jetës materiale, pra të ashtuquajturit revolucion tekniko-shkencor.

## Art në shërbim të dogmës politike dhe ideologjike

Mjaft poema u thurën për të glonorifikuar peizazhin e sukseseve komuniste. Këto poema vuanin nga skematizmi dhe ishin tërësisht cerebrale, larg artit të vërtetë. Po kështu ndodhi dhe me një pjesë të madhe të romanit, pikturës dhe muzikës. Kjo krijimtari nuk ngrihej më mbi parimet e mirëfillta estetike, por mbi parimet dhe dogmat politike dhe ideologjike. Si rrjedhojë e stadi të patologjisë së akulturacionit, në të cilën u gjend shoqëria shqiptare, edhe kultura iu nënshtrua jo prirjes së saj gjenetike për të krijuar vlera të qëndrueshme, por servilizmit për të fituar në çdo rast mbështetjen dhe aprovimin e partisë dhe të diktatorit. Në këtë humnerë me pasoja vdekjeprurëse u përfshinë disa struktura mirëfilli krijuese si letërsia, muzika, teatri, etj. Kjo solli me vete humbjen e vlerave të mirëfillta artistike dhe i la këto forma të artit dhe kulturës jashtë proceseve konkurruese dhe integruese.

Për shkak të karakterit tejet detyrues që patën parimet e krijimtarisë artistike dhe jeta kulturore në përgjithësi; si dhe për shkak se nën pushtetin e “patologjisë” së akulturacionit ishte edhe receptuesi, arti dhe letërsia shqiptare, në shumicën e rasteve u paraqitën më tepër si forma të propogandës dhe të publicistikës sesa si forma të njëmendëta të rikrijimit estetik të botës. Për më tej, disa prej këtyre formave, iu kthyen modeleve të vjetra të imitimit dhe të përshtatjes, pa kryer më parë filtrimin përzgjedhës dhe krijues. Ndodhi kështu, një kthim tek klima shpirtërore despotike lindore dhe tek format arkaike folklorike. Moderniteti u intentifikua me modernizmin dhe këtij të fundit iu dha kuptim pezhorativ. Edhe mjaft ansamble kulturore popullore, që e kishin të mirëprofilizuar substratin orgjinal shqiptar, u bënë pre e frymës së partishmërisë komuniste – mjaftojmë të kujtojmë si shembull temat e mjaft krijimeve të prezantuara në festivalet folklorike të Gjirokastrës.<sup>2</sup> Pasojat negative, në këtë rast qenë të rënda dhe të shumanshme, sepse ato kishin të bënin jo vetëm me krijimin e modeleve hibride, ku dominantja nuk ishte estetikja, duke reduktuar edhe

<sup>2</sup> Shih edhe Reuer 1997: 123-133; Reuer 2001: 184-189.

tiparet autentike të kulturës dhe të artit tonë, por edhe me reduktimin e aftësive për komunikim dhe integrim, që historikisht e ka pasur kultura jonë.

## Ekskomunikimi i universit teorik dhe artistik të Evropës moderne

Humbja e tipareve të mirëfillta artistike, e la kulturën tonë jashtë komunikimit universal, pasi përmasa përfruese dhe bashkëvepruese e kulturave, në kohët moderne është ajo që lidhet me cilësitë e njëmendta artistike. Kultura, siç thotë Jacques Delors, nuk është një mall tregu.<sup>3</sup> Mbi këtë koncept u ngrit në gjysmën e dytë të shekullit XX e gjithë politika dhe filozofia kulturore evropiane. Nga ana tjetër, dialogu kulturor, në nivel evropian dhe më gjerë, ngrihet mbi parimet e partneritetit, çka nënkupton që dukuritë e përshtatjes dhe të marrëdhënieve kulturore nuk pranohen me të njëjtën paradigmë si nën despotizëm apo pushtim. Por tek ne universi teorik dhe prodhimi artistik i Evropës moderne u paraqit i deformuar përmes të ashtuquajturve ideologë dhe estetë, për rrjedhojë dhe u ekskomunikua nga i gjithë sistemi i vlerave shpirtërore.

## Format e kundërvënies ndaj modelit sundues

Kjo që u nënvizua më lart përbënte normën, që kishte forcën e kanonit taksativ, ndërkohë që në realitetin krijues dhe receptues ekzistonte paralelisht edhe një model tjetër i përkundërt me zyrtarin. Individë të botës së artit dhe kulturës, intelektualë, por edhe qytetarë të thjeshtë të origjinave dhe të formimeve të ndryshme jetonin dhe krijonin si antikongformist. Ndonëse në Shqipëri nuk pati një disidencë të mirëfilltë, nuk munguan përgjatë gjithë ekzistencës së totalitarizmit komunist format e kundërvënies ndaj modelit dogmatik dhe “patologjisë” së akulturacionit. Kështu, një pjesë e rëndësishme e veprës së Kadaresë është sinjifikative e komunikimit me modelet artistike universale dhe me strukturat moderne artistike të letërsisë së qendrave të mëdha të botës perëndimore. Vepra të tjera të shkrimtarëve dhe të artistëve shqiptarë të krijuara nën diktaturë, flasin gjithashtu për urat komunikuese që ata kanë krijuar me artin modern botëror. Ide, koncepte dhe sjellje properëndimore u shfaqën nën diktaturë edhe nga intelektualë të fushave të tjera, një pjesë e të cilëve u burgosën apo edhe u pushkatuan. Në shumicën e rasteve këta intelektualë shfaqnin hapur prirje dhe adhurim ndaj kulturës dhe filozofisë perëndimore.

Forma të refuzimit të paradigmës zyrtare ishin edhe sjelljet e disa të rinjve që parapëlqenin modelet moderne të jetës së përditshme. Një rol pozitiv për thyerjen në disa pjesë të tij të murit të moskomunikimit me botën perëndimore kanë qenë stacionet televizive.

<sup>3</sup> Brunsvick / Danzin 2001: 64.

Humori, gjithashtu, ka qenë një formë e antikonformizmit. Këtu kam parasysh në radhë të parë të ashtuquajturin humor të rrugës. Në qendra të tilla urbane si Shkodra apo Durrësi, por dhe në qytete të tjera të Shqipërisë tregoheshin barcaleta dhe parabola në të cilat stigmatizohej realiteti politik shqiptar. Këto forma të ikjes prej paradigmës zyrtare kanë luajtur një rol të madh në mbajtjen gjallë të vetëdijes estetike dhe filozofike të një pjesë sado të vogël të shoqërisë, e cila nga ana e vet ka ushtruar ndikim mbi pjesën tjetër.

## Sfida mes globalizimit dhe kërkimit të indentitetit

Pas shëmbjes së diktaturës komuniste rrëzohet parimisht edhe paradigma e “patologjise” së akulturacionit. Jeta kulturore dhe artistike si mbarë shoqëria shqiptare është tashmë në një dialog të gjërë dhe intensiv me modelet kulturore gjeneruese. Në kohën e sotme problem themelor mbetet përbalimi i sfidës midis pranimi të mondializmit, pra procesit të globalizimit, dhe kërkimit legjitim të indentitetit. Këtë sfidë duhet ta përballojnë edhe shqiptarët, sepse ndryshe nuk mund të bëhen pjesë organike dhe harmonike e së tërës evropiane. Krahas kësaj sfide universale, shqiptarëve u duhet të përballojë edhe disa sfida të tjera që lidhen me natyrën e trashëgimisë sonë shoqërore. Në vitet `90 të shekullit XX shqiptarëve iu desh të bënin kapërcimin e madh nga një shoqëri ku të gjithë ishin “të përfshirë” (kuptohet sipas konceptit dhe sistemit të fermës) në një shoqëri ku një pjesë u gjend “e përjashtuar” dhe një pjesë tjetër e kërcënuar “nga përjashtimi”. Pra, u prishën identitetet shoqërore të krijuara sipas modeleve kolektiviste, ku edhe artin e bëjnë masat.

Mirëpo, ndërtimi i identiteteve të reja është një proces i vështirë, i cili kërkon edhe rivlerësim kritik të trashëgimisë kolektive dhe individuale. Në aspektin kulturor ndodhën, gjithashtu, edhe shumë dukuri të tjera, si kalimi nga kontrolli mbi gjithçka në vërshimin e shumë kulturave. Diversiteti, që e ka orgjinën që herët në fushën e kulturës përjetoi, në kushtet e reja të demokracisë politike dhe shoqërore, zhvillime të vrullshme të cilat shpesh herë u shoqëruan edhe me shmangie dhe deformime tipologjike, semantike dhe stilistike në fushën e kulturës shpirtërore.

Një tjetër sfidë, që duhet të përballojë realiteti kulturor shqiptar, është edhe ajo që lidhet me çshënjtërimin e ekspertëve, prirje të cilën vendet e zhvilluara demokratike e kishin bërë të vetën prej shumë dekadash. Ende, në ditët e sotme, ndihet tek ne autoriteti i ekspertit si i vetmi shpëtimtar i deformimeve kulturore; kur në të vërtetë më i fuqishëm dhe veprues duhet të jetë autoriteti i receptuesit, i individit të kulturuar, i cili nuk duhet të bëhet konsumator i ushqimeve shpirtërore të prishura dhe të prodhuara në kantiere me teknologji arkaike.





## Domosdoshmëria e individit të kulturuar

Krijimi i një individi me një aparat konceptual modern dhe të pavarur; me një sistem receptimi dhe vlerësimi të mbështetur në argumente; aftësi për t'i diskutuar gjërat jo sipas shkakësive lineare, por atyre të gërshetuara: veprim, kundërveprim; shije estetike moderne, të cilat nuk plotësohen nga banalitetet, por nga cilësitë e larta artistike. Sociologu i madh gjerman, Max Weber, në veprën e tij “Ekonomia dhe Shoqëria” thotë se “*formimi i komunitetit njerëzor nuk është thjesht fakt empirik, por është vlerë, rrjedhim i imagjinatës, fantazisë dhe të menduarit njerëzor. Dy format kryesore të socialitetit njerëzor: kombi dhe kultura nuk janë thjesht fakte empirike, por konstruksione të mendimit*”.<sup>4</sup> Pra sipas Weberit kombi dhe kultura janë vlera dhe si të tilla ato bëjnë pjesë në sistemet e vështira të krijimit, receptimit dhe vlerësimit.

Subjekti shqiptar, për hir të së vërtetës, është ende në një proces të vështirë formësimi për të mbërritur tek homologët e tij evropianë. Për pasojë edhe kultura jonë, e gjendur përpara sfidave të shumta, disa prej të cilave u përmendën këtu më lart, përjeton një gjendje rikrijimi dhe rivlerësimi pa të cilin nuk mund të bëhet pjesë aktive e proceseve integruese moderne.

## Bibliografi

Brunsvick, Yves; André Danzin (2001) Lindja e një qytetërimi. Shoku i mondializimit, Apolonia, Tiranë

Eco, Umberto (1997) Për letërsinë, Dituria, Tiranë

Reuer, Bruno (1997) *Musik in Albanien vor und nach der Wende 1991*, në Musik im Umbruch - Kulturelle Identität und gesellschaftlicher Wandel in Südosteuropa, Mynih

Reuer, Bruno (2001) *Das Festival von Gjirokaster*, në Albanien - Reichtum und Vielfalt alter Kultur, Staatliches Museum für Völkerkunde München

Said, Eduard (2009) Orientalizmi – Imagjinimi evropian i Orientit, Lindje Perëndim, Tiranë

Weber, Max (2005) Ekonomia dhe Shoqëria, Plejad, Tiranë

Zalambani, Maria (2003) La morte del romanzo. Dall'avanguardia al realismo socialista, Carroci, Romë

---

<sup>4</sup> Weber 2005: 22

## “THE SECOND SOCIETY” – QËLLIMET, KONCEPTET DHE VEPRIMTARIA E LËVIZJES SË SHOQËRISË CIVILE NË RDGJ NË VITIN 1989

Dr. Christoph Giesel

### Shënime hyrëse

Përfundimi i Luftës së Ftohtë në fund të viteve '80 u shoqërua edhe në Gjermaninë Lindore me një proces transformimesh shoqërore të përmasave të thella. Ndryshimet politike, ekonomike dhe sociale u shoqëruan edhe me zhdukjen nga harta politike të një kufiri, atij mes RDGJ-së dhe RFGJ-së. Shoqëria e dikurshme autoritare e organizuar sipas paradigmave të ekonomisë së planifikuar, e cila në medie dhe në botimet shkencore quhej si “socializmi që ekzistonte në realitet”, iu bashkua në vitin 1990 një shoqërie të bazuar në parime kapitaliste të ekonomisë së tregut dhe të demokracisë parlamentare. Shumica e historianëve, e politologëve dhe e gazetarëve gjermanë i konsideron vendosjen e demokracisë, pluralizmit dhe ribashkimin e Gjermanisë, si qëllimet kryesore të “Revolucionit gjerman të vitit 1989”. Në këtë kuadër trajtohen rrallë përfytyrimet, përmbajtja dhe mënyra e veprimit të njerëzve dhe të “Lëvizjes qytetare”<sup>1</sup> në fillim të kthesës politike në Republikën Demokratike Gjermane (RDGJ), megjithëse këto grupe kanë luajtur një rol relativisht të rëndësishëm në procesin e zgjimit politik të popullsisë në RDGJ. Veprimtaria kryesore e opozitës shihet apo reduktohet në këtë kuadër kryesisht në lidhje me organizimin e protestave kundër regjimit të RDGJ-së. Në kuadër të këtyre analizave dhe vlerësimeve, vëmendje u kushtohet shpesh atyre proceseve që çuan asokohe në ribashkimin e Gjermanisë dhe vendosjen e demokracisë parlamentare. Nga ana tjetër në opinionin publik dhe në atë shkencor si dhe në veprimtaritë përkujtimore, anashkalohet dhe marginalizohet një fazë vërtet realtivisht e shkurtër

<sup>1</sup> Në kontekstin e grupeve opozitare në RDGJ studiuesja Degen e konsideron “Lëvizjen qytetare” si një “... organizatë, e cila e kupton vendosjen e demokracisë në të gjithë sektorët e jetës si parakusht që individët dhe pakicat të shpaleshin mundësitë e tyre krijuese dhe e cila e bën këtë edhe qëllimin më të lartë të politikës” (Degen 2000: 191). Geisel ka në këtë mes rezerva dhe mendon se “atribute si “veprimtar për të drejtat e njeriut” apo “lëvizje për të drejtat e njeriut”, të cilat përdoren dhe pretendohen me kënaqësi dhe në mënyrë të vetëkuptueshme prej ish-opozitarëve të vjeshtës së vitit 1989, (...) e kanë zanafillën në përdorimin e tyre prej “vëzhguesve të mediave gjermanoperëndimore”. Edhe vetë termi “Lëvizje qytetare” i përdorur për herë të parë në shtator të vitit 1989 në mënyrë autoktone, është problematik sepse ai sugjeron mes grupeve opozitare dhe popullsisë së RDGJ-së një afërsi të tillë, e cila zor se ekzistonte madje edhe në ato pak javë kur „Forum i Ri“ gëzonte popullaritet të madh. Fakti që përfaqësues të spikatur të opozitës së dikurshme vazhdojnë të quhen si “veprimtarë për të drejtat e njeriut”, ka të bëjë me meritat e tyre historike, por jo me mënyrën se si konceptoheshin ata vërtet prej qytetarëve” (Geisel 2005: 10).

për nga kohëzgjatja, por jo e parëndësishme nga këndvështrimi i historisë së ideve dhe nga pikëpamja sociale e një të ashtuquajturë "second society", një lloj shoqërie paralele në RDGJ, e cila ekzistonte në kohë nga pranvera deri në fund të vitit 1989.

Qëllimi i këtij shkrimi është të hedhë dritë ndaj disa aspekteve të kthesës paqësore në ish-RDGJ, të cilat duket se kanë rënë në harresë. Kjo është një temë, e cila ka shkaktuar shumë diskutime kontroverze (shih edhe shënimin 1):

*"Se sa i vështirë – dhe shumështrësor – është objekti në fjalë, [...], e tregon rrethana se kujtimet rreth qëllimit dhe botëkuptimit të disidencës në RDGJ janë sot tejet të ndryshme edhe në radhët e atyre pak personave që bënin pjesë vërtet në të."* (Geisel 2005: 8)<sup>2</sup>

Trajtimi i të gjitha aspekteve (p.sh. përfytyrimet për politikën ekonomike) si dhe i qëndrimeve politike polemizuese, i perspektivave, i fushave problemore dhe i diskutimeve polemike brenda grupeve opozitare, do t'i kalonte caqet e këtij artikulli, prandaj ato vetëm sa do të cekën ose do të lihen jashtë vëmendjes.

Në ndryshim nga shumica e botimeve që merren me tematikën themelore të ndryshimeve politike të vitit 1989 në Gjermaninë Lindore, në kuadër të këtij punimi do të gjykohet më tepër rreth perspektivës së pjesës më të madhe të aktorëve të shoqërisë civile të asaj kohe.<sup>3</sup> Pikërendesa tematike përqendrohet tek lëvizjet qytetare gjermano-lindore si aktor që vepron si formë shoqërore alternative e orientuar nga parimet e demokracisë direkte. Vëmendje do t'u kushtohet sidomos aspekteve të prejardhjes, kushteve të lindjes dhe të krijimit, proceseve të zhvillimit, përfytyrimeve sociale dhe politike, strukturave, mënyrës së veprimit, dështimit dhe humbjes së rëndësisë të këtyre lëvizjeve qytetare specifike në RDGJ.

## Grupet opozitare në RDGJ deri në vitin 1989

### Krijimi i lëvizjeve politike alternative në RDGJ

Origjina e lëvizjes opozitare gjermanolindore e ka zanafillën në grupe të vogla dhe të shpërndara (kryesisht në formën e grupeve të punës dhe grupeve të diskutimit), që filluan të krijoheshin gradualisht që prej vitit 1973 (krh. Krech 2005: 76-79). Megjithë karakterin totalitar të shtetit dhe të shoqërisë në RDGJ u përvijuan gjatë viteve 1980 gjithnjë e më tepër dhe më me forcë konturet e një kulture politike të

<sup>2</sup> Sipas Geisel bërthama e disidentëve përbëhej prej rreth 2.500 vetësh.

<sup>3</sup> Një burim të rëndësishëm për analizën e këtushme përbën studimi për lëvizjen opozitare në RDGJ i politologes gjermanoperëndimore Christel Degen. Përfundimet e saj bazohen në shumë vëzhgime dhe intervista, që autorja i ka marrë në kohën e kthesës në radhët e lëvizjes qytetare gjermanolindore (krh. Degen 2000). Autori i këtij artikulli ka qenë vetë dëshmitar i ndryshimit politik në RDGJ 1989/1990 si banor i Berlinit Lindor, dhe në reflektimet e tij përfshin jo vetëm përvojën, kujtimet dhe vëzhgimet personale, por edhe ato të rrethit të tij familjar dhe shoqëror.

dytë (krh. Probst 1993: 28v dhe Wolfram 1999) Grupet që mishëronin këtë kulturë, simbolizonin dhe zgjerimin e formave të shprehjes kulturore, sociale dhe politike *“rëndësia e së cilave filloi t’i kapërcente dimensionet e kohës së lirë dhe të kulturës rinore duke u shtrirë shprehimisht në koncepte politike.”* (Lemke 1991, 164).

Gjithsesi rëndësia shoqërore e këtyre ideve politike alternative qe fillimisht tepër e ulët. Fillimisht këto grupime të ndryshme dhe të vogla e ndienin veten më tepër si kulturë alternative, sesa si opozitë politike. Kahu i përfytyrimeve dhe i veprimeve të tyre kishte më tepër orientim kulturor dhe nuk kishte të bënte thujse fare me pushtetin dhe organizimi i tyre kishte më tepër format e demokracisë direkte dhe jo të një drejtimi të centralizuar. Deri në mesin e viteve` 80 struktura organizative e këtyre shoqatave ishte pak e formalizuar, ngaqë për shkak të represionit shtetëror dhe të monopolit të informacionit, ishte e pamundur të krijoje hapur organizata politike, por edhe sepse secili prej grupeve donte të ishte mundësisht autonom. Nga fundi i viteve 1980 këto grupe filluan të politizohen dalëngadalë dhe që prej vitit 1987 kemi krijimin e një rrjeti në të cilin dalin në pah këndvështrimet e dikurshme, politikisht të ndryshme të grupeve, por edhe efekte solidarizimi (krh. Degen 2000: 76-78; Fricke 2000: 2005-208; Probst 1993 dhe Wolfram 1999) Erozioni i shkallëshkallshëm i ideologjisë dhe i monopolit të pushtetit shtetëror ndikoi pozitivisht për zgjerimin e opozitës. Orientimi socialopolitik i saj nuk drejtohej vetëm kundër vlerave të kulturës politike shtetërore, por edhe kundër kulturës dominuese të popullsisë me orientimin e saj materialist dhe apolitik, qëndrimi i së cilës përpara vitit 1989 ishte shpesh i distancuar, pritës dhe kritik – kjo edhe në radhët e asaj pjesë të popullsisë së RDGJ-së që nuk ishin tepër entuziaste ndaj regjimit. Për këtë shkak ndërmjet këtyre grupeve shoqërore ekzistonin edhe pak kontakte. Ndërkohë që kulturat politike ekzistuese nuk ishin vetëm në konkurrencë, por shpesh edhe në koekzistencë me njëra tjetrën (krh. Pollack 2000:9 dhe Probst 1993: 28). Pollack tërheq vëmendjen se me kërkesat e tyre grupet alternative opozitare shpesh nuk arrinin të depërtonin tek shtresat e popullsisë. Për këtë shkak *“shumica e grupeve e kishin hequr prej kohësh shpresën se me temat e tyre sociale dhe përfytyrimet politike mund të depërtonin dhe të fitonin përkrahës në radhët e popullsisë.”* (Pollack 2000: 174)

Në këtë mënyrë edhe në rrethet më aktive të opozitës, nga mesi i vitit 1989 deri në vjeshtën e 1989, nuk mendonte njeri se mund të arrihej një mobilizim masiv. Në lidhje me nëndarjen brendshme të grupeve të qytetarëve opozitarë në RDGJ Torpey dhe Baule tërheqin vëmendjen për dy lëvizje mes së cilave, duke filluar nga viti 1987, kishte pasur disa tensione sporadike (krh. Baule 1991: 40v dhe Torpey 1992: 21v). Nga njëra anë ajo lëvizje që ishte e orientuar nga Perëndimin dhe synonte shpërbërjen e RDGJ-së (parulla: *“Ne duam të shpëtojmë prej këtu!”*), dhe nga ana tjetër lëvizja opozitare alternative, e cila në një kohë të mëvonshme (1989) ishte për dialog me SED dhe reformimin e socializmit (parulla: *“Ne duam të*

qëndrojmë këtu dhe të bëjmë ndryshime!“). Duke iu referuar këtyre fakteve Pollack bën këtë vlerësim:

*“Veprimtaria e grupeve politike alternative të të drejtave të njeriut, atyre të paqes, të ambientit apo të grave mbeten deri në verën e vitit 1989 dhe kohën lëvizjeve masive të vjeshtës 1989 dy fenomene të pakrahueshme. Përpjekja për ta shpjeguar të dytin përmes të parit, e lë pa vënë re cilësinë e tyre krejtësisht të ndryshme.”* (krh. Pollack 2000: 8)“

### **Klasifikimi i grupeve opozitare në RDGJ si “Lëvizje të reja sociale“**

Për klasifikimin specifik të grupimeve opozitare dhe të lëvizjeve qytetare në RDGJ politologët gjermanoperëndimorë përdorin shpesh atributin “Lëvizje të reja sociale“. Me këtë term klasifikohen njëherësh si lëvizjet sociale, që lindën asokohe në ish-bllokun lindor, në atë përfundim apo në Botën e Tretë, ashtu edhe ato të shoqërive të sotme. Sociologjia i konsideron lëvizjet e reja sociale si përgjigje ndaj ndryshimeve social-strukturore dhe socio-kulturore të shoqërive të sotme të industrializuara dhe të së ashtuquajturës „logjikë funksionale të kohëve moderne“ që karakterizon këto shoqëri. Pjesë e rëndësishme e ndërgjegjes së kësaj kohe janë çështje të tilla si shkatërrimi mbarëbotëror i mjedisit, rreziqet dhe kërcënimet ushtarake dhe ato që lidhen me përdorimin e enegjisë bërthamore, padrejtësitë në rendet ekonomiko-shoqërore të botës, mungesa e pjesëmarrjes së njerëzve në vendimmarrjet politike etj. Sipas mendimit të politologut dhe aktivistit gjerman për të drejtat e njeriut Roland Roth në këtë kuadër lëvizjet e reja sociale ofrojnë përmes “(...) protestave, stileve të jetesës dhe kulturave ndryshe të paktën në fillësë alternativa shoqërore dhe kërkojnë në këtë mënyrë formësimin e transformimit social” (Roth 1991: 1).

Për shkak të të përbashkëtave në përmbajtje, formë dhe në përbërjen sociale lëvizjet alternative në RDGJ krahasohen, megjithë strukturat e ndryshme shtetërore, që në vitin 1988 me lëvizjet e reja sociale në Republikën Federale të Gjermanisë duke u klasifikuar në një mjedis botëkuptimor paralel. Lindja e këtyre lëvizjeve në kushtet e sistemit të diktaturës së socializmit shtetëror në RDGJ interpretohet si shprehje e një ndryshimi të modelit shoqëror, i cili bazohet në kontradiktat e mënyrës së industrializuar të jetesës në shtetet socialiste (krh. Knabe 1988: 553v dhe 557). Në këtë kuadër Probst e interpreton lindjen e lëvizjeve opozitare në RDGJ, në lidhje me tiparet e “Lëvizjeve të reja sociale” “(...) si refleks ndaj formës specifike real-socialiste të një industrializimi shkatërrimtar, ndaj mungesës së mundësive dhe të hapësirave për individualizëm dhe për shprehjen e interesave politike të pavaruara, ndaj ngathtësisë së sistemit politik dhe ekonomik për risi, si dhe ndaj politikës autoritare dhe të cetralizuar.” (Probst 1993: 33).

Më tej ai konstaton: “Evolucioni kulturor në shoqëri dhe diferencimi i kulturës

*politike krijuan kuadrin për lindjen e lëvizjeve të reja sociale, të cilat në vjeshtën e vitit 1989 do të kristalizoheshin për një kohë të shkurtër në protestat masive.”* (Probst 1993: 29).

Sipas argumentimit të Probstit për grupet opozitare në RDGJ do të vlenin këto tipare karakteristike të “Lëvizjeve të reja sociale“:

- “Larmia tematike dhe ndryshimi i shpejtë i temave,
- Mungesa e një ideologjie unike dhe të vendosur,
- Niveli i ulët i ngjizjes organizatore, i burokratizimit dhe i centralizimit i lidhur ky edhe me një qëndrim armiqësor ndaj figurës së drejtuesit,
- Variacioni i madh në format e veprimeve dhe të aksioneve me theks të veçantë ndaj aksioneve të drejtpërdrejta, dhe një
- numër i madh lëvizjesh autonome, por të lidhura fort në rrjet me njëra-tjetrën“ (Probst 1993: 31).

Gjithsesi në studimet e politologëve gjermanë klasifikimi i grupeve opozitare gjermanolindore në kuadrin e “Lëvizjeve të reja sociale“, nuk gjen ndonjë miratim të gjërë (krh. Degen 2000: 169 dhe 180).

### **Qëndrimet, tiparet dhe veprimtaria e lëvizjeve opozitare në RDGJ në periudhën përpara ndryshimeve politike**

Fakti që në vitet 1980 grupimet opozitare alternative në RDGJ merreshin dhe trajtonin kryesisht tema të tilla si edhe ato të lëvizjeve pacifiste në RFGJ, si p.sh. sigurimi i paqes, ekologjia, demokratizimi i shoqërisë, ndikimi i industrializimit në vendet e Botës III, problemet e minoriteteve, të emancipimit të gruas e kështu me radhë, është i padiskutueshëm (krh. Baule 1991: 40; Fricke 1984: 193-204; Pollack 2000: 153v dhe Probst 1993: 40). Proceset pedagogjike dhe socializuese të këtyre lëvizjeve në vitet 1970, e sidomos nga fundi i viteve 1980 lidheshin sidomos me mënyrën e zgjidhjes së kontradiktave për çështje për të cilat ekzistonin qëndrime të ndryshme përmes argumentimit, me ushtrimin e formave të demokracisë së drejtpërdrejtë për arritjen e një konsensusi, me stërvitjen e mënyrave demokratike të sjelljes dhe të qëndrimeve si dhe me sqarimin dhe perceptimin se çdo të thotë të marrësh përsipër përgjegjësi politike (krh. Probst 1993: 40). Në kuadër të kësaj metodike veprimtarët e këtyre grupimeve orientoheshin në një shkallë të gjërë prej këtyre parimeve të rëndësishme të koncepteve shoqërore alternative: orientimi drejt bazës, refuzimi i strukturave hierarkike dhe burokratike, procesi i vendimmarrjes demokratike nga baza ose pranimi i një shoqërie të orientuar prej parimeve të demokracisë së drejtpërdrejtë ose të demokracisë participuese. Këto parime ishin të pranishme edhe në fazat e mëpasme të zhvillimit të lëvizjeve qytetare.

Përmes shfrytëzimit të mjeteve të tilla si instrumenti ligjor i dorëzimit të

letrave të ankesave, letrave të protestave apo parashtrimet të kërkesave pranë autoriteve shtetërore; përmes organizimit të protestave apo ekspozitave, lutjeve për paqen, parakalimeve të heshtura apo paqësore (sidomos në periudhën 1987-1989), stendave të informacioneve fetare, demonstrate të vogla proteste, krijimit të bibliotekave për mjedisin dhe paqen si të grupeve të punës për një sërë problemesh ekologjike, shoqërore dhe politiko-ekonomike, ose përmes aksioneve me orientim ekologjik si p.sh. për mbjelljen e pemëve, këto grupime përpiqeshin që brenda suazës së mundësive të kufizuara që kishin prej sistemit, të arrinin një lloj mobilizimi modest për t'i vënë në jetë idetë e tyre. Strategjia dhe qëllimi bazë i veprimeve të tilla ishte që të bëhej rezistencë, të krijohej në opinion ndërgjegjia për një problem të caktuar dhe që me gjithë kushtet e rrezikshme njerëzit të nxiteshin që të bashkëpunonin (krh. Baule 1991: 40; Pollack 2000: 152v, 156-162; Probst 1993: 34 dhe Wolfram 1999).

Partia e Bashkuar Socialiste e Gjermanisë Lindore (SED) u kundërvihet këtyre grupeve përmes izolimit të ashpër prej publikut si dhe me përndjekjen dhe dënimin e anëtarëve të tyre (krh. Degen 2000: 77; Fricke 1984: 205).

*“Veprimtaria e grupeve opozitare të RDGJ-së të organizuara sipas parimit të demokracisë së drejtpërdrejtë, konsiderohej prej SED-së si vënie në pikëpyetje e monopolit që pretendonte të kishte ajo për të vërtetën dhe pushtetin dhe për këtë SED-ja u kundërpërgjigjej atyre me një represion të gjërë shtetëror.”(Probst 1993: 37).*

Por megjithë monopolin e informacionit dhe kontrollin e opinionit publik nga ana e SED-së, këto lëvizje arritën të krijonin në hije të strukturave të shoqërisë së RDGJ-së një “opinion publik të dytë” ose elemente të një “second society” me tiparet e një kulture të kundërt sociale dhe politike. Frymëzuar prej një konceptimi individual të ndryshëm të kulturës dhe të politikës nëpër revista dhe aktivitete të llojeve të ndryshme, nëpër forume fetare dhe deklarata publike, përmes krijimit të bibliotekave, organizimit të takimeve për diskutime si dhe formash të tjera, gjente shprehje nevoja për kalimin nga një mënyrë konceptimi të politikës si formë sunduese e instrumentalizuar në një formë ekspresive të orientuar nga baza (vgl. Baule 1991: 40; Degen 2000: 180; Probst 1993: 28v dhe 37v). Një rol të veçantë luajtën në këtë mes edhe kishat. Një pjesë e konsiderueshme e përfaqësuesve të kishës protestanto-luterane jetonin në një simbiozë të ngushtë me lëvizjet qytetare në RDGJ (krh. Baule 1991: 38v; Fricke 1984: 190-193; Pollack 2000: 155 dhe Probst 1993: 42-54)

### **Përbërja sociale e grupeve opozitare para vitit 1989**

Prej një vëzhgimi të vëmendshëm të përbërjes sociale të grupeve opozitare të

bie në sy, se "aktivistët" kanë zakonisht një nivel të lartë shkollimi, siguri sociale dhe relativisht shumë kohë në dispozicion. Nga fillimi deri nga mesi i viteve '80 të angazhuar në grupimet politike alternative ishin kryesisht persona që punonin në profesion të lirë (p.sh. artistë, mjeshtra të prodhimeve artistike, dizinjatorë, asistentëregisorë, psikologë dhe publicistë), priftërinj të kishës protestante, teologë dhe punonjës të tjerë të kishave, persona të punësuar në sektorin e të ashtuquajturave shërbime humane (p.sh. infermierë dhe kujdestarë azilesh për pleq), shpesh edhe studentë të arteve, të filozofisë dhe të teologjisë, grupe akademikësh që kishin pak shanse për të gjetur punë, apo akademikë që punonin në institucione studimore (p.sh. fizikantë, biologë, mjekë etj), persona që kishin lënë shkollën apo shkollimin profesional, përfaqësues të subkulturave (si p. sh. pankë, rokerë dhe hipi) si dhe punonjës profesionesh të rralla (krh. Knabe 1988: 561; Probst 1993: 33-35).

## Kthesa politike dhe lëvizjet qytetare të orientuara prej demokracisë së drejtpërdrejtë në RDGJ

### Fillimi i Kthesës dhe lindja e Forumit të Ri

Nën trysinë e proceseve të transformimeve politike dhe sociale që filluan në vitet 1980 në Bashkimin Sovjetik dhe nxitjen që dhanë "perestrojka" dhe "glasnosti" edhe në RDGJ filluan të duken hapur problemet, përkeqësimi i gjendjes ekonomike, arratisjet masive të qytetarëve të RDGJ-së për në RFGJ dhe faktorë të tjerë në fund të viteve 1980 sollën me vete edhe një rritje të ndjeshme të rëndësisë së lëvizjeve qytetare në Gjermaninë Lindore. Në shtator dhe tetor 1989 tek gjithnjë e më tepër qytetarë të RDGJ ndjenja se nuk vazhdohej më si deri në atë kohë u shndërrua në një gatishmëri për veprim revolucionar. (krh. Baule 1999: 22-24 dhe 41). Në këto kushte veprimtaria opozitare shënoi kulmin e saj me përmbysjen e shpejtë të regjimit diktatorial të RDGJ-së në vjeshtën e vitit 1989. Arrestimet dhe dëbimet nga vendi të aktivistëve prej organeve shtetërore të RDGJ-së çuan në një valë edhe më të gjërë solidariteti të popullsisë me ta (krh. Degen 2000: 77v). Vendet dhe aksionet që ndërmerrnin grupet opozitare u bënë tërheqëse për shumë qytetarë (krh. Baule 199: 41). Grupet e deritanishme, të cilat e konsideronin veten më tepër si kulturë politike dhe më pak si opozitë politike, arritën një status në të cilin u duhej të përballeshin me përgjegjësi politike. Si forca më e fortë politike u zhvillua me shpejtësi gjatë vitit 1989 Forumi i Ri, në të cilin merrnin pjesë një numër i madh grupesh të ndryshme lokale të krijuara sidomos gjatë vjeshtës së vitit 1989 në të gjithë RDGJ-në. Mes tyre ekzistonte në masë të gjërë si konsensus bazë krijimi i një opinionit publik të pavarur dhe ndryshimi i pushtetit që sundonte në atë kohë (krh. Degen 2000: 77v; Pollack 2000: 152v dhe Probst 1993: 95v).



Kthesa e madhe e vitit 1989 e gjeti opozitën të papërgatitur për të përballuar nga pikëpamja organizative një masë kaq të madhe njerëzish që donin t'i bashkoheshin asaj. Megjithatë për shkak të veprimtarisë së saj të dikurshme, ajo pati mundësi që në një kohë relativisht të shkurtër dhe në kushtet e një infrastrukture tejet të keqe të themelonte kudo në RDGJ pika takimi. Me kërkesën për dialog, e cila erdhi njëkohësisht si nga grupet opozitare edhe nga krijuesit e pavarur të arteve dhe të kulturës, Forumi i Ri ishte në vitin 1989 në një mendje me shumicën e popullsisë që protestonte dhe bashkë me grupet e tjera opozitare përbënte të vetmen forcë politike, e cila që në gjendje t'i jepte një zë pakënaqësisë kolektive (krh. Degen 2000: 78, 87v., 175v. dhe 182; Probst 1993: 40).

Pollack (2000: 8v) jep një shpjegim të ndryshëm. Sipas tij dinamika e procesit të transformimit ishte bashkëveprim i protestave masive dhe i largimit masiv të qytetarëve nga RDGJ-ja, ndërkohë që grupet opozitare as që i kishin organizuar të gjitha protestat masive, ose kishin bërë thirrje për to.

Në kuadër të veprimtarive të opozitës duke filluar nga vjeshta 1989 në të gjithë vendin u organizuan tryeza të rumbullakta gjatë të cilave njerëzit kishin mundësi t'i pyesnin sundimtarët drejtpërdrejt, u krijua një rrjet grupesh në bazë komisionesh qytetare dhe komisionesh kontrolli. Në këtë mënyrë u krijua një lloj sundimi i dyfishtë, sepse në nivelin e qeverisjes lokale Forumi i Ri krijoi një lloj kundërpushteti apo një "shoqëri të dytë". Për shkak të parimeve të demokracisë së drejtpërdrejtë ky forum nuk që në gjendje ta shterronte potencialin e vet në nivel shtetëror. Edhe mundësia për t'u vënë në krye të lëvizjes së transformimit politik dhe shoqëror, nuk u mor sa duhej seriozisht për shkak të përfytyrimeve negative të anëtarëve të tij në lidhje me pushtetin (krh. Degen 2000: 78v dhe 176).

Me rritjen e rëndësisë së lëvizjes qytetare sidomos nën drejtimin e Forumit të Ri ndryshoi edhe struktura sociale brenda kësaj lëvizjeje. Në ndryshim nga viti 1989 në të merrnin pjesë tashmë përfaqësues të të gjitha shtresave shoqërore. Në mënyrë të veçantë në gjysmën e dytë të vitit 1989 u shtua numri i punëtorëve, raporti i të cilëve në krahasim me atë të studentëve dhe të intelektualëve ishte shumë më i lartë se më parë (krh. Degen 2000: 87-89).

## Përfytyrimet social-politike, kultura politike dhe aktivitetet e Forumit të Ri

### **Konceptet e politikës së hapur dhe idetë për një socializëm liberal dhe demokratik**

Diskutimet për deficitet shoqërore, refuzimi ndaj kërkesave të sistemit për t'u përshtatur me të dhe kërkimi i një praktike jetësore që të ketë kuptim, bënë që

grupet e lëvizjes qytetare gjermanolindore t'i ngrinin konceptet për krijimin e ndërgjegjes së tyre e tyre politike jo mbi bazën e teorive të pushtetit, por mbi baza etiko-sociale si dhe subjektive. Ata nuk kishin përfytyrime të sakta për formën e shoqërisë së ardhshme. Nisur prej ideve të demokracisë së drejtpërdrejtë këto grupime synonin një rrugë alternative me koncepte të hapura mes socializmit shtetëror dhe demokracisë parlamentare me orientim kapitalist. Megjithëse synimi ishin "konceptet e hapura" dhe pluralizimi, ndërkohë që idetë tradicionale politike të majta hidheshin poshtë, parapëlqeheshin njëkohësisht edhe pretendime normative për një socializëm demokratik (krh. Degen 2000: 78; Pollack 2000: 169v; Probst 1993: 38-40; Wielgohs/Schulz 1991: 388). Referimi jodogmatik i parimeve socialiste kishte të bënte me një orientim të përbashkët bazë, i cili varionte në intensitet sipas grupeve të veçanta dhe individëve.

Për shumë aktivistë të të drejtave të njeriut veprimtaria opozitare kundër regjimit autoritar nuk do të thoshte automatikisht përkrahje e të ashtuquajturit sistemi perëndimor (krh. Deklaratë kundër FMN-së 1988). Ky fenomen është i lidhur ngushtë me të ashtuquajturin koncept të "rrugës së tretë" (krh. Geisel 2005: 107v.; Trömmel 2002: 126). Megjithë frikën nga Bashkimi Sovjetik opozita gjermanolindore e shihte RDGJ-në si pjesë të bllokut lindor. Sipas Geisel apo Pollack (2000: 151v) opozita e RDGJ-së *"nisej prej idesë së ekzistencës së përhershme të RDGJ-së dhe të bllokut të shteteve socialiste dhe për këtë shkak horizonti i qëllimeve të saj mbeti i kufizuar tek reformimi i sistemit ekzistues në vend"* (Geisel 2005: 7).

Për të qenë të saktë në lidhje me idetë politike të aktorëve themelorë të Forumit të Ri duhet thënë se megjithë përfytyrimet për një socializëm liberal dhe demokratik, në të cilin shkrihen me njëri-tjetrin elemente të demokracisë së drejtpërdrejtë dhe asaj të këshillave, ato duhen konsideruar si ide të qarta opozitare apo si alternativa ndaj sundimit autoritar dhe diktatorial të shtetit socialist. "Socializmi" nuk barazohej me komunizmin dhe diktaturën, por konsiderohej si një model ideal shoqëror kundrejt „socializimit që ekzistonte realisht“ në kushte diktatoriale dhe i cili perceptohej si „një socializëm alibi“.

Sipas deklaratave publike të opozitarit Sebastian Pflugbeil RDGJ-ja duhet të kishte p.sh. si orientim traditat socialiste dhe jo sistemin e RFGJ-së. Vazhdimësia e ekzistencës së RDGJ-së duhet të garantonte mbijetesën e eksperimentit socializëm dhe të ideve të tij normative në formën e përballjes me anët pozitive dhe negative të socializmit që ekzistonte në realitet. Ajo që përfytyronte dhe synonte të arrinte Pflugbeil ishte një shoqëri "më e lirë, më e qeshur dhe më e gëzuar." (krh. Pflugbeil 1989: 26).

Përparësitë e RDGJ-së si alternativë ndaj Republikës Federale Gjermane Rolf Henrich i shihte tek idealet themelore socialiste si p.sh. "identiteti kolektiv", "kooperimi" dhe



“ndjenja e ndihmës vëllazërore” që janë të kundërtat e ideve të së ashtuquajturës “shoqëri bërrylash” të sistemit ekonomik dhe shoqëror kapitalist. (krh. Roctus 1999: 209).

### **Gjallërimi i hapësirës publike nga poshtë mbi bazën e dialogut pragmatik dhe të procesit të konsensusit**

Gjallërimi i hapësirës publike përmes njerëzve të zakonshëm përbënte një çështje të rëndësishme të procesit të transformimit shoqëror të viteve 1989/90. Në këtë kuadër Forumi i Ri ishte një bartës i rëndësishëm i ndryshimeve shoqërore. Nxitja e projekteve të ndryshme dhe procesi në rritje i politizimit, mundësuan lindjen e shumë nismave të vetorganizuara. Në këtë mes doli në pah se procesi i demokratizimit nga poshtë kërkonte mënyra të ndryshme pune dhe qëndrimi të veprimtarisë politike. Një tregues themelor paradigmatic i Forumit të Ri ishte në këtë kuadër krijimi i një procedure dialogu dhe konsensusi për arritjen e qëndrimeve kolektive në rrjedhën e procesve të marrjes së vendimeve (krh. Degen 93-95 dhe 141-145; Hürtgen 1999 dhe Pollack 2000: 152f.). Thirrja për dialog që u bë për herë të parë ditën e themelimit të Forumit të Ri më 10 shtator 1989 karakterizon edhe pragmatizmin, pluralizmin si dhe qëndrimin antidemokratik dhe antiinstitucional të tij. Koncepti që propozon Forumi i Ri për demokracinë nuk është teoretizues, por përbën një ofertë praktike sjelljeje dhe qëndrimi (krh. Degen 2000: 84; Probst 1993: 36 dhe 145). Në të pranohet se Forumi i Ri nuk ka ndonjë lloj zgjidhjeje të gatshme, ai nuk pretendon të marrë përsipër drejtimin e dialogut dhe u bën thirrje njerëzve të kontribuojnë për gjetjen e zgjidhjeve pragmatike dhe konstruktive (krh. Neues Forum 1989: 13v). Edhe një fletë volante e shpërndarë më 23 tetor përmban propozime pragmatike për zhvillimin e diskutimeve mbi bazat e demokracisë së drejtpërdrejtë (krh. Degen 2000: 82v). Mbi bazën e vëzhgimeve intensive të proceseve të ndryshme të vendimmarrjes prej Forumit të Ri Christel Degen jep këtë vlerësim në lidhje me kulturën politike të këtij grupi:

*“Kultura politike orientohej me rigorozitet prej çështjeve objektive dhe problemeve që duheshin zgjidhur konkretisht. Mburjet individuale, retorika e tepruar, fyerjet dhe gjëra të tjera të ngjashme me to, konsideroheshin sikurse edhe debatet ideologjike dhe teorike themelore si metoda të vjetëruara dhe të kapërcyera. Parimi më i lartë që zgjidhja pragmatike e problemeve në favor të sa më tepër personave të prekur. Interesat individuale ishin në plan të fundit. Prosesi i krijimit kolektiv të mendimit bënte që rezervat gjatë debateve të merreshin seriozisht, megjithatë debatet pa fund mënjanoheshin ose problemet që nuk mund të zgjidheshin brenda një harku të caktuar kohor, shtyheshin*

*për në një moment tjetër për të krijuar në këtë mënyrë mundësinë për të rimenduar dhe rigjykuar për problemin. Edhe përfaqësuesit e kundërshtarit politik konsideroheshin në shumicën e rasteve si individë dhe jo si përfaqësues të një pikëpamjeje apo funksioni politik ose nuk quheshin me ndërgjegje si kundërshtarë politikë.” (Degen 2000: 94).*

Nisur nga këto Degen e quan mënyrën e diskutimeve të çështjeve politike në radhët e Forumit të Ri si ”pragmatizëm jodogmatik” (Degen 2000: 94). Autorja tërheq në këtë mes vëmendjen edhe tek kritika që u bënin aktivistët gjermanolindorë të të drejtave të njeriut, të kuptuarit dhe praktikimit të demokracisë së drejtpërdrejtë prej grupimeve alternative gjermanoperëndimore. Bärbel Bohley, një ndër aktivistët më të rëndësishme gjermano-lindore të të drejtave të njeriut, kritikonte p.sh. një orientim të dukshëm drejt pushtetit në organizatat gjermanoperëndimore të bazuara në demokracinë e drejtpërdrejtë. Ajo kritikon mënyrën e arritjes së konsensusëve dhe shtypjen e mendimit të pakicave në rastet e procesit të hedhjes së çështjeve në votë, ngaqë në të tilla raste individit dhe mendimi i tij nuk merren parasysh sa duhet (Degen 2000: 144v).

Nga ky shembull del se lëvizja qytetare në Gjermaninë Lindore nuk mund të barazohet me ”Lëvizjet e reja sociale” dhe grupimet alternative gjermanoperëndimore megjithë paralelet pragmatike, përmbajtësore, tematike dhe social-etike. Degen, e cila nuk është dakord me klasifikimin apo barazimin e lëvizjes qytetare në Gjermaninë Lindore me lëvizjet e reja sociale në Gjermaninë Perëndimore, tërheq vëmendjen edhe ndaj një aspekti tjetër:

*”Qëllimi i Forumit të Ri ishte (...) demokratizimi i shoqërisë. Po t’i shohësh me kujdes kushtet konstitutive, mënyra e organizimit të hapësirës publike në Gjermaninë Lindore dhe aktorët që vepronin në të nuk mund të krahasohen pa tjetër me ato të landeve të Gjermanisë Perëndimore. Kërkimi për gjetjen e „grupeve alternative” në Gjermaninë Lindore nuk i përgjigjet kontekstit të atjeshëm politiko-kulturor” (Degen 2000: 94).*

Në këtë mënyrë ajo e relativizon tezën e Probstit për të përbashkëtat mes grupeve të orientuara prej demokracisë së drejtpërdrejtë në Gjermaninë Lindore dhe Perëndimore në kontekstin e ”Lëvizjeve të reja sociale” (krh. Degen 2000: 169, 180).

### **Struktura organizative e Forumit të Ri 1989/90**

Struktura organizative e Forumit të Ri<sup>4</sup> e cila gjendej në ndërtim dhe zhvillim të

<sup>4</sup> Të gjitha të dhënat për strukturën organizative të Forumit të Ri janë marrë nga Degen 2000: 84-90 dhe Probst 1993: 117v.

vazhdueshëm, konsiderohej si model i mundshëm për një shoqëri të orientuar prej parimeve të demokracisë së drejtpërdrejtë. Baza përbëhej prej dy grupeve të ndryshme. Temat që trajtoheshin kishin karakter lokal dhe rajonal. Sektorët e veprimtarisë së këtyre grupeve kishin të bënin me nxitjen dhe mbështetjen e projekteve të tilla që kishin të bënin p.sh. me sektorë të tillë si trafiku (p.sh. krijimi i zonave me trafik të limituar), ligjet, çështja e qirave (p.sh. krijimi i shoqatave të qiramarrësve, dhënia me qira e ambienteve për biznes), gjelbërimi i rrugëve, shërbime sociale (p.sh. përkujdesje për të rinjtë, fëmijët, personat me aftësi të kuafizuara apo të moshuarit), shërbime mjeksore (p.sh. nëpër spitale normale dhe psikatrike). Në kohën e transformimit politik në RDGJ ato gjatë vitit 1990 morën pjesë përmes "grupeve tematike" edhe në veprimtarinë parlamentare. Këto grupe merreshin me sektorë të tillë që ishin mbi interesat lokale apo rajonale, si p.sh. shteti, kultura, arsimi, drejtësia, mediet, urbanistika, politika ekonomike, politika e jashtme, ajo e sigurisë dhe e rendit etj.

Grupet në bazë ishin të lidhura në një rrjet rajonal që organizohej prej një këshilli përfaqësuesish rajonalë. Ky këshill merrej me koordinimin e grupeve. Çdo grup zgjidhte përfaqësuesin e vet, i cili mbronte interesat e grupit përpara Këshillit të Përfaqësuesve Rajonalë. Idetë dhe mënyra e punës së secilit grup diskutohej me grupet e tjera dhe shërbente si bazë për propozime për përmirësimin e punës. Meqenëse kompetencat e Këshillit të Përfaqësuesve Rajonalë nuk ishin krejt të qarta, mes këtyre dy nivele kishte konflikte të shumta. Pamundësia për veprim dhe mungesa e stabilitetit politik ishin pra kërcënime të përhershme. Për marrjen e vendimeve të rëndësishme Këshilli i Përfaqësuesve Rajonalë organizonte thirrjen e një asambleje të Forumeve Rajonale apo atyre të Qarkut. Vendimet që merreshin në to kishin fuqi detyruese për të gjithë anëtarët. Prej përfaqësuesve të Këshillit të Përfaqësuesve Rajonalë zgjidheshin përfaqësuesit e "Këshillit të Përfaqësuesve të Republikës".

Sipas Christel Degen Forumi i Ri e konsideronte veten si *"një nismë që koordinon një sërë nismash për të krijuar një shoqëri vërtet demokratike. (...) Demokratizimi i shoqërisë dhe vetorganizimi i grupeve të interesit, si i atyre që ekzistojnë prej kohësh edhe i grupeve të reja, përbënin qëllimin e lëvizjes qytetare."* (Degen 2000: 90).

Përveç këtyre dy grupeve bazë në periudhën tetor 1989 – janar 1990 platforma demokratike të drejtpërdrejta u krijuan edhe në shumë ndërmarrje (krh. Hürtgen 1999).

### **Kritika ndaj sistemit partiak të parlamentarizmit demokratik**

Në rolin e tij si vendimmarrës politik, Forumi i Ri e sheh veten si kundërshtar të partive politike, por duke e përcaktuar veten si lëvizje qytetare, diferencohet fort

prej tyre. Mënyra se si e kuptojnë demokracinë reprezentative të orientuar nga ekonomia e tregut partitë gjermanoperëndimore, konsiderohej prej aktivistëve kryesorë gjermanolindorë të të drejtave të njeriut si e pamjaftueshme. Ata e kritikonin atë dhe favorizonin konceptin e një demokracie participative dhe krijimin e një sistemi politik, i cili përmirëson vazhdimisht *"rrjedhat e komunikimit mes shtetit dhe qytetarëve në favor të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë politike të çdo individi"* (Degen 2000: 96).

Kritika ndaj partive që ushtronin aktorët e ndryshëm të Forumit të Ri ishte shpesh e lidhur me kritikën e përgjithshme ndaj demokracisë parlamentare, e cila konsiderohej si sinonim me *"absolutizmin e partive"* apo me *"demokracinë e spektatorëve"* (krh. Probst 1993: 116; 134-136). Në përputhje me parimin moral themelor, se pushteti duhet t'i shërbejë vetëm së mirës së përgjithshme, shumë parti dhe politikanë akuzohen për veprimtari të pandershme si dhe se kanë si synim të marrin pushtetin, të bëjnë karrierë dhe të sigurojnë poste. Parimi dominues i disiplinës partiake që përkrahet prej shumicës së demokracive parlamentare, hidhet poshtë me forcë, sepse në këtë mënyrë pushteti kalon nga baza tek krerët e partisë dhe te politikanë të tillë, pikëpamjet e të cilëve nuk përputhen me mendimin e shumicës së partisë, e cila dënohet të heshtë. Një shtypje e tillë e individit pengon, sipas mendimit të aktorëve të ndryshëm të Forumit të Ri, procesin demokratik. (krh. Degen 2000: 141).

Forumi i Ri i akuzon politikanët partiakë se janë të paafhtë për të zgjidhur probleme. Këtë ata e shpjegojnë me luftërat që zhvillojnë prej llogoreve të tyre partitë e ndryshme mes njëra-tjetrës si dhe me kontradiktat e brendshme partiake. Po ashtu aktorë të ndryshëm të Forumit të Ri kritikojnë edhe klauzolën e minimumit prej 5% të votave si kusht për të hyrë në parlament, e cila përdoret prej sistemit partiak parlamentar dhe ndarjen relative të pushtetit në favor të partisë që fiton zgjedhjet, sepse në këtë mënyrë nuk gjen shprehje vullneti i pakicave të mëdha apo të vogla në radhët e zgjedhësve. Fenomene të tilla shoqërohen sipas përfaqësueve kritikë të Forumit të Ri me një proces të pamjaftueshëm konsensusi si dhe me pjesëmarrjen e pamjaftueshme të njerëzve në jetën politike. Sipas tyre një deficit tjetër i demokracisë shihet edhe në mungesën e elementeve plebishitare në kombinim me pushtetin e fortë të partive, të cilat nuk garantojnë formën e demokracisë së drejtpërdrejtë (krh. Degen 2000: 139-141, 154-156 dhe 160). Përparësia e një forme organizative si ajo e Forumit të Ri kundrejt partive ka të bëjë sipas politologes Degen me atë: *"që në rastin e çështjeve konkrete ka shans të fitojë mendimi më i arsyeshëm, sepse brenda tij zhvillohet një diskutim i sinqertë larg ideologjive, përfytyrimeve dhe interesave për pushtet, i karakterizuar prej solidaritetit, tolerancës, konsensusit dhe respektimit të mendimit të individëve dhe të pakicave."* (Degen 2000: 161).

Ky sqarim bën të qartë përfytyrimin normativ dhe subjektiv që kishte për

vete Forumi i Ri, i cili donte të ofronte një platformë për të gjithë. Një aspekt tjetër që merrte në konsideratë Forumi i Ri, ishte faktori kohë. Sipas tij partitë shpesh marrin vendime duke qenë nën presionin e kohës, gjë që ndikon negativisht ndaj sqarimit adekuat të problemit. Sipas përfytyrimit të Forumit të Ri arritja e konsensusit në çështje problematike nuk duhet bërë nën presionin e kohës (krh. Degen 2000: 95 dhe 161). Ky lloj argumentimi, që tingëllon thujtë naiv, nuk merr parasysh faktin që në rastin e shumë problemeve nevojiten zgjidhje të shpejta në mënyrë që problemet të mos thellohen më tepër.

## Çështja gjermane dhe dështimi i lëvizjes qytetare

### Kërkimi rrugës së tretë versus ribashkimit gjerman

Në vjeshtën e vitit 1989 as SED-ja dhe as grupet opozitare as që e shtronin për diskutim idenë e ribashkimit të dy shteteve gjermane. E ashtuquajtura rrugë e tretë që sipas përfytyrimeve të opozitës duhej të ishte përtej kapitalizmit, parlamentarizmit dhe shtetit socialist autoritar, shihej pa asnjë pikë dyshimi e lidhur me vazhdimin e ekzistencës së RDGJ-së ose të dy shteteve gjermane. Opozitarët përfytyronin një RDGJ „më të mirë” dhe „më të drejtë”, e cila duhej të drejtohej prej parimeve të socializimit demokratik (krh. Pollack 2000: 177v.; Probst 1993: 116; Roctus 1999: 201 dhe 209). Përmes veprimtarisë së tyre politike, sidomos me krijimin e nismave qytetare dhe grupeve të bazës opozita ia doli mbanë të krijonte një lloj ”shoqërie paralele” me orientim demokratik të drejtpërdrejtë (krh. Degen 2000: 176, Probst 1993: 28v dhe 40). Por kjo ”second society” ishte tepër e re, e dobët dhe pa përvojë dhe përfaqësuesit e saj të drejtuar pjesërisht me shumë forcë prej parimesh politike jorealiste, për të marrë përsipër struktura shtetërore si dhe për të krijuar një konstrukt shoqëror të qëndrueshëm. Ajo kishte nevojë për mbështetjen e vazhdueshme të qytetarëve. Në fillim të vjeshtës së vitit 1989 kjo mbështetje nuk duket se përbënte ndonjë problem. Parulla ”Ne jemi populli!” mishëronte vullnetin dhe dëshirën e pjesës më të madhe të qytetarëve të RDGJ-së për t’i shndërruar raportet shoqërore në RDGJ në një shoqëri sociale të drejtë dhe të afërt me qytetarët. Por ngjarjet dhe situata e krijuar pas rrëzimit të Murit të Berlinit më 9 nëntor 1989, përmbysja e regjimit të SED-së dhe veprimtaria intensive e politikanëve dhe e politikës së RFGJ-së në RDGJ ishin tepër të shpejta dhe çuan në forcimin e ndjenjës së euforisë kombëtare dhe nevojës së ribashkimit gjerman. Brenda muajit nëntor 1989 ndodhi një proces, që në botimet shkencore quhet shpesh ”kthesa brenda kthesës” (krh. Probst 1993: 11v) . Ky term shënon procesin e ndryshimit në opinionin publik të rëndësisë së ideve dhe të premisave socialo-politike të një RDGJ-je të demokracisë participatore në ribashkimin me RFGJ-në dhe sistemin e saj demokratik parlamentar. Si rrjedhojë e ngjarjeve të përmendura më lart ”*modeli vetëm katërmujor i bazuar*

*tek pjesëmarrja politike e qytetarëve dhe tek modelet e hapura u përball pas hapjes së Murit relativisht shpejt me konkurrencën e drejtpërdrejtë të modelit 40-vjeçar të demokracisë reprezentative të Republikës Federale Gjermane.*“ (Degen 2000: 185). Të paktën që prej vizitës së ish-kancelarit Helmut Kohl në Dresden më 19 dhjetor 1989 u bë e qartë, se përpara RDGJ-së shtrohej seriozisht çështja e mbijetesës. Në këtë mënyrë u vu në pikëpyetje edhe mundësia e realizimit të „rrugës së tretë“. Përpjekjet respektive të lëvizjeve qytetare filluan të luajnë vetëm një rol marginal në ngjarjet politike, dhe thirrja e njerëzve nëpër rrugë filloi të transformohej gradualisht nga *”Ne jemi populli”* në *”Ne jemi një popull”*.

Këto ngjarje dhe zhvillime me kahe të ndryshme patën ndikimin e tyre edhe ndaj lëvizjes opozitare të qytetarëve. Ajo filloi të përçahej në kampin e atyre që donin të vazhdonin përpjekjet për realizimin e rrugës së tretë dhe në kampin e atyre forcave që kërkonin bashkimin me Republikën Federale të Gjermanisë. Në këtë kuadër brenda dy kampeve të spektrit të dikurshëm të grupeve dhe të nismave qytetare pati diskutime të shumta, të gjata dhe tepër të ashpra. Qëndrimet në lidhje me ribashkimin e mundshëm të Gjermanisë ndryshonin nga grupi në grup dhe nga muaji në muaj. Sikurse u theksua më lart deri në momentin e shpërbërjes së papritur të bllokut lindor, opozita në RDGJ besonte në vazhdimësinë e një RDGJ-je me orientim socialist dhe horizonti i saj kufizohej për këtë shkak tek reforma e sistemit ekzistues (krh. Geisel 2005: 7). Ndryshimet e thella politike u ofronin atyre tani mundësi më të shumta zgjedhjesh politike. Rochtus konstaton se: *”përpara hapjes së Murit opozita nuk e mendonte thuajse fare bashkimin e mundshëm gjerman, ndërkohë që pas hapjes së Murit dhe nën ndikimin e ndryshimit të gjendjes, ajo filloi ta shihte ribashkimin gjerman si një nga perspektivat”* (Rochtus 1999: 209).

Pasi ideja e ribashkimit gjeti një përhapje të gjërë në radhët e popullsisë së RDGJ-së dhe strukturat politike dhe ekonomike po ndiqnin gradualisht modelin gjermanoperëndimor të sistemit demokratik parlamentar të orientuar nga ekonomia e tregut, përfshirja përmes ribashkimit e RDGJ-së në sistemin politik të Gjermanisë Perëndimore mbetej vetëm një çështje kohe. Në zgjedhjet për Kuvendin Popullor të 18 marsit 1990 nismat qytetare *”Forumi i Ri”*, *”Demokraci tani”* dhe *”Nisma për Liri dhe të Drejtat e Njeriut”* kandiduan së bashku nën emrin *”Lidhja 90”*. Kjo parti fitoi vetëm 2,9% të votave duke pësuar në këtë mënyrë një humbje të thellë. Fituese, me 48,1% të votave, doli lidhja elektorale me drejtim politik konservator *”Aleanca për Gjermaninë”* e cila ishte pro ribashkimit të shpejtë të Gjermanisë dhe përbëhej nga partitë CDU, DSU dhe DA (krh. Rochtus 1999: 241). Që prej këtij momenti u bë për të gjithë e qartë se përpjekjet dhe përfytyrimet politike për të krijuar një RDGJ *”alternative”* kishin dështuar. Grupimet e këtij drejtimi e ndryshuan taktikën e tyre politike duke filluar përpjekjet për të transmetuar në Gjermaninë e ribashkuar sa më tepër vlera të ish-RDGJ-së, që konsideroheshin si vlera pozitive dhe arritje (krh. Rochtus 1999: 201). Politika e ribashkimit dhe kalimi në sistemin parlamentar



të ekonomisë së tregut u shoqëruan tek shumë opozitarë të ish-RDGJ-së me ndjenja zhgënjimi, përuljeje ndaj fatit, paralizimi dhe nënvlerësimi të vetvetes. Kjo sepse sukseset inkuarajuese të arritura përmes përmbysjes së sistemit diktatorial dhe gjallërimit të hapësirës publike nga poshtë, u ndoqën brenda një kohe tepër të shkurtër prej zhvillimesh të tilla që perceptoheshin si humbje të mëdha (krh. Hürtgen 1999). Gjendjen shpirtërore në radhët e aktivistëve të opozitës së orientuar prej parimeve të demokracisë së drejtpërdrejtë Degen e përshkruan me këto fjalë:

*“Sapo opozita kishte arritur t’i kundërvihet me sukses diktatit nga lart dhe ndjenjës së pafuqisë ndaj tij dhe kishte filluar të formulonte me kujdes interesat e saj dhe të zhvillonte në praktikë kulturen e saj politike, një sistem i konsoliduar dhe i fuqishëm vendosi koordinatat themelore të një politike interesash. Një pjesë e madhe e qytetarëve të angazhuar në lëvizjet qytetare të RDGJ-së ua kishin dorëzuar që në mars të vitit 1990 një pjesë të përgjegjësive partive të Gjermanisë Perëndimore dhe politikanëve të tyre profesionistë që ofronin koncepte profesionale dhe kompetente. Rilindja e ndërgjegjes individuale, e cila filloi të vihej re tek shumë njerëz gjatë rrjedhës së ngjarjeve të vjeshtës së vitit 1989, papritur nuk ndihej më. Më e fortë se ushëtimi e lartë e kredos gjermanoperëndimore: “E bëjmë ne këtë, se kemi në çdo fushë edhe më tepër përvojë” ishte vetëm baza financiare dhe organizatore e saj.”(Degen 2000: 184v).*

Me bashkimin me Partinë Ekologjike gjermanoperëndimore lëvizja “Lidhja 90” hoqi dorë prej premisave të një shoqërie demokratike të pavarur prej partive. Një pjesë e konsiderueshme e kundërshtarëve politikë aktivë ndaj regjimit të RDGJ-së si dhe e aktivistëve për të drejtat e njeriut, të cilët u integruan në parti të ndryshme sipas modelit gjermanoperëndimor, u bënë pas vitit 1990 anëtarë aktivë të partive të mëdha të RFGJ-së dhe u larguan së tepërmi prej pozicioneve dhe ideve të tyre të dikurshme.

Disa aktivistë të Forumit të Ri nuk ishin të gatshëm që ta ndërmerrenin hapin politik të përshtatjes me sistemin partiak të demokracisë parlamentare ose parapëlqenin një formë shoqërore të përzierë, të përbërë nga një dualizëm mes demokracisë parlamentare dhe asaj participatore apo të orientuar nga demokracia e drejtpërdrejtë. I orientuar prej formës së tij të dikurshme të veprimit Forumi i Ri vazhdoi të luante një lloj roli si organizatë politike në nivel lokal dhe rajonal deri në vitet 2000, por rëndësia e tij qe e vogël.<sup>5</sup>

Me përjashtim të zgjedhjes së përfaqësueve të veçantë të Forumit të Ri në organe

<sup>5</sup> Në periudhën 1994-2006 ai kandidoi si bashkim elektoral për zgjedhjet e parlamenteve në katër prej landeve gjermanolindore si dhe në Berlin. Në to ai fitoi ose më pak se 0,1% dhe maksimumi 1,1% të votave (krh. Probst 2007: 349). Po ashtu nën emrin “FORUM” kjo lëvizje kandidoi në vitin 1994 për zgjedhjet për parlamentin e Evropës dhe fitoi 0,3% të votave (krh. Bundeswahlleiter 1994).

të ndryshme të qeverisjes lokale në landet lindore të Gjermanisë, ruajtjes së disa "tryezave të rrumbullakta" lokale dhe vazhdimet të projekteve sociale, kulturore dhe politiko-edukative,<sup>6</sup> grupimet që pasuan lëvizjet qytetare gjermanolindore me orientim demokratik të drejtpërdrejtë nuk shënuan gjatë viteve 1990-2000 suksese të tjera për t'u shënuar. Ato u marginalizuan, në shumë raste u shpërbënë dhe ranë në harresë megjithë vlerat e tyre themelore, përvojën historike dhe arritjen e tyre. Një shembull për harresën, lënien e qëllimshme jashtë vëmendjes publike apo botimeve e madje edhe falsifikimit të veprimtarisë dhe të premisave politike në kuadër të ndryshimeve të vitit 1989, është botimi "Fundi i RDGJ-së si katalizator për përfundimin e Luftës së Ftohtë" i ish-aktivistit gjermanolindor për të drejtat e njeriut, sot ushtarak dhe këshilltar për politikën e jashtme, Hans Krech. Në kapitullin " Opozita – Etapat e lindjes, grupimet dhe qëllimet politike" injorohen krejtësisht aspektet e trajtuara në artikullin tonë dhe opozita e RDGJ-së paraqitet si një opozitë me orientim kryekëput antisocialist, e cila simpatizonte me forcë me SHBA-në dhe me presidentin e atëhershëm Ronald Regan (krh. Krech 2005: 73-80).

Në disa raste përjashtimore mediat vazhdojnë t'i tematizojnë – edhe pse në mënyrë sipërfaqësore – dhe tani mbi 20 vjet pas kthesës politike idealet dhe qëllimet si dhe dështimin e lëvizjes qytetare. Si shembull mund të sillet nekrologjia me rastin e vdekjes së figurës më të madhe të revolucionit, Bärbel Bohley, më 11 shtator 2010 në botimin online të së përditshmes "Die Welt". Autori i artikullit e citon Bärbel Bohley me këto fjalë:

*"Politika filloi të zhvillohej papritur nën qiell të hapur – nëpër rrugë filloi të shpalosej një lloj dinamike që mund të shpalosej vetëm atje. (...) Karakteristikë e këtyre gjashtë muajve ishte që prioritetet politike vendoseshin prej shumicës që demonstronte."Politikës së madhe" s'i mbetej gjë tjetër vetëm se të na vinte pas dhe ajo arriti ta ngrinte ndërtesën e saj tradicionale vetëm mbi terrenin e krijuar prej lëvizjeve qytetare" (Malzahn 2010)*

Prej kësaj thënieje të krijohet fillimisht përshtypja se edhe këtu veprimtaria kryesore e opozitës – si shpesh edhe në botime të tjera – reduktohet vetëm në organizimin e protestave kundër regjimit të RDGJ-së në favor të ribashkimit. Por në vijim të nekrologjisë autori thekson:

*"Pas revolucionit paqësor edhe Bohley filloi të provonte si dhe miliona qytetarët të tjerë të RDGJ-së se si ishte Gjermania e re. Në mars të vitit 1990 ajo u zgjodh në Asamblenë e të Deleguarve të Qyteteve në Berlinin Lindor, ku konstatoi shpejt se parlamentet demokratike janë*

<sup>6</sup> Një ndër institucionet më të njohura dhe aktive në këtë drejtim është shoqata "Robert-Havemann", e cila u themelua në nëntor 1990 prej Forumit të Ri si një shoqatë për edukimin politik dhe si arkiv historik për të mbledhur, dokumentuar dhe transmetuar më tej historinë dhe përvojën e opozitës dhe të rezistencës në RDGJ (krh. [www.havemann-gesellschaft.de](http://www.havemann-gesellschaft.de)).



*për t'u përshëndetur, por mund të jenë edhe tepër të mundimshme. Pak nga pak ajo u tërhoq. Pothuajse me mall i përshkruan ajo ndonjëherë ditët e revoltës, në të cilat luftohej jo vetëm „për të marrë një copë ëmbëlsirë, por për të marrë të gjithë dyqanin“. Vjeshta e vitit 1989 në RDGJ ishte për Bohley-n para së gjithash historia e vetëorganizimit të potencialeve demokratike që ishin mbledhur thuajse në të gjitha shtresat e popullsisë. "Për mua procesi i rëndësishëm nuk është shembja e karakterit të vjetëruar shtetëror, por kryengritja madhështore e qytetarëve që e shkaktoi atë." Në vitin 1994 ajo mori edhe një herë vrull me Forumin e Ri – ose më saktë me atë që kishte mbetur prej lëvizjes së dikurshme qytetare. Ajo dështoi prej kufirit të 5%. Por ajo sigurisht që nuk ka dështuar politikisht edhe pas kthesës politike në Gjermani. Me verdiktin e saj "Ne donim drejtësi dhe fituam shtetin e së drejtës" i duhej të merrej një brezi të tërë politikanësh gjermanoperëndimorë (...)." (Malzahn 2010)*

Këtu del e qartë (jo vetëm për rastin e Bohley-t por edhe për shumë prej bashkëluftëtarëve të saj të asaj kohe) gjendja e trazuar e brendshme e njeriut që mendon dhe vepron politikisht, dyjëzimi mes këmbënguljes tek idealet e "vjetra" të demokracisë së drejtpërdrejtë dhe participatore dhe renditjes në një mjedis të demokracisë reprezentative si një alternativë ekzistuese reale dhe më e mirë ndaj përvojave të dikurshme me shtypjen, përndjekjen dhe diktaturën; një ndjenjë dyzimi, e cila së bashku me ndjenjën e përuljes ndaj fatit çoi në një imigrim të brendshëm.

## Shkaqet për dështimin e lëvizjes qytetare me orientim demokratik të drejtpërdrejtë

Dështimi përfundimtar i lëvizjes qytetare me orientim nga demokracia e drejtpërdrejtë si dhënëse impulsesh politiko-shoqërore dhe si forcë mobilizuese masash lidhet me një sërë shkaqesh dhe rrethanash të ndryshme, disa prej të cilave u prekën apo u sqaruan në radhët e mësipërme të këtij shkrimi. Këtu do të bëjmë një përmbledhje të tyre si dhe disa plotësime për këtë aspekt. Sikurse u trajtua hollësisht më lart, aktorët politikë të partive të mëdha gjermanoperëndimore me përpjekjet e tyre për të fituar ndikim politik dhe reputacion historiko-politik, përbënin një faktor të jashtëm me ndikim të madh, i cili i dha fund ndikimit politik të lëvizjes qytetare. Forumi i Ri nuk mund të konkuronte me veprimtarinë e mbifuturshme të partive gjermanoperëndimore që kishin përvojë me fushatat elektorale, përvojë profesionale në punë dhe fuqi financiare (krh. Degen 2000: 184v; Probst 1993: 11v dhe Schorlemmer 1991: 35). Këto ishin ndër të tjerat shkaqet se përse shumë zgjedhës të zakonshëm si dhe aktivistë nga radhët e opozitës votuan

dhe iu bashkuan partive gjermanoperëndimore dhe koncepteve dhe zgjidhjeve të tyre për problemet, të cilat prezantoheshin me profesionalizëm dhe kompetencë. Në to ata shihnin një perspektivë më të mirë për të ardhmen. Aktorëve politikë gjermanoperëndimorë, përfaqësues të RFGJ-së me sistemin e saj demokratik parlamentar, nuk iu desh të krijonin për veprimtarinë e tyre në RDGJ struktura lokale bazë. Si pjesë përbërëse e një sistemi të fuqishëm dhe të qëndrueshëm me një konstrukt të plotë institucional dhe mediatik, ata mund të mbështeteshin me sukses në punën e deriatëhershme të grupeve opozitare, dhe të krijonin më pas mbi këtë bazë strukturat e tyre të qëndrueshme dhe konkurrese ndaj atyre të lëvizjes qytetare (krh. Degen 2000: 97 dhe 184v). Për këtë arsye një pjesë e aktivistëve gjermanolindorë të të drejtave të njeriut e ndjeu veten sikur dikush t'u kishte përvetësuar "frytet e veprimtarisë së tyre politike" dhe thaujse të papërfshirë si partnerë në bisedimet dhe proceset e vendimmarrjes për orientimin e ardhshëm social dhe politik të RDGJ-së.

Një faktor tjetër që ndikoi në dështimin e koncepteve të lëvizjeve qytetare në opinionin publik dhe si pasojë e të cilit ndodhi edhe procesi i "kthesës brenda kthesës" ishte ekonomia. Si pasojë e 40 vjetëve të ekonomisë së planifikuar, situata e përgjithshme ekonomike e RDGJ-së ishte tepër e keqe. Me bashkimin e mundshëm me RFGJ-në, me mirëqënien dhe fuqinë e saj ekonomike, shumë njerëz shpresonin se gjendja e tyre ekonomike do të përmirësohej shpejt dhe në këtë mënyrë do të rritej pa probleme edhe mirëqënia e tyre. Këto shpresa u ushqyen më tej edhe prej përmbajtjes së fushatës elektorale për zgjedhjet për Kuvendin Popullor të marsit 1990 (që u zhvillua me mbështetjen logjistike dhe financiare bujare të partive gjermanoperëndimore). Për këtë arsye shumica e popullsisë gjermanolindore nuk kishte më asnjë lloj interesi për eksperimente të reja shoqërore, të cilat mund të shoqëroheshin ndoshta me vite të tëra privimesh ekonomike (krh. Baule 1999: 29).<sup>7</sup> Përfaqësues me reputacion të politikës dhe të ekonomisë nga RFGJ-ja i krijuan popullsisë së Gjermanisë Lindore ndjenjën se do të bëheshin pjesë e një sistemi të qëndrueshëm ekonomik dhe politik që prodhonte një mirëqënie të vazhdueshme.<sup>8</sup> Për shkak të mungesës së përvojës me strategjitë perëndimore të

<sup>7</sup> Sipas mendimit të Probst dhe Baule shkak kryesor për dështimin e lëvizjes opozitare alternative nuk ishte ndërhyrja e Perëndimit apo e politikanëve profesionistë të RFGJ-së në vitet 1989/1990, sepse krahasimi mes Gjermanisë Lindore dhe asaj Perëndimore kishte kohë që ndodhte përmes konsumit të mediave gjermanoperëndimore, vizitave të të afërmeve në RFGJ dhe anasjelltas. Pra shumica e gjermanolindorëve e konsideronte shumë kohë përpara kthesës politike RFGJ-në si model për mirëqënien dhe sistemin ekonomiko-politik. Po ashtu, sipas tyre, shumica e popullsisë gjermanolindore e shihte që në fillim markën gjermane dhe ribashkimin e vendit si mënyrën më të shpejtë për të dalë prej depresionit ekonomik dhe privimeve materiale kundrejt përfytyrimeve të papërpunuara ekonomiko-politike të afërta me socializmin të grupeve alternative. Krh. Baule 1991: 27-29; Probst 1993: 12-14 dhe 24v; si dhe Fricke 1984: 212-215 dhe 217-219)

<sup>8</sup> Si shembull i strategjisë elektorale në këtë drejtim mund të sillen slogane të tilla si: "Jo eksperimenteve socialiste" apo "Mirëqënie për të gjithë", që u përdorën gjatë zgjedhjeve të marsit 1990 nga CDU-ja.

luftës elektorale dhe me marketingun politik, përfytyrime të tilla u adaptuan prej shumë gjermanolindorëve shpesh pa asnjë lloj reflektimi dhe me një lloj naiviteti. Po ashtu ndaj joshjes së mirëqënies, përpjekjet për të ndërmarrë një eksperiment të ri politik dhe shoqëror nuk kishin asnjë shans.<sup>9</sup> Mungesa e përvojës dhe e kompetencës në çështjet ekonomike në radhët e përfaqësuesve të lëvizjes qytetare, është vetëm një nga shembujt për ndikimin e faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm për dështimin e saj. Sepse është e qartë që dështimi i lëvizjes qytetare lidhet me situatën dhe organizimin e brendshëm të saj si dhe disa ide politike themelore. Më lart në kapitullin *Konceptet e politikës së hapur dhe idetë për një socializëm liberal dhe demokratik*, konstatojmë se për shkak të parimeve të demokracisë së drejtpërdrejtë dhe një drejtimi jo të centralizuar si dhe një raporti negativ ndaj pushtetit apo refuzimit të një politike të orientuar për të marrë pushtet grupimet qytetare opozitare, nuk u morën sa duhet seriozisht (krh. Degen 2000: 78v). Lëvizja qytetare e organizoi konstruktin e saj shoqëror nga poshtë dhe jo duke pasur dhe ushtruar një rol drejtues nga lart. Në radhët e saj mungonte gatishmëria për t'u përhapur edhe në nivelet e mësipërme, gjë që do të kishte qenë e domosdoshme që kjo lëvizje të vazhdonte të ishte një lëvizje e suksesshme politike dhe të ishte në gjendje të përfaqësonte interesat vitalë të të gjithë vendit. Lëvizja qytetare që asokohe tepër e re, e dobët dhe pa përvojë për t'iu përgjigjur kërkesave dhe sfidave të tilla.<sup>10</sup> Një problem tjetër në këtë drejtim përbënin dobësitë organizative dhe strukturore të kësaj lëvizjeje, të cilat dolën madje pjesërisht qartë edhe në pah, si dhe paqëndrueshmëria e kësaj lëvizjeje (p.sh. për shkak të mosmarrëveshjeve për kompetencat).<sup>11</sup> Mungesa e unitetit të grupeve opozitare lidhej edhe me refuzimin e tyre ndaj strukturave të ngurta, rregulloreve, hierarkive, votimeve apo ndarjes së funksioneve, gjë që konsiderohej si tutelë. Nga ana tjetër mes personaliteteve drejtuese të këtyre lëvizjeve, që kishin edhe ambicie politike, qenë të pashmangshme rivalitetet dhe luftrat (krh. Pollack 2000: 179, 182).

Koncepti politik i lëvizjes qytetare shfaq më tej edhe dobësi programore si p.sh. mungesën e një koncepti të qëndrueshëm politik-shoqëror<sup>12</sup> apo mbrojtjen

<sup>9</sup> Megjithë sukseset politike, sociale dhe ekonomike që u arritën falë bashkimit të Gjermanisë, që në gjysmën e parë të viteve 1990 në radhët e shumë qytetarëve të ish-RDGJ-së u përhap një ndjenjë pakënaqësie dhe zhgënjimi për gjendjen sociale, politike dhe ekonomike sidomos në Lindje të Gjermanisë. Shumë gjermanolindorë u zhgënjyen kur kuptuan, se shumë prej premtimeve elektorale nuk mund të realizoheshin aq shpejt ose as që u mbajtën fare dhe se bashkimi gjerman solli me vete vështirësi sociale shumë më të mëdha nga sa u ishte sugjeruar gjatë fushatës elektorale.

<sup>10</sup> Krh. për këtë edhe kapitullin Kërkimi i rrugës së tretë versus ribashkimit gjerman.

<sup>11</sup> Krh. për këtë edhe kapitullin Struktura Organizative e Forumit të Ri 1989/90.

<sup>12</sup> Parë thjesht teorikisht dhe në mënyrë abstrakte, parimi i konsensusit anulohet vetvetiu në rast se një pjesë e popullsisë nuk është e gatshme nga ana e saj, që të integrohet në një shoqëri sipas këtij parimi. Për të siguruar legjitimitetin e këtij parimi politik të shoqërisë duke respektuar edhe pretendimet individuale normative, teorikisht do të duhej hollë-hollë që me çdo banor të vendit, apo anëtar të shoqërisë përkatëse të ekzistojë një konsensus mundësisht i vazhdueshëm për implementimin e këtij sistemi, gjë që është utopike. Megjithatë autori i këtij shkrimi nuk e sheh këtë sqarim si argument kundër shoqërisë që ka një konsensus politik. Ideja është që të nxitet një diskutim teorik dhe praktik për këtë çështje dhe ky koncept të zhvillohet më tej.

e ideve dhe të qëndrimeve të vështira për t'u realizuar politikisht apo utopike<sup>13</sup> si dhe përfytyrimeve ekonomike deri diku absurde (krh. Probst 1993: 13). Të gjitha këto bënë që ajo të mos ishte në gjendje të (ri)fitonte besimin e një pjese të madhe të popullsisë.

Gjatë muajve tepër tronditës të kthesës politike shumë qytetarë ndienin një nevojë të fortë për stabilitet ekonomik, politik dhe social si dhe për perspektiva individuale. Në vitin 1990 thujse askush nuk besonte se lëvizja qytetare do të ishte në gjendje t'i plotësonte nevoja të tilla.<sup>14</sup> Në këtë pikë kishte rëndësi edhe një aspekt psikologjik. Edhe pse Forumi i Ri e interpretonte termin "socializëm" ndryshe, me këtë term shumica e popullsisë asocionte 40 vjetët e diktaturës së sapokapërcyer të RDGJ-së. Ky fenomen u përdor qëllimisht prej disa partive në taktikën për fushatën elektorale të vitit 1990, fushatë e cila drejtohej kundër Partisë së Socializimit Demokratik (partisë që pasoi SED-në) si dhe kundër Lidhjes 90.

Së fundi është e padiskutueshme se realizimi i qëllimeve tepër të vështira të kësaj lëvizjeje do të kërkonte shumë kohë, forcë, privime dhe rreziqe dhe se pikërisht për këtë është tepër e vështirë të arrish një konsensus optimal mes individit dhe shoqërisë. Përpjekje të tilla mund të shkaktojnë në raste problematike edhe një situatë ngërçi politik dhe ngecjeje në vend. Shumë prej qëllimeve politike të kësaj lëvizjeje përmbajnë pretendime të forta normative (pjesërisht edhe utopike), realizimi praktik i të cilave në një nivel të gjerë shoqëror nuk mund të parashikohet, në rast se do të merren parasysh edhe korniza shtetërore apo lidhjet me politikën ndërkombëtare dhe ekonominë botërore. Këto rreziqe u futën në fund të fundit frikën edhe simpatizuesve apo mbështetësve potencialë të lëvizjes.

Një shkak tjetër për dështimin e Forumit të Ri ishte edhe mënyra e raportimit të mediave perëndimore, të cilat nuk bënë thujse asnjë përpjekje për të gjykuar në mënyrë neutrale dhe joideologjike për veprimtarinë praktike dhe relativisht të pavarur të Forumit të Ri si "aktor kolektiv" gjatë ngjarjeve të rëndësishme historike (krh. Degen 2000: 185).

<sup>13</sup> Krh. për këtë edhe kapitujt Kritika ndaj sistemit partiak të parlamentarizmit demokratik dhe Kërkimi i rrugës së tretë versus ribashkimit gjerman.

<sup>14</sup> Gjatë zgjedhjeve të para të lira në RDGJ të vitit 1990 u konstatua p.sh. se simpatizantët dhe mbështetësit e lëvizjes qytetare nga frika prej dobësisë dhe paqëndrueshmërisë politike dhe rikthimit eventual për këtë shkak të regjimit të partisë SED votuan – pavarësisht përfytyrimeve të tyre politike – për ato parti që gjatë fushatës elektorale premtuan më me forcë se do t'i jepnin në mënyrë të pakthyeshme fund RDGJ-së dhe trashëgimisë së saj diktatoriale.

## Vlerësime përfundimtare

Për shkak të koncepteve dhe të veprimtarisë së saj politike, lëvizja qytetare gjermanolindore – sikurse u parashtrua hollësisht edhe në këtë shkrim – përbën një rast të posaçëm në kuadrin e përmbyesjeve politike që përfshinë në vitet 1980-të Evropën Lindore dhe Juglindore (krh. Probst 1993: 71-80). Në rastin e "second society" kemi të bëjmë me një eksperiment social, etik dhe politik që fillimisht dukej tepër premtues se do të kishte sukses, por që shumë shpejt u marginalizua apo u ndërpre. Rëndësia teorike dhe praktike e "second society" për zhvillimin e mëtejshëm të formave demokratike të jetesës duket se nënvlerësohet. Megjithë përparësitë e demokracisë parlamentare kundrejt sistemeve autoritare diktatoriale edhe ajo e para përmban probleme si në aspektin politik, social, apo ekonomik edhe në atë etiko-moral si dhe disa deficite të caktuara demokratike. Kjo ka pasojat e veta shoqërore. Vitet e fundit në Gjermani si edhe në vende të tjera demokratike vihet re një rënie në rritje e numrit të qytetarëve që marrin pjesë në zgjedhje, një velje në rritje nga politika, zhgënjim dhe pakënaqësi me procedurat politike dhe madje edhe prania e atyre që e vënë në pikëpyetje demokracinë. Në sfondin e problemeve të tilla mund të thuhet, se konceptet e harruara politike dhe përvoja e lëvizjeve qytetare gjermanolindore si dhe pikat e saj të kritikës ndaj sistemit të demokracive perëndimore, megjithë shkallën shumë të ulët të njohjes së tyre prej opinionit të gjërë, vazhdojnë të kenë një relevancë aktuale për zgjidhjen e problemeve politike dhe ekonomike të shoqërive demokratike, edhe pse ato kanë nevojë për një zhvillim të mëtejshëm konceptual dhe programatik.

Në këtë kuadër Degen (2000: 191) shtron pyetjen se *"përse na tërheqin ne – vëzhguesve të rinj perëndimorë – idetë e lëvizjeve qytetare megjithë druajtjen dhe distancën kritike fillestare?"* dhe i përgjigjet vetë kësaj pyetjeje me këto fjalë:

*"Fillimisht këndvështrimi i pjesëtarëve të një sistemi tjetër shoqëror na hap mundësinë për të vënë re aspekte të reja të sistemit tonë dhe na zgjeron perspektivën që kemi. Përvoja e përmbyesjes së një sistemi të tërë shoqëror dhe paaftësia e ideologjisë socialiste për zgjidhjen e problemeve shtrojnë për diskutim shumë më tepër çështje parimore nga sa u diskutuan ato në Perëndim në fundin e viteve '80 dhe në fillim të viteve '90" (Degen 2000: 191v).*

Në vijim të përgjigjes së saj ajo arrin edhe në këtë vlerësim përmbledhës të koncepteve dhe procedurave të veprimit të lëvizjes qytetare:

*“Koncepti pragmatik, jo shumë ideologjik dhe i lidhur me realitetin jetësor i demokracisë së drejtpërdrejtë që ndeshim tek Forumi i Ri, ofron sipas mendimit tim potencialisht mundësinë për krijimin e grupimeve politike që do t’u përshtateshin nevojave të një shoqërie të diferencuar dhe të individualizuar. Njerëz nga nivele dhe shtresa të ndryshme sociale, me mënyra të ndryshme jetese dhe bindje të ndryshme fetare mund të angazhohen drejtpërdrejt në vend për kërkesa konkrete që mund të kenë, pa pasur nevojë që të përdorin për këtë një paketë të tërë kërkesash dhe qëndrimesh politike, si do të ndodhte kjo në rastin e angazhimit të një grupi bazë të Partisë së Gjelbër. Në radhët e Forumit të Ri u zhvillua një kulturë politike në të cilën respekti dhe vlerësimi i çdo individit ishte për shumë prej anëtarëve po kaq i rëndësishëm sa edhe trajtimi i çështjeve përmbajtësore. Njohja reciproke, këmbimi i ideve, zhvillimi i përbashkët i koncepteve demokratike të gjalla dhe kultivimi i kurajos civile, ishin realizimi në praktikë i formës dialoguese në rastin e mosmarrëveshjeve. Pretendimi komunikativ që ekzistonte brenda grupeve vazhdohej të ndiqej edhe jashtë tyre. Sidomos për t’u shënuar është p.sh. fakti, që thuajse të gjithë personat e intervistuar shprehën gatishmëri të madhe për të diskutuar me të gjitha grupet shoqërore dhe partiake dhe se edhe vepronin në atë mënyrë. (...) Çdo njeri i veçantë duhet pranuar pavarësisht botëkuptimit, ideologjisë apo përkatësisë së tij partiake” (Degen 2000: 192).*

Përmes kësaj forme diskursive të procesit të vendimmarrjes të implementuar gjatë rrjedhës së socializimit dhe të mësimin, formë e cila nuk bazohej tek teoria e pushtetit por tek etika, grupimet e lëvizjes qytetare gjermanolindore, arritën të ndiknin në fund të viteve 1980 ndaj pjesës moderne të shoqërisë, e cila shpresonte për ndryshimet demokratike, duke i dhënë asaj orientim dhe drejtim. Lëvizjet qytetare në ish-RDGJ jo vetëm që përfaqësonin pakënaqësinë kolektive ndaj sistemit, por njëkohësisht e politizuan dhe e radikalizuan këtë pakënaqësi; ato ishin si shpresë edhe pararojë e “modernizimit kulturor” të shoqërisë; ato mishëronin dhe përshpejtuan zhvillimin e elementeve të shoqërisë civile në strukturat në hije të “second society”. Si lajmëtarë dhe paraprirës të vjeshtës së vitit 1989, ata krijuan terrenin për lindjen, krijimin dhe aktivitetin e sukseshëm të lëvizjeve qytetare dhe në këtë mënyrë kanë dhënë një kontribut dhe kanë pasur një ndikim që nuk duhet nënvlerësuar për krijimin e një kulture politike me frymëzim demokratik në pjesë të tëra të shoqërisë, duke krijuar në këtë mënyrë parakushtet për rikthimin e shoqërisë civile (krh. Probst 1993: 40). Në këtë pikë lëvizja qytetare e orientuar prej demokracisë së drejtpërdrejtë në RDGJ mund të shërbejë edhe si shembull për vende apo shoqëri të tjera, në të cilat shumica e popullsisë ndien nevojën për transformime demokratike ose për forma të demokracisë participatore.



Si përfundim mund të thuhet se një pjesë e madhe e veprimtarëve, mbështetësve dhe simpatizantëve të lëvizjes qytetare gjermano-lindore të vitit 1989 në veprimtarinë e mëtejshme politike u është përshtatur mundësive dhe rrethanave shoqërore, ekonomike dhe politike të kohës. Në kuadër të proceseve të tilla të zhvillimit individual të secilit "second society" ka mbetur vetëm si një stacion i ndërmjetëm në ndërgjegjen e njerëzve që e kanë përjetuar atë. Rëndësia shoqërore, etiko-sociale dhe historike e "second society" ka humbur në kuadër të zhvillimeve të furishme historiko-politike dhe ekonomiko-shoqërore që pasuan, si dhe sidomos për shkak të globalizimit në rritje. Adaptimi dhe zgjerimi i impulseve dhe i ideve të saj në kuadrin e një niveli të gjërë shoqëror, nuk ka qenë i mundur. Për shkak të specifikës së saj, ekzistenca e kësaj lloji lëvizjeje opozitare të bazuar në demokracinë e drejtpërdrejtë, ishte pazgjidhshmërisht e lidhur me ekzistencën dhe rënien e RDGJ-së. Trualli për lindjen dhe zhvillimin e saj ishin raportet shoqërore që ekzistonin në vitet 1980 në kushtet e diktaturës së socializmit. Kjo lloji lëvizjeje mund të lindte dhe të ekzistonte vetëm në kushtet specifike të RDGJ-së. Me shpërbërjen e sistemit diktatorial të RDGJ-së u zhduk sërish edhe trualli që ushqente këtë lëvizje. Në këtë mënyrë ajo e humbi dalëngadalë edhe bazën e saj legjitimuese si faktor politik-shoqëror. Në kuadrin e përmytjes dhe të transformimit të sistemit, kjo lëvizje si forca e tretë alternative, pati vetëm funksionin e katalizatorit.

Kjo tragjikë e veçantë e historisë së lëvizjeve qytetare të vitit 1989 që bazoheshin te parimet e demokracisë së drejtpërdrejtë, lidhet me faktin se suksesi i tyre, shpërbërja e diktaturës së RDGJ-së, çoi njëkohësisht edhe në dështimin e tyre dhe së fundi thithjen e tyre prej një sistemi tjetër ekonomiko-shoqëror. Ky sistem përbënte për aktivistët e kësaj lëvizjeje një alternativë shumë më të mirë sesa diktatura e RDGJ-së, edhe pse ai në fakt nuk u përgjigjej përfytyrimeve të tyre politike dhe shoqërore.

Pyetja nëse parimet dhe përvoja e kësaj lëvizjeje mund të përdoren dhe të zhvillohen në të ardhmen në vende diktatoriale apo për thëllimin e procesit të demokratizimit në rastin e sistemeve të demokracive parlamentare, nisur prej shtimit të pakënaqësive sociale dhe politike, mbetet e hapur.

## Bibliografi

- Anti IWF-Erklärung (1988) në: Friedrichsfelder Feuermelder, September 1988, fq. 21.
- Baule, Bernward (1991) „Wir sind das Volk!“. Politische Bedingungsfelder der Freiheitsrevolution in der DDR, në: Löw, Konrad (Edit.), Ursachen und Verlauf der deutschen Revolution 1989, 2., unveränd. Aufl., Berlin, fq. 17- 44.
- Bundeswahlleiter (1994) Wahl zum 4. Europa-Parlament (12.06.94): Bundesergebnis, [www.bundeswahlleiter.de/de/europawahlen/fruehere\\_europawahlen/ew1994.html](http://www.bundeswahlleiter.de/de/europawahlen/fruehere_europawahlen/ew1994.html).

- Degen, Christel (2000) Politikvorstellung und Biografie. Die Bürgerbewegung Neues Forum auf der Suche nach der kommunikativen Demokratie, Opladen.
- Fricke, Karl-Wilhelm (1984) Opposition und Widerstand in der DDR, Köln
- Geisel, Christof (2005) Auf der Suche nach dem dritten Weg. Das politische Selbstverständnis der DDR-Opposition in den 80er Jahren, Berlin.
- Hürtgen, Renate (1999) "Die Erfahrung laß mir nicht nehmen!" "Demokratieversuche der Belegschaften in den DDR-Betrieben zwischen Oktober 1989 und Januar 1990, nê: Gehrke, Bernd / Rüdtenklau, Wolfgang (Edit.), ...das war doch nicht unsere Alternative. DDR-Oppositionelle zehn Jahre nach der Wende, Münster.
- Knabe, Hubertus (1988) Neue Soziale Bewegungen im Sozialismus. Zur Genesis alternativer politischer Orientierung in der DDR, nê: Kölner Zeitschrift für Soziologie und Sozialpsychologie 40 (1988), S. 554-557.
- Krech, Hans (2005) Der Untergang der DDR als Katalysator für das Ende des Kalten Krieges, Berlin.
- Lemke, Christiane (1991) Die Ursachen des Umbruchs 1989. Politische Sozialisation in der ehemaligen DDR, Opladen.
- Malzahn, Claus Christian, Sie wollte Gerechtigkeit und bekam den Rechtsstaat, [www.welt.de/politik/deutschland/article9566915/Sie-wollte-Gerechtigkeit-und-bekam-den-Rechtsstaat.html](http://www.welt.de/politik/deutschland/article9566915/Sie-wollte-Gerechtigkeit-und-bekam-den-Rechtsstaat.html), 11. September 2010.
- Neues Forum, Gründungsaufruf (1989) nê: Rein, Gerhard (Edit.), Die Opposition in der DDR. Entwürfe für einen anderen Sozialismus, Berlin 1989, fq. 13v.
- Pflugbeil, Sebastian (Interview), "Wir müssen die Reform mit den Genossen machen.", nê: Rein, Gerhard (Edit.), Die Opposition in der DDR. Entwürfe für einen anderen Sozialismus, Berlin 1989, S.26.
- Pollack, Detlef (2000) Politischer Protest, Politisch alternative Gruppen in der DDR, Opladen.
- Probst, Lothar (1993) Ostdeutsche Bürgerbewegungen und Perspektiven der Demokratie. Entstehung, Bedeutung und Zukunft, Köln.
- Probst, Lothar (2007) Neues Forum (Forum), nê: Decker, Frank / Neu, Viola (Hrsg.), Handbuch der deutschen Parteien, Wiesbaden, fq. 347-350.
- Rochtus, Dirk (1999) Zwischen Realität und Utopie. das Konzept des dritten Weges in der DDR 1989/90, Leipzig.
- Roth, Roland, Social Movement Areas Revisited. Theoretical Implications of Empirical Findings in West Germany, Manuskript für einen Beitrag auf der "First European Conference of Social Movements" in Berlin (29.-31. Oktober 1991).
- Schorlemmer, Friedrich (1991) Bis alle mauern fallen. Texte aus einem verschwundenen Land, Berlin.
- Torpey, John (1992) Two Movements, not a Revolution. Exodus and Opposition in the East German Transformation 1989-1990, nê: German Politics and Society 26 (1992), fq. 21-42.
- Trömmner, Markus (2002) Der verhaltene Gang in die deutsche Einheit. Das



Verhältnis zwischen den Oppositionsgruppen und der (SED)-PDS im letzten Jahr der DDR, Frankfurt

- Wielgohs, Jan / Schulz, Marianne (1991) Von der illegalen Opposition in die legale Marginalität. Zur Entwicklung der Binnenstruktur der ostdeutschen Bürgerbewegung, nē: Berliner Journal für Soziologie, Heft 2 1991, fq. 383-392.
- Wolfram, Klaus (1999) DDR-Opposition vor 1989, nē: Gehrke, Bernd / Rüddenklau, Wolfgang (Edit.), ...das war doch nicht unsere Alternative. DDR-Oppositionelle zehn Jahre nach der Wende, Münster.

## “SHKRUAR“ NË KOKË – LETËRSIA E INDOKTRINUAR E REALIZIMIT SOCIALIST DHE LETËRSIA E PABOTUAR NËN DIKTATIN E SAJ

Dr. Eldon Gjika

Panorama e letërsisë shqipe brenda kufijve shtetërorë të Shqipërisë,<sup>1</sup> me pikënisje gjysmën e dytë të shekullit XX dhe me cak kohor vitin 1990, paraqitet e deformuar. Duke i mbajtur parasysh “kushtëzimet prapatërheqëse të sistemit letrar e kulturor shqiptar në përgjithësi, dikur më të forta, pastaj më të pakta, por kurdoherë vepruese”,<sup>2</sup> mund të themi se segmenti kohor, të cilit po i referohemi (1945-1990), është nga *prapatërheqësit* më çoroditës. Nisur nga konceptimi i letërsisë si (*poli*) *sistem*,<sup>3</sup> ky deformim shfaqet tek të gjithë faktorët. Even-Zohar propozon këtë skemë për sistemin letrar:<sup>4</sup>

INSTITUCIONI [konteksti] REPERTORI [kodi]	
PRODHUESI ("shkrimtari")	KONSUMATORI ("lexuesi")
TREGU [kontakti / kanali] PRODHIMI [mesazhi]	


Kjo skemë të jep dorë të postulosh tezën se *sistemi letrar shqiptar (1945-1990) pëson deformim prej centralizimit të skajshëm; faktori INSTITUCION e gjeneron deformimin në linjë vertikale*. Bazuar në faktin se centralizmi realizohet si pasojë e kontrollit të politikës mbi institucionet, rezulton kjo tablo:

<sup>1</sup> Këtu dhe në vijim, me *letërsi shqiptare* i referohemi kryesisht letërsisë *brenda* kufijve shtetërorë të Shqipërisë.

<sup>2</sup> Jorgo 2004: 28

<sup>3</sup> Sipas Itamar Even-Zohar 1990: 11v; 18: “Sistemi, nga njëra anë, konsiston tek sinkronia dhe diakronia së bashku, nga ana tjetër, secila prej tyre, veçmas, është qartësisht e dukshme brenda sistemit. Gjithashtu, nëse idea e strukturimit dhe e sistematizimit, ka nevojë të identifikohet me homogjenitetin, sistemi semiotik mund të përfytyrohet si heterogjen, me struktura të hapura. [...] Ky i fundit është domosdoshmërisht një *polisistem*, një shumësi sistemesh, një sistem që ka brenda sisteme të ndryshme, të cilët kryqëzohen me njëri tjetrin dhe pjesërisht shtresëzohen, duke përdorur në mënyrë konkurruese mundësi të ndryshme, tashmë duke funksionuar si një strukturë tërësore, ku secili syresh është i ndërvarur. [...] Termi *polisistem*, synon të nxjerrë në pah konceptin e një sistemi dinamik dhe heterogjen, në opozicion me këndvështrimin sinkronik. [...] Shkurtazi, për teorinë e polisistemit, sistemi letrar, mund të formulohet: Rrjeti i marrëdhënieve, i cili hipotetizohet se vepron ndërmjet një numri aktivitetesh të emërtuara si ‘letrare’, por edhe vetë këto aktivitete të vëzhguara përmjet rrjetit”. Khs, edhe Tynjanov 1968; Corti 1980: 13-17; Gnisci 2002:165v; Zhenet 1985:27-31.

<sup>4</sup> Even-Zohar 1990:31



Ky shkrim pëqendrohet vetëm në gjendjen e *prodhimit letrar* në vitet 1945 -1990, sepse ky prodhim mundëson një ilustrim të qartë të deformimit të sistemit letrar shqiptar në tërësi.

## Letërsi e bazuar thellësisht në ideologji

Prodhimi letrar u shtrëngua detyrimisht nën rregullat e metodës zyrtare të realizmit socialist, gjë që solli, në pjesën më të madhe, një letërsi të bazuar thellësisht në ideologji, pa vlera të vërteta. Realizmi socialist në letërsinë shqiptare, në thelb, duhet përfillur si një *kanonizëm dinamik*,<sup>6</sup> sepse kjo metodë nuk imponohet përmes teksteve, por merr udhë dhe dominon si një model i importuar rregullash dhe normash letrare, të detyrueshme për të qenë në bazë të prodhimit letrar.

Realizmi socialist ishte një metodë krijuese e letërsisë dhe arteve, që u zbatua fillimisht në ish-Bashkimin Sovjetik dhe më pas më intensivisht në gjithë vendet ish-komuniste gjatë shekullit të 20. Në historinë e mendimit letrar të vendeve ish-komuniste realizmi socialist është konsideruar për një kohë të gjatë si shkalla më e lartë dhe më e përparuar e zhvillimit të realizmit. Përfaqësuesi kryesor në shkallë botërore konsiderohet shkrimtari bolshevik, Maksim Gorki, me romanin “Nëna”, edhe pse në kohën e botimit të kësaj vepre ky term nuk ekzistonte dhe parimet kanonike-doktrinare të metodës nuk ishin përcaktuar. Sipas Maria Zalamban-it e

<sup>5</sup> Për më shumë mbi konceptet *institucion*, *repertor*, *prodhues*, *konsumator*, *treg*, *prodhim* Even-Zohar 1990: 30v

<sup>6</sup> Sipas Even-Zoharit 1990: 19 termi *kanonizëm* i referohet si nivelit të teksteve, ashtu edhe nivelit të modelit. Në rastin e parë kemi të bëjmë me një *kanonizëm statik*, ndërsa në rastin e dytë me një *kanonizëm dinamik*. shih *static vs. dynamic canonicity*.

gjithë esenca e realizmit socialist përmbledhet në slloganin e Zhdanovit në Kongresin e parë të Shkrimtarëve Sovjetikë:

*“Ne pohojmë që realizmi socialist është metoda themelore e letërsisë dhe e kritikës letrare sovjetike, dhe kjo parashikon që romantizmi revolucionar të jetë pjesë përbërëse e krijimit letrar, meqenëse e gjithë jeta e partisë sonë dhe e klasës punëtore dhe lufta e tyre qëndrojnë te bashkimi i punës praktike më të ashpër dhe të rreptë me një maksimum heroizmi dhe perspektivash vërtet madhështore”<sup>7</sup>*

Kjo metodë mbështetet në ideologjinë dhe filozofinë markiste-leniniste; ishte metodë e angazhimit politik të shkrimtarëve dhe të artistëve në përputhje me ideologjinë sunduese, ideologjinë komuniste dhe përmes saj, shteti komunist ushtronte kontrollin e vet tërësor mbi proceset krijuese në letërsi, arte dhe kulturë. Parimet themelore mbi të cilat u mbështet realizmi socialist ishin: partishmëria proletare dhe fryma progresive; vlerësimi social-klasor i realitetit, i ngjarjeve dhe i njerëzve; karakteri kombëtar dhe fryma popullore; përmbajtja socialiste dhe forma kombëtare, heroi pozitiv dhe optimizmi revolucionar.

Realizmi socialist nxiti skematizmin, përshtatjen politike, solidaritetin me ideologjinë sunduese dhe propagandën e kohës. Letërsia dhe artet e realizmit socialist ndoqën vijën politike dhe parimet ideologjike, duke ngarkuar veten me role agjitative.

## Realizmi socialist në Shqipëri

Prirjet e para për një letërsi të angazhuar politikisht dhe ideologjikisht në përputhje me kërkesat e realizimit socialist në Shqipëri lindën qysh gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Një grup shkrimtarësh dhe artistësh që morën pjesë aktive në luftë dhe luajtën rol në shtypin e saj (F. Gjata, Sh. Musaraj, Ll. Siliqi, K. Jakova etj). e nisën rrugën krijuese si themelues të realizmit socialist në Shqipëri. Ndërkohë edhe shkrimtarët e brezit të viteve 1930 (Dh. S. Shuteriqi, A. Varfi, A. Çaçi) iu bashkuan shumë shpejt kësaj metode.

Fryma pllakateske, heroizmi skematik, angazhimi i hapur ideologjik, që karakterizojnë realizmin socialist, prekën thellë edhe letërsinë shqipe. Disa nga kryemetaforat e ligjëritimit totalitar të radhitura nga studiuesi A. Vehbiu<sup>8</sup> janë lehtësisht të verifikueshme në letërsinë e prodhuar në këtë periudhë:

<sup>7</sup> Zalambani 2003: 131

<sup>8</sup> Shih Vehbiu 2007: 184-230

a. *Metafora e rrethimit* sipas së cilës popullit shqiptar i është dashur në shekuj të përballej me një luftë për jetë a vdekje me armikun e jashtëm dhe të brendshëm duke dalë gjithnjë fitimtar. Një nga shembujt më ilustrues të kësaj metafore është romani “Kështjella” i Ismail Kadaresë.

b. *Imazhi i armikut*, kjo kryemetaforë zë një vend qendror në ideologjinë dhe mitologjinë totalitare, e cila transmetohet dhe kultivohet fort edhe në letërsi. Mund të thuhet se pothuaj në mënyrë ekskluzive në të gjithë letërsinë shqipe soc-realiste figura e armikut bashkëshoqërohej me një ngarkesë emocionale negative; ai ishte gjithnjë i egër, i pamëshirshëm, gjakpirës, mizor, gjakatar etj. Një rast përjashtimor përbën kjo figurë në disa vepra të Petro Markos, ku paraqitet në trajta më të humanizuara ( „Qyteti i fundit“, „Nata e Ustikës“).

c. *Heroi pozitiv* ishte gjithnjë antipodi i armikut, përfaqësues i shoqërisë së shëndetshme socialiste dhe kësisoj i Shqipërisë së pamposhtur. Një pjesë e mirë e teksteve letrare poezi e prozë iu kushtuan kultit të rinisë në aksione për ndërtimin e hekurudhave, të brigadave vullnetare. Kjo letërsi në koherencë të plotë me vijën e partisë u funksionalizua në krijimin e kultit të njeriut të ri që i vlonte gjaku ndër deje, që punonte natë e ditë për ndërtimin e socializmit.

d. *Ndërtimi i kultit të udhëheqësit*, respektivisht Enver Hoxhës, ishte një detyrë permanente e letërsisë shqipe. Figurës së Hoxhës si prijës largpamës dhe i përrjetshëm, i kushtohen shumë e shumë tekste.

e. *Figura e sëmurë dhe dekadente e intelektualit mikroborgjez* është shpesh e pranishme në veprat letrare të periudhës së komunizmit. Në faqe librash figura e intelektualit do të paraqitej si një individualist i vetmuar, me sedër të sëmurë, që ndikohet nga morali borgjez dhe nga shfaqjet e huaja.

Poezi të angazhuar, shkruan edhe shkrimtarët më të talentuar të kësaj periudhe: “Shqiponjat fluturojnë lart” apo Ëndërr Industriale (Ismail Kadare), “Nënë Shqipëri”, “Devoll, Devoll”, “Poemë për babanë dhe për veten” (Dritëro Agolli); “Alarme të përgjakura”, “Drejt qindra shekujsh shkojmë” (Fatos Arapi) dhe shumë autorë të tjerë.

## Letërsia e censuruar dhe e ndaluar

Megjithë masat shtërnguese ka edhe një varg veprash që u përkasin kohës të ndryshme, të cilat nuk i mbetën krejtësisht besnik realizmit socialist, pra nuk mbetën peng të dogmës dhe për këtë arsye u ndaluan dhe u censuruan, për shembull:

“Përbindëshi“ I. Kadare, “Tuneli“ Dh. Xhuvani, “Njollat e murrme“ M. Jero, “Zgjimi i thellësive“, Xh. Spahiu etj.

Këto vepra por edhe të tjera u ndaluan ose u hoqën nga qarkullimi për nxirje realiteti, formalizëm, ekstravagancë, ndikime të huaja, dekadencë dhe lëshime ideologjike. Pati shkrimtarë e poetë, të cilëve iu hoq përkohësisht e drejta e krijimtarisë ose që u dënuan me heqje lirie apo internim për shkaqe ideologjike që lidheshin me krijimtarinë ose me jetën e tyre (S. Malëshova, K. Trebeshina, Dh. Xhuvani, V. Zhiti etj.)

## Deri në fund besnikërisht përcjellëse e kumteve të pushtetit

Pjesa dërmuese e letërsisë shqipe, shkruar dhe botuar brenda kufijve shtetërorë të Shqipërisë, ishte besnike ndaj parimeve të realizmit socialist, gjë që solli një letërsi propagandistike, pa vlera të vërteta estetike dhe pllakateske. Një nga veçantitë e lëvrimin të realizmit socialist në letërsinë shqipe ishte se ky vazhdoi deri në fund i shtrënguar rreptë në dogmat dhe kanonet ideologjike, ndryshe nga vendet e tjera ish komuniste. Nëse në këto vende sidomos pas vitit 1960 pati një frymë politike revizionuese, e cila u transmetua edhe në letërsi e arte, Shqipëria ishte i vetmi vend ish-komunist ku kjo nuk ndodhi. Për pasojë letërsia shqipe e modeluar sipas realizmit socialist, vazhdoi të ishte deri në fund besnikërisht përcjellëse e kumteve të pushtetit.

Megjithatë kjo letërsi me autorët përkatës nuk duhet përfytyruar si bllok monolit pa vlerë sepse në këtë periudhë letërsia shqipe sidomos në vitet 1960 e tutje, e sidomos në prozën e gjatë, romanin, pasurohet me vepra me nivel të lartë që edhe sot mbeten të një rëndësie parësore për të. Pra kjo letërsi funksionoi me *autorë të talentuar* dhe me *autorë të patalentuar*, por është e vështirë, në mos po e pamundur që të gjejmë *autorë ndryshe* në këtë letërsi. Kushtet politike në Shqipërinë e atyre viteve e bënë të pamundur botimin dhe recetimin e një *letërsie alternative* karshi realizmit socialist.

Ndërkohë ka autorë të talentuar që në poetikën e diskursit letrar nuk mbetën ortodoksë ndaj dogmës së realizmit socialist, por kjo shtrihet vetëm në aspektin imanent të tekstit, si strukturim rrëfimor, ndërsa në planin semantik e theksoj që mosrevizionimi i komunizmit shqiptar e bënte të pamundur që një vepër të mos ishte politikisht në koherencë me kumtet e pushtetit, ideologjisë, që është edhe thelbi i realizmit socialist.



## Letërsia e sirtareve

Përveç letërsisë së botuar në Shqipëri ka ekzistuar edhe letërsia e burgjeve dhe *letërsia e sirtareve*; krijuesit që për arsye të persekutimit politik, ishin privuar nga botimi, por që kishin vazhduar të shkruanin, botojnë librat e tyre në prozë, poezi, dramaturgji, memuaristikë etj. Ndër autorët më përfaqësues mund të përmendim Kasëm Trebeshinën, Bilal Xhaferrin, Bashkim Shehun, Fatos Lubonjën, Zef Zorbën, etj. Duhet thënë se kjo letërsi për shkak të regjimit stalinist në Shqipëri e kishte të pamundur të komunikonte me lexuesin, kështu që botimi i saj dhe receptimi prej publikut nisi pas vitit '90.

Nëse do të krahasonim prodhimin letarar soc-realist me letërsinë e burgjeve dhe të sirtareve, do të rezultonin disa çifte opozicionale makro-shenjorë që formohen prej specifikave, që burojnë nga kategoritë autor *militant* dhe autor *meditant*: optimizëm / dilemë; pasqyrim besnik i realitetit / fantazi dhe imagjinatë; entuziazëm / fatalitet; heroi, si model i përparimit / individi, me pikëpyetje; pohim i idealit komunist / kërkim i idealit; partishmëri proletare / spekulim filozofik; moralizimi / liria personale etj.

Megjithatë në Shqipërinë komuniste letërsia alternative nuk arriti të formohet dhe të shfaqet asnjëherë si disidencë artistike, me parime krijuese të shqiptuara, me një opozicion të qartë artistik ndaj realizmit socialist, me ndonjë traktat apo doktrinë estetike të përpunuar.

## Bibliografi

Even-Zohar, Itmar (1990) *Polysystem Studies* në Poetics Today - International Journal for Theory and Analysis of Literature and Communication, vëll 11, nr. 1, <http://itamar.even-zohar.com>

Corti, Maria (1980) *Principi della comunicazione letteraria*, Bompiani, Milano

Jorgo, Kristaq (2004) *Avangarda si provokim për historishkrimin e letërsisë shqiptare*, në Fenomeni i avangardës në letërsinë shqiptare, Arbëria, Tiranë

Tynjanov, Jurij (1968) *L'evoluzione letteraria*, në I formalisti russi, bot. T. Todorov, Einaudi, Torino

Unisci, Armando et. al (2002) *Letteratura comparata*, Mondadori, Milano

Vehbiu, Ardian (2007) *Shqipja totalitare*, Çabej, Tiranë

Zalambani, Maria (2003) *Dall'avanguardia al realismo socialista*, Carocci, Romë

Zhenet, Zherar [Genette, Gérard] (1985) *Figura*, Rilindja, Prishtinë

## LECKA LEGJENDASH TË GRISURA E TË COPTUARA NGA ERA E REVOLUCIONIT – POEMA SHQIPTARE MES VITEVE '60 – '70 NJË AVENTURË MES REALIZMIT DHE IREALIZMIT

Arian Leka

Tema që trajtojmë këtu gjykoj se ka nevojë për disa shpjegime paraprake, që bëhen të domosdoshme për të larguar çdo keqkuptim apo çdo ngjyrim të mundshëm nihilistik, me të cilin mund të vishen argumentat e saj.

Më së pari, falë vetë natyrës që shfaqin, trajtimi i prurjeve letrare në letërsinë shqipe në formën e disa “pelegrinëve të vonuar” të prurjeve dhe të risive letrare të Evropës – me fort gjasë mund të vështrohet si një formë kallëzimi ndaj pranisë apo jo të asaj që në letërsi njihet përmes një emërtimi fort të lëkundshëm: shprehimisht këtu, si “originalitet”. Me këtë artikull nuk synoj të jem as kritikues nihilistik, as përjashtimor, as artificialisht shterues, por të jap një kontribut në qartësimin e termit se sa e re ishte letërsia e zhvilluar nën termin “realizëm socialist”, e cila fillimisht u shfaq nën terminologji më të zbutura dhe joklasifikuese si psh “drejtim i ri letrar”, “letërsi e re”, “më progresive dhe popullore” etj.

Por le t'i kthehemi argumentit bazë. Mbërritja e këtyre zhvillimeve dhe risive letrare të Evropës në letrat shqipe si “pelegrinë të vonuar”, duket se përbën një dukuri që i ka shoqëruar letrat shqipe që prej fillimeve të veta, çka besojmë se vërehet lehtë nga çdo njohës i prurjeve letrare të Evropës. Do të mjaftonte të sillnim si shembull një vepër si *Historia e jetës dhe e bëmave të Gjergj Kastriotit Skënderbeut* e Marin Barletit, e vështruar nga shumëkush si një vepër që i përgjigjet përkitazi të zhvillimeve dhe frymës së Evropës së atyre kohëve. Nga pikëpamja e frymës dhe mendësisë, vepra e Barletit ndan shumëçka me humanizmin e Rilindjes Evropiane të shekullit XVI, që aso kohe kishte nisur të jetonte fazën e fundit si një lëvizje kulturore sunduese; porse, parë nga këndvështrimi letrar, nga zhanri i zgjedhur dhe modelet rrëfimtare, vepra e Barletit shfaqet një “pelegrin i vonuar” i një forme letrare që kishte nisur të lëvrohej qysh në kohën kur Evropa prihej drejt një sistemi të ri kalendarik, hagiokronologjisë, kohës së paraqitur përmes kujtimit të shenjtorëve – heronjve të ri, siç i quan Jacques Le Goff në *Lindja e Evropës në Mesjetë* – e cila pati sjellë në mënyrë të natyrshme edhe nevojën e lëvrimin të letërsisë hagiografike, e cila në kapërcyell të shekullit X u përdor si formë letrare edhe për jetën e mbretërve dhe sundimtarëve, të cilët duhet të shërbenin si një “model” dhe “burim frymëzimi” për masat e gjera. Vështruar nga pikëpamja letrare, pra, vepra e Barletit mbart një anakronizëm, shfaqet një “pelegrin i vonuar”.

Porse, sikundërse u shprehëm edhe më lart, qëllimi që na paraprin në këtë shkrim, nuk është assesi demistifikues, as nihilistik, as përjashtimor, dhe aq më pak shterues. Të tilla sjellje burojnë nga disa patologji depresivo-maniakale që lindin nga, dhe i përgjigjen hap pas hapi logjikës “ja risi, ja s’ka”, dhe fshehin në thellësi një krizë të thellë identitare, qoftë edhe thjesht në një rrafsh kulturor e letrar. Jemi larg të tilla prirjeve a qëllimeve. Në këtë shkrim do të donim të nxirrnim në pah thjesht dhe vetëm disa nga shkaqet e kësaj dukurie, e cila e ka shoqëruar letërsinë shqipe në thuajse tërë zhvillimet përkatëse. Si shembull nga më të fundit të kësaj dukurie kemi marrë praninë e frymës së futurizmit në letrat shqipe dhe, për të ngushtuar disi këndin e vështrimit, në disa sjellje të poezisë shqipe mes viteve ’60 -’70.

Sjellja në vëmendje e viteve, besojmë se e shndërron vetvetiu praninë e futurizmit në poezi në një “pelegrin të vonuar”, madje, ca si shumë të “vonuar”, nëse do të gjykonim me mendjen e ftohtë të një njeriu që është i vetëdihëm për larminë e rrymave dhe të brezave poetikë të letrave evropiane, si dhe për vetë shpejtësinë me të cilën ato i lanë stafetën njëri-tjetrit, nëse mund të shprehemi kësisoj.

Si rrymë letrare dhe kulturore, futurizmi, siç dihet, mund të shtratëzohet lehtësisht në koordinata kohore, kulturore dhe ideologjike. Jemi në fundin e dhjetëvjeçarit të parë të shekullit XX. Të ushqyera me oksigjenin e bollshëm të shkencave e të teknologjive që po zhvilloheshin me një hov dhe ritëm marramendës, prirjet për sipërmarrje mbinjerëzore, nga njëra anë, dhe prirjet ekspansioniste nga ana tjetër, nisën që të bashkoheshin në një shtrat të vetëm, duke krijuar një neurozë që do të shpërthente pashmangshëm në çastin e pjekjes, më 1914. Ndërsa nga pikëpamja e ideologjisë, kemi një përzierje të sforcuar të ideve Nietzsche-iste me prirjet dhe shpresat e pozitivizmit teknokratik, nga pikëpamja estetike dhe letrare, zhvillimet e teknologjisë dhe të shkencave të ndryshme e përbalën letërsinë me një mori nevojash dhe mundësish të reja shprehëse. Shtrirja e njohurive të njeriut, forca e tyre depërtuese në shtresat e mistershme të gjithë sa përbënin ligjësitë dhe thelbin e natyrës, sollën lindjen e një kulture të re politike, e cila nisi të kërkojë – siç ka ndodhur rëndom përgjatë historisë – mbështetjen e një kulture të re artistike.

Brenda një atmosfere të tillë të ngarkuar, futurizmi mëtoi më së pari të ofrohej si një alternativë e mundshme, a ndoshta si një *a-vent-urë*. Ndërsa në rrafshin ideologjik, futurizmi njihet për karakterin luftarak dhe himnizimin e luftës, në rrafshin estetik, njihet më së pari për flakjen tëhu të moralizmit. I shtratëzuar në “absolute”, me “kohën” dhe “hapësirën” të ndryrë në “arkivole” të çeliktat dhe hermetikisht të mbyllura, futurizmi mëtoi ta vendoste gjithçka në pasqyrat e pamjes, e dukjes, apo të njohjes. Jemi përpara demistifikimit *par excellence*. I gjendur nën ethet e një zhvillimi që po shtrinte gjithnjë dhe më tepër e në mënyrë marramendëse mbarë fuqitë e njerëzores, futurizmi u përpoq të ishte një dorë që guxoi të largonte “moralizmin” që e mbronte nga “turpi”, nga “mëkati” dhe nga

“mallkimi”; të heqësh atë “gjethe”, të nxirrje në dritë të diellit gjithë sa gjykohej se duhej të qëndronte e mbuluar, do të thoshte shprehimisht të çliroje nga zinxhirët “mëkatin” dhe “mallkimin”, i cili në një hapësirë “absolute” pushon së paturi atë peshë dhe atë tmerr që kishte në hapësirat jashtë “absolutes”. Parë në këtë drejtim, futurizmi mëtoi, dhe ia arriti të shfaqej një provokim, shijen e të cilit e hasim edhe sot e gjithë ditën në mbarë Evropën.

Përpos kësaj, futurizmi, në funksionin e lëvizjes së dorës, mëtoi të shkonte akoma edhe më tej: njëlloj si shoku i Odiseas, edhe futuristët, të shtyrë së tepërmi nga demistifikimi i gjithçkaje, guxuan të vinin dorë tek kaceku, ku perëndia Eol pati ndryrë erërat. Futurizmi hapi një kacek të tillë, duke sjellë një klimë furtunash dhe shpejtësie në mbarë zhvillimet letrare të Evropës së viteve të mëvonshme. Futurizmi mëtoi të ishte një sakrilegj prometeik ndaj hyjnive: mëtoi t’u rrëmbente syresh natyrën dhe përmasën hyjnore për t’ia veshur tërësisht njerëzores...

Parë nga këndvështrimi letrar, hapja e kacekut të erërave, shënjon dëbimin e Apollonit, dhe rikthimin në skenë të Dionisit, të “shpirtit dionisiak” së trumbetuar nga Nietzsche. E përkthyer në terma letrarë, fjala është për hedhjen pas krahëve të rendeve ekzistuese, të kristalizuara sipas logjikës dhe kategorive të njohura aristotelike. Futurizmi e shprehu një prirje të tillë me një qartësi simptomatike: sintaksa, vendosja e gjërave sipas një rendi të kushtëzuar nga diçka tjetër nga vetë gjërat (shprehimisht këtu nga logjika dhe ligjësitë e kategorizimit - *taksonomia*), është i pari element që lipset shkatërruar, duke u hapur një shteg të lirë gjërave (emrave) të krijojnë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me njëri-tjetrin. Parë nga ky drejtim, vetëparaqitja e futurizmit si një stil realist – si një përpjekje për të trupëzuar “realen” dhe “realitetin” në një vepër arti – besojmë se na shpërfaqet logjikisht më se e qëndrueshme.

Porse, sikundërse u shprehëm edhe më lart, futurizmi shfaqet më tepër i rëndësishëm në gjithë sa provokoi, në gjithë sa vendosi në lëvizje, sesa në gjithë sa realisht krijoi. Me futurizmin, letërsia i qaset një forme tjetër të realizmit letrar; prirjet e tij shkojnë përtej nocionit të atyre kahjeve realiste të shekullit XIX që mëtonin ta paraqisnin letërsinë dhe realitetin letrar si një dritare nga bota, për të kristalizuar një realizëm të ri, një realizëm në përputhje me realitetin kompleks të jetës moderne: një realitet ky dinamik, fragmentar, i bashkëkohshëm dhe retorikisht i stisur.

Duke thënë këtë, personalisht mendojmë se kemi shprehur tashmë edhe anën tjetër të medaljes në lidhje me futurizmin: shprehimisht këtu, fundin e tij në bazë të po së njëjtës ligjësie që mundësoi edhe lindjen e tij si lëvizje letrare dhe kulturore. Futurizmi u shfaq apokaliptik dhe ikonoklastik ndaj traditës së mëparshme për shkak të “realitetit të ri”, “realitetit të jetës moderne”, dhe po kësaj ligjësie i nënshtrohet edhe vetë.

Ndryshimi i këtij “realiteti” solli perëndimin e “realitetit” të mëparshëm,

e bashkë me të perëndoi edhe “kultura artistike” që ky “realitet” mundësoi. Shprehimisht këtu, fundi i Luftës së Dytë Botërore shënoi fundin e neurozës që përmendëm në hyrje; fundi i saj, shënjoj edhe konsumimin e paradigmës futuriste, e cila u pasua nga neorealizmi. Porse, pavarësisht kësaj, futurizmi solli në vëmendje një të vërtetë që shfaqet e vyer për qëllimin e kumtesës sonë. Shprehimisht këtu, të vërtetën se letërsia – për aq sa është një formë gjuhësore – është shprehje e pastër e një “forme jete”, siç do të ishte shprehur, gjykojmë, Wittgensteini.

Nëse marrim parasysh këtë, besojmë se shfaqja e futurizmit – apo, më së paku, e një lloj fryme futuriste – në disa poezi shqipe të viteve ’60 -’70, në mos na vendos përpara një të vërtete shteruese, arrin, më së paku, të na ofrojë një mundësi logjike të kuptimshme.

Çdo të thotë kjo? – Shprehimisht këtë: bujtja e zhvillimeve dhe e risive letrare të Evropës në letrat shqipe si “pelegrinë të vonuar” përbën një dukuri që lidhet, ndoshta, me kohën e shfaqjes në Shqipëri të atyre “formave të jetës” që mundësuan lindjen dhe zhvillimin e prurjeve dhe risive në fjalë. Dhe kjo, besojmë, i brendashkruhet edhe rastit të bujtjes së prurjeve dhe risive poetike të futurizmit në disa poezi të viteve ’60 -’70. Në këto poezi të viteve në fjalë, vërehen dukshëm disa nga tonet më të spikatura futuriste, sikundërse edhe një sistem *tropeik* që kullon frymë futuriste.

## Jo këngë shoqëruese, por këngë që diktojnë marshimin

Sa i përket tonit, në poezitë në fjalë mbizotëron dukshëm karakteri luftarak; “kjo është këngë e alarmeve”, lexojmë në një poezi, “është këngë lufte”, “nga lufta po vijmë për në luftë po shkojmë”, lexojmë në një tjetër; lufta është e pashmangshme; marshimi drejt frontit ka nisur tashmë (“për në luftë po shkojmë”); herë e dukshme, herë e padukshme, porse e ndjeshme, tejet e ndjeshme. Poezia thirret jo për të qenë një këngë shoqëruese, por kënga që dikton dhe nxit vetë marshimin si të tillë: është një poezi lufte. E jo vetëm kaq: vargjet e saj shndërrohen ja në “dinamit” (“Por kam qejf që ndryshe ta çaj shkëmbin... lumenj e mal të trembim... me dinamit e varg”, siç lexojmë në një poezi), ja në ushtarë (“po ju dërgoj si ushtarë nizamë/në vijën e parë të luftës”, siç lexojmë në një tjetër). E shndërruar në këngë lufte, poezia nuk ka vend – njëlloj si në rastin e poezisë futuriste – për sentimentalizëm, për *histoires roses*. E jo vetëm kaq: ajo merr përsipër t’i hyjë deri edhe një shndërrimi antropologjik; si në rastin e futurizmit, edhe për këtë poezi, gruaja si grua, me të tërë cilësitë dhe tiparet antropologjike që i dikton natyra dhe gjinia, del jashtë (“ti dole nga kënga ime... Ti doje që të rrije në një këngë më të qetë”). Tashmë për gruan si qenie njerëzore ka vetëm një rrugë për të jetuar brenda vargut dhe poezisë: të shndërrohet antropologjikisht, të heqë dorë nga feminiteti, nga të qenit grua,

për t'u shfaqur si burrë, “të ashpra”, për të jetuar “një jetë më serioze”, “jetën e revolucionit”, “jetën e luftës”.

## Shkatërrimi i botës së vjetër dhe ngadhnjimi i revolucionit

Krahas kësaj, toni i këtyre poezive mbart padyshim edhe klimën e apokalipsit, kaq fort e pranishme edhe në poezinë futuriste. Është një poezi që na përball me të njëjtin grotesk apokaliptik të vënë në lëvizje nga futuristët: me “kombe me një sy”, “popuj të gjymtuar”, “shtete me paterica”, apo me “marshimin e akullnajës” (“Unë eci përpara, rrëshqas, gjithçka përtej: Shtete, gadishuj, luftëra, popuj, skaj më skaj”, lexojmë në një poezi). Është poezi apokaliptike e “botës së vjetër” (“Copëra imazhesh të botës së vjetër notojnë në erë / Pirgje kështjellash, paragrafë të përgjakur kanunesh, lecka legjendash / Të grisura e të copëtuara nga era e revolucionit”), shkimët me apokalipsin që mëtoi të sillte futurizmi, teksa u përpoq që t'i flakte imazhet e së shkuarës, duke hedhur në erë strehën e tyre: bibliotekat, muzeumet.

Për sa i përket *sistemi tropeik*, në poezitë e kësaj periudhe, spikasin jo pak metaforat e energjisë, e mobilizimit, e thirrjes për t'u bërë pjesë e vrullit revolucionar, e rilindjes dhe e ripërtëritjes, e heroizmit, e fantazisë, e entuziazmit, e vetëmohimit të individit për hir të nevojave të shoqërisë, që janë disa nga tropet kryesore të futurizmit. Po ashtu, njëlloj si futurizmi, kjo poezi nuk boshtohet rreth “kombit” – një koncept gjeopolitik – por rreth “atdheut” – një koncept biologjik dhe, për më tepër, njëlloj si në rastin e futurizmit që shtratëzuar tashmë si pjesë e aparatit ideologjik të fashizmit, kjo poezi i drejtohet më së tepërmi rinisë, duke i bërë jehonë forcës fizike dhe aksioneve të drejtpërdrejta të punës vullnetare.

Më të pakta janë ngjashmëritë në rrafshin sintaksor; lëvizjet e saj i përgjigjen më së tepërmi një rrjedhe normale të zhvillimit të një gjuhe poetike nga ana e poetit, sesa një formësimi të ri *ad hoc*, apo *ex nihilo* “me të grykës pushkë hej një maliher”, porse shembujt janë fare të paktë, arsye për të cilën mund të vështrohen si shprehje të pakta të *licentia poetica*-s.

## Luftë në të gjitha frontet: ideologjike, politike, ekonomike, botëkuptimore

I tërë ky kuadër na përball me pyetjen që besojmë se nisi të gjallojë natyrshëm më lart: kjo bujtje e “vonuar” e futurizmit, a mos ndoshta ka lidhje me shfaqjen e “vonuar” në Shqipëri të asaj “forme të jetës” që mundësoi lindjen e tij, apo mos ndoshta është fryt i një “vonese” që lidhet me kohën e kontaktit, e kohës kur poetët tanë ranë në kontakt me traditën e poezisë futuriste që ishte lëvruar në ish-vendet e BRSS-së? Personalisht jam i mendimit se gjasa e parë shfaqet më e mundshme, për

aq sa edhe në ish-vendet e BRSS-së futurizmi ishte një poetikë që kishte perënduar tashmë qysh në vitet e para të revolucionit të 1917-s.

Më tepër sesa një mëtim për të sjellë një risi poetike, personalisht duam të besojmë se kemi të bëjmë me një huazim të një modeli që i përgjigjej një “forme” të ngjashme “të jetës”. “Forma e jetës” që solli lindjen e futurizmit shfaq jo pak ngjashmëri dhe përkime me “formën e jetës” brenda të cilës u lëvruan poezitë me frymë futuriste në Shqipërinë e viteve '60-'70.

Më konkretisht: mes këtyre dy “formave të jetës” ndehet luftë e gjithanshme: Është e njëjta klimë lufte, një luftë ideologjike, politike, ekonomike, botëkuptimore, etj.

Përpos kësaj, të dy “format e jetës” bashkohen në të njëjtin qëndrim ndaj të shkuarës. Në vitet '60 -'70, tashmë i vendosur mirë në pushtet, regjimi fillon të lëvrojë idenë e njohur të “botës së re”, e cila shfaq jo pak ngjashmëri me “absoluten” e futuristëve: një botë i lindur nga vala e revolucioneve dhe nga sipërmarrjet “mbinjerëzore” të njerëzores, çka në Shqipëri u kurorëzua në formën më të dukshme me rrënimin e kishave dhe nxjerrjen jashtë ligjit të besimeve fetare, të cilat mishëronin “botën e vjetër”. Sikundër në rastin e fashizmit, edhe në rastin e komunizmit, poetët thirren të luftojnë në frontin botëkuptimor, për të qenë kësisoj fronëzuesit e një zoti të ri: e revolucionit teknologjik nga njëra anë, dhe e revolucionit ideologjik nga ana tjetër, i boshtuar më së tepërmi në kultin e udhëheqësit të bërë njësh me forcën që udhëheq.

## Letërsi sa realiste aq irealist-utopike

Tjetërsimi i rolit të letërsisë, partishmëria dhe “përshkrimi i ‘realitetit objektiv’ [realizmi] nën dritën e zhvillimeve revolucionare [socialiste], si dy prej shtyllave kryesore të poetikës së realizmit socialist si dhe aspektet e tjetërsuara estetike, poetike dhe letrare, ishin vetëm disa prej ligjësive të përgjithshme të metodës krijuese të letërsisë së realizmit socialist, të cilat bashkë me shndërrimin dhe humbjen e funksionit estetik të disa prej elementëve dhe procedeve thelbësore të realizmit, bënë që jo vetëm socializmi, por edhe vetë realizmi e bashkë me të e gjithë metoda, pavarësisht se si ajo u shfaq, u importua, u imponua apo u “përqafua pa rezerva”, të përfundonte si një aventurë e miksuar mes narcizimit, donkishotizmit dhe futurizmit. Por gjithsesi, siç kemi pasur rastin ta vëmë re dhe ta theksojmë më se një herë gjatë këtij punimi, pa praninë e formave paraardhëse të realizmit, *realizmi socialist*, si metodë dhe si aplikim me prirje sa romantike as edhe futuristike, sa realiste aq irealist-utopike, nuk do të kishte mundur të krijonte truall dhe të bëhej sundues, së paku jo aq shpejt dhe jo aq lehtësisht, duke e shndërruar këtë *metodë krijuese* nga një formë të epërme ligjërimi, siç pretendohet, në një ligjërim formal.

Irealizmi dhe hiperrealizmi i veprave të mëvonshme, do të fuste në rrugën e krizës jo vetëm letërsinë, por edhe perceptimin e publikut mbi gjithë sa ndodhte në artin dhe në kulturën shkrimore shqiptare, kulturë e cila e cila pikërisht pas vitit 1950 filloi të merrej më seriozisht me çështjet e metodës, me marrëdhëniet që do të vendoste “arti i ri” me traditën dhe letërsinë që po krijohesh, tashmë jo vetëm përmes veprave artistike autoriale, por edhe përmes sprovave të hartimit të teksteve të formatit dhe formulimit historiografik, akt ky që linte të nënkuptuar pretendimin se vlerat letrare, shkruar prej autorëve vendës në metodën e realizmit socialist, ishin krijuar dhe se ato meritonin të përfillëshin, të vlerësoheshin, t’i nënshtroheshin gjykimit të kritikës profesionale dhe të trajtoheshin si pjesë e historiografisë letrare.

## Përfundime

Nga gjithë sa më sipër, besojmë se, në mos arritëm të themi një të vërtetë, më së paku shtruam një ide apo këndvështrim që tashmë shfaqet një gjasë logjike e mundshme dhe e qëndrueshme, e cila do të kërkonte padyshim një analizë më të gjerë dhe më të thellë: më konkretisht këtu, gjasën sipas të cilës prurjet letrare të Evropës bujtën në letrat shqipe si “pelegrinë të vonuar” për shkak të “vonesës” së shfaqjeve në vendin tonë të atyre “formave të jetës” që mundësuan lindjen dhe zhvillimin e tyre.



## MES NOSTALGJISË DHE AMNEZISË – REFLEKTIMI I SHOQËRISË SHQIPTARE DHE ASAJ GJERMANE NDAJ KRIMEVE TË KOMUNIZIMIT

Aida Cama

Më 23 gusht në vendet e Bashkimit Evropian kremtohet "Dita përkujtimore për viktimat e të gjitha sistemeve dhe regjimeve autoritare". Po në vende të ndryshme, të përndjekurit jetojnë në kushte të ndryshme dhe e përkujtojnë gjithashtu atë kohë në mënyra të ndryshme.

"Në Shqipëri mungon kujtesa historike për atë kohë," thotë Fatos Lubonja, i cili si mbi 15.000 shqiptarë ka kaluar vite të tëra në burgjet e regjimit komunist në Shqipëri. Por ata që kanë mundur të mbijetojnë prej vuajtjeve dhe torturave janë të ndarë sa i përket kujtimit të asaj kohe: disa syresh duan ta mbajnë gjallë kujtesën për vitet e tmerrshme të sundimit komunist, kur në një burg të madh jetonin të gjithë shqiptarët, të tjerë jo, ata preferojnë të heshtin.

Nga ana tjetër 20 vjet pas përmbysjes së diktaturës në Shqipëri, thuajse janë zhdukur të gjitha gjurmët e dhunës komuniste, nuk ka thuajse asnjë shenjë a tabelë që tregojnë burgjet apo kampet e internimit. Si dhe ku mund të tregohet historia e regjimit të dhunës komuniste në Shqipëri? Për këtë çështje në Shqipërinë postkomuniste thuajse nuk është kujdesur askush. Përballja me të kaluarën në Shqipëri ka qenë e kufizuar kryesisht në dëmshpërblimin material të viktimave. Madje edhe në këtë pikë shumë prej viktimave nuk kanë pasur mundësi të përfitojnë, sepse atyre u kërkoheshin shumë dokumente dhe një pjesë e tyre ishin aq në moshë të shkuar, sa nuk arritën dot as të bënin kërkesat për dëmshpërblim.

Problemi i prezantimit të dhunës komuniste nuk lidhet vetëm me paraqitjen e kësaj periudhe në muzeume,<sup>1</sup> por edhe në fusha të tjera, si në historiografi. Pas vitit 1990 historianët shqiptarë e kanë rishkruar dy herë deri tani historinë e Shqipërisë për tekstet shkollore zyrtare, në vitin 1994 dhe 1997. Në të dyja rastet pati ndikime të politikës në shkrimin e historisë. Në varësi të partisë në pushtet edhe kjo histori anonte politikisht më nga e majta apo më nga e djathta. Elita politike shqiptare e pas '90 ka qenë dhe është e dashuruar pas historisë, ose më saktë është kujdesur që historia të shkruhej sipas interesave të saj.

---

<sup>1</sup> Muzeu Historik Kombëtar në Tiranë i kushtoi në mes të viteve 90-të një pavion përndjekjes komuniste në Shqipëri. Por ky pavion, sikurse i gjithë muzeumu janë tani në rikonstruksion.

Në vitin 2005 qeveria shqiptare lejoi botimin e librave alternativë për historinë. Megjithatë problemi se si duhet prezantuar historia e Shqipërisë, vazhdon të mbetet një problem i pazgjidhur, ngaqë në shkrimin e historisë vazhdojnë të dominojnë gjurmët e shkollës dhe të metodologjisë së mëparshme, të cilat kanë qenë të thella.

Në vitin 2009 Akademia e Shkencave e Shqipërisë botoi një histori të re të Shqipërisë. Në vëllimin IV që u kushtohet viteve 1939-1990 Akademia përsërit këndvështrimin e historisë sipas atij të historiografisë gjatë periudhës së diktaturës komuniste. Për të përndjekurit politikë duket se as librat e rinj të historisë së Shqipërisë nuk kanë vend. Sikurse në periudhën e diktaturës komuniste ata mbeten të papërmendur si në librin e Akademisë për historinë e Shqipërisë edhe nëpër tekste shkollore, duke vazhduar të quhen „armiqtë e klasës punëtore“.

Periudha e diktaturës komuniste në Shqipëri është herë pas here pjesë e emisioneve televizive, në të cilat ftohen të diskutojnë gazetarë, ish të përndjekur nga regjimi, historianë e politikanë. Edhe në të tilla emisione del e qartë ndarja në kampe e shoqërisë shqiptare dhe mungon një konsens për trajtimin objektiv dhe larg emocioneve të tepruara të temës së brutalitetit të regjimit komunist. Po ashtu këto diskutime thuhet nuk e arrijnë fare brezin e ri, sepse nuk ka asnjë formë trajtimi që ta bëjë këtë temë interesante për të rinjtë, pra filma, romane apo pjesë teatrale.

Ana Kaminsky, drejtore ekzekutive e Fondacionit Federal për Zbardhjen e Diktaturës së Partisë së Bashkuar Socialiste Gjermane në ish-RDGJ thekson:

*“Për ne nga Gjermania është tepër e çuditshme që konstatojmë se si një shoqëri, e cila nga njëra ana ka qenë e prekur nga një nga diktaturat komuniste më brutale dhe ku pjesa më e madhe e popullsisë iu është nënshtruar drejtpërdrejt represioneve më të tmerrshme, ka nga ana tjetër probleme tepër të mëdha për t’u marrë me këtë traumë, për t’i vënë emrin e duhur dhe trajtuar historinë e kësaj kohe dhe për t’i dënuar personat përgjegjës.”*

## Mes nostalgjisë dhe harresës

Shqipëria dhe Gjermania gjithsesi duket se ngjajnë në një pikë: ndërsa shumica e atyre që e kanë përjetuar vetë periudhën e diktaturës kanë një lloj interesi për atë kohë, për të mësuar se çfarë janë të vërteta nga ato që thuheshin nën zë apo dihen për atë kohë, brezi i ri është indiferent.

Po ashtu anketat tregojnë se në të dy vendet një pjesë e popullsisë, sidomos të

rinjtë që kanë lindur pas vitit 1990, dinë fare pak ose thujtë asgjë për periudhën e diktaturës komuniste.<sup>2</sup>

Brezat e më të rriturve kanë një lloj ndjeshmërie tjetër për atë kohë, sepse është një histori që i ka prekur disi drejtpërdrejt ose indirekt. Por kjo ndjeshmëri është e bashkuar edhe me një lloj heshtjeje, apo ndoshta me një ndjenjë bashkëfajësie, e cila sigurisht bën që problematikat e kësaj çështjeje të mos transmetohen tek të rinjtë. Kësaj i duhen shtuar edhe problemet e mëdha që ka krijuar e tashmja në Shqipëri me problemet e saj, të cilat e zhvendosin edhe më shumë vëmendjen dhe preokupimin e njerëzve nga ajo kohë.

Fatbardh Doko është në gjendje të tregojë shumë për atë kohë, për jetën në internim dhe mënyrën e organizimit të zonave të internimit. Ai vetë erdhi në jetë në një kamp internimi në vitin 1959. Prindërit e tij ishin që të dy të internuar dhe familja Doko ka kaluar 43 vjet në internim. Në moshën 14-vjeçare ai u detyrua ta linte shkollën dhe të punonte në fushë me prindërit dhe të rriturit e tjerë. Duke gjykuar për interesin që tregon sot shoqëria shqiptare për periudhën e diktaturës, Fatbardh Doko vëren se: "shqiptarët përpiqen ta harrojnë historinë, por ajo i mbërthen ata vazhdimisht."

Simon Mirakaj nga Instituti për Integrimin e ish të Përndjekurve Politikë, mendon se: "Edhe pse kanë kaluar mbi 20 vjet në Shqipëri vazhdon të sundojë mentaliteti komunist. Ata që kanë bërë krime, as që kanë marrë mundimin të kërkojnë të paktën falje dhe të thonë se u vjen keq. Në Shqipëri as që zhvillohet një diskurs i tillë."

Fatos Lubonja e shpjegon këtë me vazhdimësinë e elitave në Shqipëri. Në këtë pikë Shqipëria i ngjan Ruisë. Në të dyja vendet antikomunizimi u kuptua si ideologji e re për të mbetur apo për të riardhur sërish në pushtet.

Përveç kësaj Shqipëria e ka shumë të vështirë ta kryejë siç duhet procesin

---

<sup>2</sup> Sipas një studimi të Fondacionit Federal për Zbardhjen e Diktaturës së Partisë së Bashkuar Socialiste Gjermane në ish-RDGJ dhe të Lidhjes Gjermane të Mësuesve të Historisë, ndër rreth 5.600 gjimnazistë të pyetur për këtë periudhë si në landet lindore edhe ato perëndimore të Gjermanisë janë vënë re mangësi të shumta. Nxënësit iu përgjigjën saktësisht vetëm rreth gjysmës së pyetjeve. Nxënësit kishin mangësi jo vetëm lidhur me datat historike, por edhe me figurat politike dhe historike të asaj periudhe. Po ashtu shumë nga nxënësit besojnë se shumë qytetarëve të RDGJ nuk i kundërviheshin regjimit, sepse kishin më shumë frikë se mos humbisnin vendin e punës, dhe jo nga represioni që ushtronte regjimi. Deficite autorët e studimit kanë konstatuar edhe gjatë analizës së 64 teksteve e librave shkollorë të historisë si dhe materialeve mësimore nga dhjetë shtëpi botuese. Edhe pse zhvillimet dhe ngjarjet historike në to janë paraqitur me korrektësi, fillimi i ri politik në Gjermani prezantohet mangët dhe disi vakët, sikurse edhe sistemi diktatorial i Partisë Socialiste të Bashkuar Gjermane (SED) dhe ndikimi i partisë në aparatin shtetëror, në arsim dhe në media nuk i nënshtrohen një kritike komplekse. Po ashtu edhe opozita dhe rezistenca e saj paraqiten në këto libra mënyrë jo sistematike.

e transformimit drejt një shoqërie demokratike, sidomos për shkak të konflikteve sociale. Shoqëria e re shqiptare vrapon sot në një mënyrë të jashtëzakoshme pas parasë dhe pas konsumit. Kjo rendje dhe shkatërimi i shumë vlerave në kohën e komunizimit pengojnë kërkimin e kujtimeve, analizimin e historisë dhe gjetjen e vlerave të reja.

## Përvoja gjermane

Autoriteti Federal i ngarkuar me dokumentat e shërbimit të sigurimit të shtetit të ish-RDGJ-së<sup>3</sup> i cili mori në ngarkim dosjet që mundën të shpëtoheshin prej arkivave të Ministrisë për Sigurimin e Shtetit<sup>4</sup> i përgatiti ato për t'ua vënë në dispozicion të prekurve, studiuesve dhe gazetarëve. Arkivi i Autoritetit Federal për dokumentat e Shtazit përmban 39 milionë kartela dhe 111 kilometra dosje. Në fondet e tij gjenden po ashtu 1,4 milionë fotografi, 2.734 regjistrime në filma dhe video si dhe 31.300 regjistrime zanore në shirita magnetofoni, kaseta etj.

Falë këtyre dokumenteve, me kalimin e viteve, janë demaskuar shumë prej ish-bashkëpunëtorëve të Shtazit, ndër ta edhe një sërë personash që u bënë aktivë në jetën politike gjermane edhe pas bashkimit të vendit.<sup>5</sup> Shumë viktima mësuan se çfarë përmbanin arkivat për ta dhe se kush i kishte spiunuar.

Marianne Birthler, nga viti 2000 deri në 2011 e ngarkuara e Qeverisë Federale Gjermane për drejtimin e institucionit që merret me dokumentat e Sigurimit të Shtetit të RDGJ-së, i vlerëson me këto fjalë dosjet: "Përmes tyre kemi një mundësi, që t'i kundërvihemi me fakte konkrete krijimit të legjendave dhe madje edhe disa gënjeshtreve masive mbi historinë dhe një tendence shumë të përhapur për të zbukuruar realitetin në ish-RDGJ." Po ashtu ajo mendon se, hapja e dosjeve të Shtazit dhe rivlerësimi i njëkohshëm me këtë i një pjese të rëndësishme të historisë së RDGJ-së është një kontribut i rëndësishëm për "paqen sociale" në Gjermani.

<sup>3</sup> Më 15 janar 1990 mijëra gjermanolindorë u grumbulluan përpara hyrjes kryesore të Ministrisë për Sigurimin e Shtetit dhe më pas e mësynë atë. Në këtë mënyrë ata arritën të shpëtonin prej asgjësimit një numër të madh të dosjeve të Shtazit. Pas bashkimit të Gjermanisë u krijua Autoriteti federal i ngarkuar me administrimin e dokumentave të shërbimit të Sigurimit të Shtetit të ish-RDGJ-së. Shih për më tepër <http://www.bstu.bund.de>.

<sup>4</sup> Për shërbimin e fshehtë gjermanolindor pra Ministrinë për Sigurimin e Shtetit (MfS) përdoret rëndom shkurtimi 'Stasi' (Shtazi). Përveç Shtazit që ishte një institucion spiunazhi, i cili me shpenzime gjigante për personelin dhe mjetet teknike vepronte në radhë të parë brenda vendit, ekzistonte edhe një përbindësh i ristrukturuar ushtarakisht, Administrata Qendrore për Zbulimin shkurt (HVA) e Ministrisë për Sigurimin e Shtetit e ngarkuar me zbulimin jashtë RDGJ-së. Misioni i saj kryesor ishte spiunazhi në Republikën Federale të Gjermanisë.

<sup>5</sup> Si p.sh. në Partinë për Socializmin Demokratik (PDS), e cila u krijua në vitin 1989 si pasuese e SED-së, krh. Sebastian Prinz: Die programmatische Entwicklung der PDS. Kontinuität und Wandel der Politik einer sozialistischen Partei, Wiesbaden 2010.

Edhe pse deri sot kanë kaluar 20 vjet qëkurse ky autoritet filloi nga puna, interesi për ato, që ka lënë pas shërbimi sekret komunist, vazhdon të jetë i pandërprerë dhe i lartë. Sipas Birthler "çdo vendim i të prekurve apo i të interesuarve të tjerë për të paraqitur një kërkesë për të parë dosjet është; në thelb një vendim kundër harresës."

Përveç institucionit të mësipërm në Gjermani ka shumë shoqata të të përndjekurve që merren me periudhën e diktaturës dhe përkujdesen për vendet përkujtimore dhe muzeumet e ngritura në ish-burgjet e RDGJ-së dhe sidomos në burgun qendror të hetuesisë në Hohenshenhauzen në Berlin. Të përndjekurit shkojnë edhe nëpër shkolla dhe tregojnë për atë kohë. Po ashtu ka edhe mjaft institucione që merren nga pikëpamja shkencore me periudhën e diktaturës në ish-RDGJ-Në. Po ashtu ekziston edhe një fondacion i posaçem federal që merret me studimin dhe përpilimin e botimeve dhe të informacioneve për atë periudhë.<sup>6</sup> Fondacioni Federal për Zbardhjen e Diktaturës së Partisë së Bashkuar Socialiste Gjermane (SED) është krijuar me paratë që ka pasur dikur partia në pushtet në RDGJ, SED-ja, dhe sot mbështetet edhe nga shteti gjerman.

---

<sup>6</sup> Për më tepër informacione rreth veprimtarisë së këtij fondacioni si dhe botimeve të tij shih më hollësisht <http://www.stiftung-aufarbeitung.de/index.php>